

LE MONDE. *shqip* *diplomatique*

100 LEKË, 1 EURO / MUJORE / 24 FAQE

Nr. 789 / Viti i 67 i botimit / Janar 2020

SINDIKATA E RE E MINATORËVE NË BULQIZË

Kromi i oligarkisë

Themelimi i sindikatës së re nga minatorët e Bulqizës ka rishfaqur çështjen e të drejtave dhe statusit të minatorëve. Aksidente fatale, pushime nga puna, ulje pagash, miniera e kromit të Bulqizës vazhdon të jetë sinonim i shfrytëzimit të minatorëve për përfitimet private të oligarkisë së lidhur me politikën.

NGA SAMI CURRI

Pas më shumë se tetë vitesh, minatorët e Bulqizës u rikthyen sërish në sheshin e protestës. Para hyrjes për në pusin e shfrytëzimit të kromit në Minierën e Bulqizës. Në protestat e vitit 2011 ishte vendi i përplasjeve ndërmjet policisë dhe minatorëve. Sot, Miniera e Kromit në Bulqizë administrohet nga kompania Albchrome e Samir Manë, pjesë e BALFIN grup. Të zhgënjyer nga puna e sindikatës ekzistuese të cilët minatorët e konsiderojnë si palë me firmën dhe që nuk mbron interesat e minatorëve, këta të fundit themeluan një sindikatë tjetër. Albchrome është kompania që ka numrin më të madh të të punësuarve në sektorin minerar, afro 650 punonjës. Në të gjithë zonën mineral-mbajtëse të Bulqizës dhe Martaneshit, sipas

të dhënave nga Zyra e Punës në Bulqizë janë të punësuar afro 2100 persona, ku përpos Albchrome operojnë edhe 36 subjekte të tjera minerare. Sipas të dhënave të bëra publike nga BIRN, prej vitit 2014 në galeritë e kromit në Bulqizë dhe Martanesh, kanë humbur jetën 27 persona dhe shumë të tjerë janë plagosur gjatë punës në minierë.

Puna për themelimin e sindikatës së Minatorëve të Bashkuar të Bulqizës do të niste që në muajin prill të vitit 2019. Themelues do të ishin 39 minatorë. Pas ndjekjes së procedurave ligjore, më 15 nëntor 2019-të Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë do ta njihte zyrtarisht sindikatën. Dy ditë më vonë në qendër të Bulqizës do të bëhej edhe shpallja publike e sindikatës. Vetëm pesë



ditë pasi sindikata ishte themeluar dhe njohur nga Gjykata e Tiranës, kompania Albchrome do të shkar-konte nga puna kreun e sindikatës të Minatorët e Bashkuar të Bulqizës, Elton Debreshi. Disa minatorë të tjerë pjesë e sindikatës do të paralajmëroheshin për pushim nga puna. Debreshi tregon se për themelimin e sindikatës kanë ndjekur të gjitha hapat e nevojshëm ligjor dhe se sindikata ekzistuese në Minierën e Kromit në Bulqizë, pjesë e Konfederatës të Sindikatave të Shqipërisë të drejtuar nga Kol Nikollaj, ka humbur kontaktin me minatorët dhe nuk mbron më interesat e punëtorëve, por është palë me kompaninë. “Themelimi i kësaj sindikate ka ardhur si nevojë sepse laku minatorëve të Bulqizës ju ka ardhur në fyt. Nuk mban më.

Që një punëtorë të futet mbi 1000 metër nëntokë dhe të paguhet 350 mijë lekë të vjetra në muaj dhe një trajtim ushqimor prej 150 mijë lekë të vjetra është e papranueshme. Minatorët që prej vitit 2011 nuk kanë pasur rritje page, por vetëm ulje”, tregon Debreshi. Ky i fundit ka disa breza të familjes së tij që punojnë në Minierën e Kromit në Bulqizë. Është babai i katër fëmijëve dhe që prej dhjetorit të vitit 2019 është i papunë. “Unë jam minator, babain e kam minator, edhe gjyshin ka punuar një jetë minator. Jam brezi i tretë në familjen time që punoj në atë galeri edhe i dimë shumë mirë hallet, se në familjet tona nuk ka muhabet tjetër, veçse ‘galeria, rroga, minatori, kush u vra, kush shpëtoi, kush erdhi e kush shkoi’. Sot jam i papunë, vetëm se.... / Faqe 8-10

Koment

Mini-schengeni si jelek shpëtimi?

Nga Agon Maliqi / Faqe 7

Editorial

Regjimi iranian ose një njeri që po mbytet, nuk ka frikë nga shiu

Nga Leart Kola / Faqe 4

Vrasja e Gjeneral Kasem Sulleimanit erdhi si atëherë kur amerikanët vendosën të ndërhyjnë në Lindjen e Mesme, në momentin më të pafavorshëm. Në Iran prej muajsh njerëzit ishin në shesh...

Globalizimi

Trukimi i një lufte tregtare mes përplasjes së qytetërimeve

Nga Jean-Louis Rocca / Faqe 12

Kur në janar të vitit 2017, Z. Xi Jinping foli për një himn në lidhje me këmbimin e lirë dhe mburri performancat e Kinës, udhëheqës politikë, kinologë, dhe gazetarë të ndryshëm e duartrokitën, duke...

Ekzodi masiv ballkanik

Shpopullimi në paqe

Nga Shkodran Hoti / Faqe 18

Përderisa është inicuar projekti për “Mini-Shengen” ballkanik, i cili ka për qëllim lëvizjen e lirë të mallrave, shërbimeve, kapitalit dhe e fuqisë punëtore; po vazhdon shpopullimi masiv i shteteve të Ballkanit Perëndimor. Vendet e rajonit...

Letërsi

Penat e kundërthënies

Nga Belgzim Kamberi / Faqe 22

Jo pak shkrimtarë vendorë me ndikim ishin frymëzues të projekteve politike që patën përfundime vrastare në masë, përgjatë historisë ballkanike dhe sidomos luftërave të fundit në ish-Jugosllavi. Përtej çështjes së ballafaqimit të sotëm të letërsive dhe të artit me...

REFORMË PENSIONESH, KORRUPSION, JETA E SHTRENJTË...

Nga Santiago në Paris, popujt në rrugë

Tani, kjo është e treta apo e katërta valë protestash masive kundër rendit neoliberal dhe qeveritarëve të tij? Nga Bejruti në Santiago, pa harruar Parisin, pushteti politik, në të gjitha rastet, edhe kur përdor forcën, duket i paaftë të rivendosë situatën.

NGA SERGE HALIMI



Pikënisja e protestave, disa herë apo një muaj më pas, ka pak rëndësi. Dhe kënaqësia e protestuesve për kërkesat fillestare, pak efekt. Duke anuluar rritjen prej 4% të çmimit për metronë, z. Sebastián Piñera nuk arriti, megjithatë, të zbrastete rrugët e Santiagos, dhe qeveria e Hong Kongut, duke tërhequr mbrapsht ligjin e ekstradimeve, nuk i çarmatosi opozitarët.

Sapo protestat nisin, ato thellhen më shumë. Për pasojë, duhet dërguar policia, ushtria. Dhe... të premtosh që në Irak, në Kili, në Algjeri duhet modifikuar Kushtetuta.

Por, sapo zjarri shuhet shpejt diku, ai ndizet gjetkë. Kërkesat janë të mëdha: «Populli do të përmbysë regjimin.» Si mund ta arrijë këtë? Po çfarë do të bëjë pastaj?

Përgjithësisht, ai nuk e di dhe prandaj vijon më tej. Në Algjeri u bë një vit që populli manifeston. Në HongKong nisi në prill të vitit të shkuar. Merita e saj është e madhe: frika e një represioni brutal mund të paralizojë kundërshtuesit. Megjithatë, ata nuk lëvizin nga vendi. Po çfarë do të ndodhë në Iran ku numri i protestuesve të vrarë është mbajtur sekret?

Në këto manifestime popullore, një mosbesim i përgjithshëm është bërë si një masë çimentoje dhe argjili; mosbesim ndaj liberalizmit ekonomik që ndërton një shoqëri kastash me manjatët e saj dhe të dëbuarit. Por, sidomos, mosbesim ndaj arrogancës dhe gënjshtreve të sistemit politik të vendit përkatës që klasa zotëruese, «elitat», e kanë transformuar në një... / Faqe 2-3

REFORMË PENSIONESH, KORRUPSION, JETA E SHITRENTJË...

Nga Santiago në Paris, popujt në rrugë

Tani, kjo është e treta apo e katërta valë protestash masive kundër rendit neoliberal dhe qeveritarëve të tij? Nga Bejruti në Santiago, pa harruar Parisin, pushteti politik, në të gjitha rastet, edhe kur përdor forcën, duket i paafitë të rivendosë situatën.

NGA SERGE HALIMI

**A SI ALGJERIA,
B SI BOLIVIA,
C SI KOLUMBIA,
E SI EKUATORI,
F SI FRANCA...**

Pikënisja e protestave, disa herë apo një muaj më pas, ka pak rëndësi. Dhe kënaqësia e protestuesve për kërkesat fillestare, pak efekt. Duke anuluar rritjen prej 4% të çmimit për metronë, z. Sebastián Piñera nuk arriti, megjithatë, të zbrastë rrugët e Santiagos, dhe qeveria e Hong Kongut, duke tërhequr mbrapsht ligjin e ekstradimeve, nuk i çarmatosi opozitarët. Sapo protestat nisën, ato thellhen më shumë. Për pasojë, duhet dërguar policia, ushtria. Dhe... të premtosh që në Irak, në Kili, në Algjeri duhet modifikuar Kushtetuta.

Por, sapo zjarri shuhet shpejt diku, ai ndizet gjetkë. Kërkesat janë të mëdha: «Populli do të përmbysë regjimin.» Si mund ta arrijë këtë? Po çfarë do të bëjë pastaj? Përgjithësisht, ai nuk e di dhe prandaj vijon më tej. Në Algjeri u bë një vit që populli manifeston. Në HongKong nisi në prill të vitit të shkuar. Merita e saj është e madhe: frika e një represioni brutal mund të paralizojë kundërshtuesit. Megjithatë, ata nuk lëvizin nga vendi. Po çfarë do të ndodhë në Iran ku numri i protestuesve të vlarë është mbajtur sekret?

Në këto manifestime popullore, një mosbesim i përgjithshëm është bërë si një masë çimentoje dhe argjili; mosbesim ndaj liberalizmit ekonomik që ndërton një shoqëri kastash me manjatë e saj dhe të dëbuarit. Por, sidomos, mosbesim ndaj arrogancës dhe gënjshtreve të sistemit politik të vendit përkatës që klasa zotëruese, «elitë», e kanë transformuar në një gardë pretoriane të privilegjeve të tyre.

Pafuqia, çështja e mbrojtjes së mjedisit janë

një provë e gjallë. Katër vjet pas shpalljes së bujshme të COP 21, asaj i ka dalë boja. Planeti i të pasurëve nuk ka reshtur së shtuari oreksin e konsumizmit; rreziqet e superngrorjes globale janë të precizuara. Kryebashkiakja socialiste e Parisit, zj. Anne Hidalgo i jep fund debatit ekologjik, gjithë duke lejuar që ndërtesat gjigande të kryeqytetit të mbushen me reklama po ashtu gjigande dhe të ndriçuara për markat e luksit dhe telefoninë celulare. Ndërsa ministri francez i transporteve po shijon një karrierë premtuese në sektorin ku është përgjegjës: «Ka nevojë për tridhjetë mijë shoferë në vitet e ardhshme, pra është një zanat që duhet vlerësuar, sigurisht të të rinjtë.» Më shumë shoferë në rrugë, më shumë «vetura Makron», ja kush do ta mbrojë ekosistemin.

Po rrjeti hekurudhor, SNCF? Nuk është kjo çështja, sepse duhen luftuar stafet e tepërta në ndërmarrjet publike.

Në dhjetor 2010, zgjimi tunizian hapi ciklin e «pranverave arabe». «Lëvizja e shesheve» spanjolle u shfaq në majin e vitit të mëpasëm; mobilizimi i studentëve kilenë, në qershor; Occupy Wall Street, në shtator. Viti që po çelet do të shënojë dhjetëvjetorin për të gjitha këto. Tashmë, në epokën tonë, është zgjuar rinia, spontaneiteti, përdorimi i rrjeteve sociale, re-

**NË DHJETOR 2010,
ZGJIMI TUNIZIAN HAPI
CIKLIN E «PRANVERAVE
ARABE». «LËVIZJA E
SHESHEVE» SPANJOLLE
U SHFAQ NË MAJIN E
VITIT TË MËPASËM;
MOBILIZIMI I
STUDENTËVE KILENË, NË
QERSHOR; OCCUPY WALL
STREET, NË SHTATOR**

fuzimi për të qenë të shëruar, zemërimi i lindur nga politikat ekonomike pothuajse të destinuara të sjellin dëme të provokuara nga bankat. Nëntë vjet më vonë, në qoftë se një diktator ka rënë në Tunizi, kërkesat shoqërore me origjinë nga kjo revoltë nuk e kanë gjetur as hijen e kësaj zgjidhjeje. Por, situata nuk është brilante as gjetiu. Në këto kushte, kuptohet dobia e lajmeve të mira. Dhe pastaj ngasja për të mbiçmuar ekzis-

tencën e një vetëdijeje ndërkombëtare, të afërt me prioritetet që mbrojnë vetveten, atje ku nuk ekzistojnë ende veçse lëvizje kozmopolite, të

paqëndrueshme dhe që nuk shqetësohen aspak që të ndërtojnë lidhje mes tyre.

Që nga fundi i shekullit të kaluar, vdekja e kapitalizmit, konvergjenca e luftërave, hegjemonia e raskapitit e mondializmit ishin lajmëruar me rregullsinë e metronomit. Me qindra herë kundërshtari ishte diagnostikuar me agoni ose e kishin marrë për të vdekur. Por, gjithmonë ai di të ndryshojë fytyrë dhe ligjërim. Dyzetë vjet pas ardhjes në pushtet të Margaret Theçerit, në Britaninë e madhe fryn një erë e re. Në anë tjetër të Atlantikut fatkeqësitë e nëntorit nuk thoshin asgjë të mirë. Më mirë ia vlen të dish (me gjithë që mund të jetë e rehatshme), të kthesh vështrimin nga një dështim ose nga disa të tilla – në Brazil, në Greqi, në Bolivi, në Itali – e shumë shpejt do të mësohet se diku zjarri është rindezur.

Në këtë gjendje, edhe karburanti i zjarrit sot gjendet pothuajse kudo. Ekonomik dhe politik në të njëjtën kohë: jo vetëm kriza financiare e 2008-s ka nxjerrë të fituar përgjegjësit kryesorë të saj, por edhe pjesa e madhe e partive tradicionale, e djathtë e majtë përzier bashkë, u koordinuan për të imponuar zgjidhje të padrejta për popullsinë e tyre. Legjitimiteti i «sistemit» ka vuajtur shumë prej saj. Dhjetë vjet më pas ai është ende në tokë. Konstatimi i një falimentimi të tillë, gjithashtu, mund të hapë rrugën (ose t'i japë frymë) interpretimeve idologjike të kundërta. Sepse «sistemi» që është nën akuzë nuk është me domosdo ai që aktivizohet në shërbim të klasës kapitaliste. Të tjerë. Për më tepër shohin në të gjithë atë që, sipas tyre, mbron padrejtësisht njerëzit e anës tjetër, që janë pak më keq ose më tej akoma, të huajt, ata që janë në «asistencë». Privilegjet e zotëruesve vijnë nga kjo lloj fyerjeje.

**TË FINANCOSH PRIVATËT
PËR TË SHKATËRRUAR
SHËRBIMIN PUBLIK**

Pavarësisht ndërhyrjeve përcarëse që gjetkë shënjestrojnë sunitët, shiitët, Kabilët ose Katalanasit, uniteti i protestuesve, për momentin, ende mbahet. Rreth kërkesave dhe refuzimeve që ndeshen thuajse ngado: të jetosh me dinjitet, kryelartë; t'i kundërvihesh një amputacioni të ri të programeve shoqërore, ose rritjes

Foto Norbu Gyachung



Nga protestat në Ekuador



së çmimeve të shërbimeve të domosdoshme (transporti, energjia, komunikimet); duke mos u kënaqur nga ulja e përqindjes së papunësisë kur ajo mbulon më së shumti «punët e mbledhjes së plehrave» (në Spanjë, 40% e kontratave të reja të punës janë realizuar për më pak se një muaj) [2], aq sa punët e përkohshme janë përqëndruar nëpër metropole ku çmimi i qerave të banesave ka shpërthyer. Kostoja e lartë e jetës, varfëria, pabarazia formojnë kështu dramën e kundërshtimeve. Në Sudan ashtu si në Ekuador, në Liban ashtu si në Kili.

Thuajse kudo, gjithashtu, falë sinqeritetit brutal të neoliberalizmit që gris perden mes Shtetit dhe kapitalit, rivendikimet ekonomike janë dyfishuar nga kërkesat politike. Sepse korrupsioni, skandalet nuk përmbledhen në çështjet e dorës së dytë që shtypi nxjerr në dritë: një asistent parlamentar në të cilën një parti në kohën e punës është konsakruar me aktivitete partizane, një president i Asamblesë që u ofron karkalecë deti familjarëve të tij; apo mësimet për kalorësinë, twite të padenja, skandale revistash, emisione speciale... Tani, secili, ose pothuajse, e ka kuptuar që korrupsioni ka prekur më thellë një Shtet neoliberal që, përmes shkatërrimit të shërbimeve publike, financon zhvillimin e interesave private. Ato, logjikisht, përfitojnë nga çdo «reformë» e angazhuar (privatizimet, fiskaliteti, pensionet).

Por korrupsioni, gjithashtu, është një sistem politik që u lejon elitave mondializuese të përfitojnë nga pasuritë nacionale ose t'i shkatërrojnë ato, t'i delokalizojnë duke përdorur shkëmbimin e lirë dhe parajsat fiskale. Dhe janë pikërisht qeveritë fajtoare që duke abuzuar me autoritetin e tyre, si në Liban, tregohen të paafte që të sigurojnë pastrimin e qyteteve që mbyten nga plehurat me rrezikun që të dëmtojnë më shumë cilësinë e ujit dhe mbijetesën e florës. Korrupsioni ka prekur ende pushtetet e goditura nga illegjitimiteti kur, si në Irak ato braktisin misionin thelbësor duke lënë shkollat afër plehrave atëherë kur në gjashtëmbëdhjetë vjet ekuivalenti i dy herë prodhimit të brendshëm bruto ka avulluar në xhepat udhëheqësve politikë dhe sipërmarrësve të krimbur. (3) Më në fund, nuk dihet më se çfarë termi duhet përdorur në Francë kur kryeministri konstaton me një emfazë të ngritur që spitali publik «*është në fazën e uljes në tokë, siç thuhet për një avion që nuk sjell gjë, por që po ulet*». «Të ulesh» në këtë rast do të thotë të nisesh me një rrotullim dhe të thyesh hundën. Z. Eduard Philip do të jetë ende në Matignon vitin e ardhshëm për të komentuar aksidentin dhe ngushëlluar prindërit e udhëtarëve?

«Ne duam një komb» shpallin irakenët që 450 viktimat të represionit nuk i kanë shkruar dhe që shoqërohen nga refuzimi i ndërhyrjeve të huaja dhe nga sektarizmi i një dëshire solidariteti, me qëllim që të ndërtojnë një shtet të denjë për këtë emër, domethënë të ndershëm (*lexo artikullin 18*). Në Kili, djepi i një neoliberalizmi lindur në gjak, represioni i karabinierëve (më shumë se 11 000 të plagosur, 200 të verbuar, 26 të vdekur) nuk e ka frenuar protestën. Dhe ajo valëvit, gjithashtu, ngjyrtat kombëtare. Ashtu si në Algjeri ku miliona manifestues kërkojnë që ushtria të reshtë së monopolizuari pushtetin, naftën, dhunën dhe simbolet e kombit.

Është akoma flamuri kombëtar që përzgjedhin «jelekverdhët», të dëshiruar që të paralajmërojnë kështu çdo ndarje të brendshme të rendit politik ose elektoral, ata, rugët e të cilëve ndryshuan deri në ditën kur zemërimi i tyre dhe kërkesat e tyre u takuan në rrethrotullimet e komunave të tyre. Kur ata shprehin një refuzim të tillë, grabitësit e tregut dhe të përçarjeve që ky ndërfit mes viktimave të tij,

Foto Hugo Morales



Nga protestat në Kili

Në lëvizjen kiliane, pa zëdhënës dhe që mbledh turma të stërmëdha, mospërfillja nuk mund të mos kursejë opozitën e majtë. Shumë shpesh ajo ka pasur frikë që të frikësojë me të vërtetë të djathtën «liberale»



Nga protestat në Kolumbi. Foto Roboting

kombëtarja duket pamje më e bukur. Dhe, më mirë akoma, ku mondializimi që i kundërvihet ka fyturën e traktateve të shkëmbimit të lirë, të gjigandëve numerikë që spiunojnë veprimet tona dhe rrisin fitimet e tyre. Apo bankat e biznesit që po përgatisin katastrofën e ardhshme financiare (nga e cila do të dalin të padëmtuara edhe njëherë më shumë). Apo Fondi Monetar Ndërmokbëtar, që, në Liban, në Egjipt, në Ekuador, në Haiti, në Greqi, në Sudan, në Argjentinë i imponon një popllsie të rrënuar ilaçe për kuaj.

Por mondializimi, të paktën, e ka një meritë: atë që të tregojë se në cilën pikë klasat drejtuese ngjajnë. Një bankier i vjetër drejton një vend, një miliarder shtatëdhjetëvjeçar një tjetër. A priori, gjithçka i dallon, përveç kësaj: një nga realizimet kryesore të njerit dhe tjetrit ishte që të favorizojnë fiskalisht të pasurit. E pastaj, kur drejtuesit lënë pushtetin, për kë punojnë ata? Ish-kryeministri francez, Fransua Fijo, artizani i një reforme të pensioneve në 2010, pastaj partizan i një sistemi pikëzimi për të «*ulur masën monetare të kontributeve të pensioneve*», punon tani për Bankën Barclays. Ashtu si z. Fransua Barua, të cilin shtypi (që e adhuron) e paraqet tani si kandidatin potencial të së djathtës në zgjedhjet e ardhshme presidenciale. Duke

pritur, ndoshta, që ai të mund t'i bëjë ballë të djathtës ekstreme, Barclays e ka ngarkuar që të «*udhëheqë blerësit e huaj në Hexagon*».

Z. Manuel Barroso, ish kryeministri portugez dhe ish-presidenti i Komisionit Europian, ka preferuar një bankë tjetër, Goldman Sachs. Disa javë më parë, ish-komisari i tij i numerikut, holandezi Neelie Kroes, u rekrutua nga Uber. Dhe ka një vit, Facebook-u i ka bërë ofertë një ish zv/kryeministri britanik, z. M. Nicholas Clegg, për drejtor të marrëdhënieve me publikun. Paga e tij do të duhet të kapë 4 500 000 euros në vit, pra gjashtëdhjetë herë më shumë sesa ai merrte si parlamentar. Manifestuesit janë vërtetë paranojakë kur pyesin se për cilët guvernatorë të ardhshëm punojnë ata tashmë? Dhe si duhet të reagojnë kilenët kur në shtatorin e fundit, ministri i tyre i financave, që u zgjodh nga president Piñera, ishte edhe ai vetë një miliarder si presidenti, si t'ua shpjegojë manifestuesve të pakënaqur, pra rritjen e çmimeve të artikujve ushqimorë që «*romantikët*» mund të blejnë gjithmonë vetëm lule sepse çmimi i tyre ka «*rënë*»?

Shembulli i Kilit është ulëritës. Me gjithë fundin e diktaturës ushtarake dhe një tranzicioni demokratik në të cilin kanë marrë pjesë

udhëheqës të së majtës, Kushtetuta e gjeneralit Augusto Pinoçet mezi u prek që nga viti 1980. Vendi ruan kështu korsinë e tij neoliberale të plotësuar me përfitime të interesave finaciare: pensione shtetërore, autorrugë urbane me pagesë, universitete private, shitje të burimeve ujore në formë aksionesh. Në lëvizjen kiliane, pa zëdhënës dhe që mbledh turma të stërmëdha, mospërfillja nuk mund të mos kursejë opozitën e majtë. Shumë shpesh ajo ka pasur frikë që të frikësojë me të vërtetë të djathtën «liberale». Për pasojë, që prej «El pueblo unido avanza sin partido» («Populli i bashkuar marshon pa u drejtuar»). Pa banderola partiake në manifestime, thjesht flamuri kombëtar dhe ai i popullit mapush, shënjestër e privilegjuar e represionit.

Megjithatë, atje si gjetiu, në veçanti në vendet arabe, një çështje shtrohet: dëshira për të mos u kompromentuar, refuzimi për të pasur drejtues, përfaqësues, janë ankoruar në një përvojë të gjatë të zhgënjimit, të dështimit dhe të tradhtisë. Por si mund të evitohet marginalizimi, lodhja apo thyerja nëse presioni popullor nuk gjen kurrë një rrugëdalje politike? Ngurtësimi i represionit juridik, policor dhe ushtarak, lidhjet gjithmonë e më të ngushta mes kapitalit dhe Shtetit parathënë që një debat i tillë duket i ndaluar. «Duhet të *organizohemi dhe të dimë ku do të shkojmë*, thotë Frederik Lordon, *sepse të tjerët janë organizuar dhe e dinë ku duan të shkojnë*» (4)

Duke pritur, ndërkohë që qysh prej tridhjetë vjetësh asnjë reformë strukturore esenciale e kodifikuar nga neoliberalizmi (shkëmbimi i lirë, tregu unik, privatizimet, çrregullimet financiare) nuk ka qenë vënë në diskutim nga ndonjë alternim elektoral, lëvizjet popullore të këtyre muajve të fundit, tashmë, mund të afishojnë një tablo të guetisë me pjatel: një regjim ra (Sudan), kryeministra dhanë dorëheqjen (Liban dhe Irak), një president i paafte nuk mundi të rifitojë (Algjeri), Kushtetuta të reja së shpejti do të mund të shpërthejnë arranzhimet e vjetra (ajo e Kilit mund të rishkruhet tërësisht). Sidomos, një brez i ri, shpesh i dënuar që të rimbursojë borxhin studentor, të jetojë në pasiguri dhe të mund të marrë një pension të gjymtuar, një mjedis i degraduar, zbulojnë betejën kolektive, solidaritetin dhe fitoren. Ajo që vjen më pas mbetet e hapur, por vetëm kjo përvojë, e jetuar prej dhjetëra milionë manifestuesish që tashmë ndjehen më të fortë dhe më me dinjitet, garanton që asnjë qeveri nuk do të mund t'i ofrojë neoliberalizmit shpresën e një rikthimi normal.

(1) Lire «Contre l'équité», *Le Monde diplomatique*, décembre 2010.
(2) Daniel Michaels et Paul Hannon, «Europe's neë jobs lack old guarantees – stoking workers' discontent», *The Wall Street Journal*, Neë York, 25 novembre 2019.
(3) «Pour Washington, l'Irak doit répondre aux revendications des manifestants», *Le Figaro* (avec l'Agence France-Presse), Paris, 29 novembre 2019.
(4) Frédéric Lordon, «Le capitalisme ne rendra pas les clés gentiment», *La pompe à phynance*, 22 novembre 2019, <https://blog.mondediplo.net>

Regjimi iranian ose një njeri që po mbytet, nuk ka frikë nga shiu

(First the bad news, then the good news...which may be even worse. - Slavoj Žižek)

NGA LEART KOLA*

Në një kafë në Tiranë kishin vënë një këngë të Elvis Presley.

Ajo - Bukur këndon ky!

Ai - Po, po, shumë bukur dhe tani po i këndon në ishull Tupacut, Hitler-it dhe Kasem Suleimanit.

Ajo: - Po Kasem Suleimani kush është?

Goxha çlirim kjo pyetje, logjika ta do të mendosh, që kjo Lufta e III-të Botërore mbase nuk është aq afër sa mendoja. Në fillim si tragjedi dhe më pas si farsë, thoshte Marksi. E di, e di, është shprehje klishe. Në fakt nuk ishte dhe aq klishe për lexuesin shqiptar, u bë e tillë kur e përdori Andi Bushati në një shkrim. Andi ka bërë klishe Albin Kurtin e lëre më Marksin. Sidoqoftë mbetet e vetmja shprehje, që mund të perfrazojë këtë situatë tensioni mes SHBA-ve dhe Iranit. Nuk ka luftë më të përqeshur në internet sesa kjo. I vetmi moment historik, mbase, me të cilin mund të krahasohet është kur ISIS pati idenë brilante të kërcënonte vendin tonë me atë tipin, që thoshte “*Vallaj ditë të zeza kanë me ardh për ju!*” Ditët e zeza erdhën, por për atë.

Vrasja e Gjeneral Kasem Suleimanit erdhi si atëherë kur amerikanët vendosën të ndërhyjnë në Lindjen e Mesme, në momentin më të pafavorshëm. Në Iran prej muajsh njerëzit ishin në shesh duke vendosur një precedent fantastik të ndryshimeve që vijnë nga brenda. Dhjetëra të vrarë e qindra të plagosur ishin një tregues që populli ishte ngritur kundra *ayatollahëve* dhe simbolit të tyre në

terren pikërisht Kasem Suleimanit. Vrasja e tij, në fakt, i shkon plotësisht për shtat regjimit ekzistues, sepse, siç e dimë nga historia, nuk ka mënyrë më të mire për të konsoliduar një qeveri në pushtet sesa lufta! Për të bërë një paralelizëm; të vrisje Kasem Suleimanin tani është si t'i bëje atentat Kico Mustaqit në prill të '92-shit, që ju prehtë shpirti në paqe! Edhe pse paralelizmi mes personave nuk është i qëlluar, askush nuk e mohon se, edhe për arsye politiko-ekonomike, ka një paralelizëm mes regjimeve që janë në rënje të lirë.

Gjenialitetin e politikës së jashtme amerikane ne e gjejmë gjatë gjithë kohës prezente në politikën iraniane njësoj si atëherë kur me një grusht shteti CIA hodhi kryeministrin e vetëm popullor dhe të ardhur nga një proces demokratik Mossadegh (fakt i provuar dhe pranuar, jo konspiracion) e sjelljen e SHAHUT në pushtet së bashku me policinë e tij sekrete, që e bënë shumë më të lehtë për ayatollahët, për ta hedhur këtë të fundit dhe instaluar një regjim autokratik fetar. Lufta e përgjakshme Irak-Iran, e frymëzuar plotësisht nga amerikanët, i ndihmoi në legjitimimin përfundimtar të këtij regjimi në shtëpi e zhdukur përfundimisht forcat progresiste të majta, që kishin marrë pjesë në përmbysjen e SHAH-ut e kishin akoma mbështetjen në popull; luftë kjo që prodhoi dhe Kasem Suleimanin e forcat *Quds*, të cilat shërbyen pak a shumë si agjentë provokatorë, për të gjithë zonën e tyre të influencës në Lindjen e Mesme. E, në fund, pikërisht ndërsa regjimi po përpëlitej, ja dhe një tjetër “dhuratë nga Qielli”.

tokratik fetar. Lufta e përgjakshme Irak-Iran, e frymëzuar plotësisht nga amerikanët, i ndihmoi në legjitimimin përfundimtar të këtij regjimi në shtëpi e zhdukur përfundimisht forcat progresiste të majta, që kishin marrë pjesë në përmbysjen e SHAH-ut e kishin akoma mbështetjen në popull; luftë kjo që prodhoi dhe Kasem Suleimanin e forcat *Quds*, të cilat shërbyen pak a shumë si agjentë provokatorë, për të gjithë zonën e tyre të influencës në Lindjen e Mesme. E, në fund, pikërisht ndërsa regjimi po përpëlitej, ja dhe një tjetër “dhuratë nga Qielli”.



Gjatë varrimit të gjeneralit iranian Kasem Suleimani. Foto Insider

Kasem Suleimani, sipas deklaratave edhe të policisë shqiptare, para se ta pësonte nga qielli kishte patur idenë brilante të kryente akte terroriste edhe në Shqipëri, por Ardi Veliu e kishte neutralizuar, për këtë gjë këtu tek ne nuk u fol shumë gjatë.

Ne në rajon kemi halle të tjera në fakt. Lufta e Tretë Botërore as nuk na hyn në sy fare. Në Kosovë nuk ka akoma qeveri, në Maqedoni ka qeveri provizore dhe në Shqipëri ka vetëm qeveri. E vetmja opozitë, që është akoma aktive është ajo e Muxhahedinëve Iranianë, e cila konsiston në disa mijëra vetë të dislokuar në një fshat të vogël mes Durrësit dhe Tiranës, që ka për detyrë të bëjë komente negative në internet kundra regjimit në Iran. Pak a shumë si grupi i të rinjve maqedonas në

Veles, që nëpërmjet profileve fallico bënëin fushatë për Donald Trump.

Ne në Shqipëri të gjithë problemet na vijnë nga opozitat. Madje edhe nga ato, që nuk janë vendase. Prej ekzistencës së kësaj opozite kreu i shtetit iranian na konsideroi “Një vend i vogël dhe i keq”?!! Kjo situatë, ne, shqiptarëve, na kapi pak të papërgatitur, se jemi mësuar që kërcënimet t'i bëjmë vetë. Kështu ka ndodhur kur kërcenonim Turqinë otomane, Italinë fashiste, Bashkimin Sovjetik, Kinën dhe vetëm para pak vitesh një njohje të vjetër të Iranit, Irakun. Atëbotë si aleat kryesorë të presidentit Bush. Sot, këtë e them dhe për të ndihmuar miqtë iranianë, politikën tonë të jashtme e udhëheq Amerika dhe në ndonjë rast specifik Erdogan, kështu që

Nëse regjimi iranian do të donte, fjala vjen, në një frymë reciprociteti të strehonte opozitën shqiptare, diku në periferi të Teheranit, ne do ishim më shumë se të kënaqur për ta e do kishim vetëm falenderime e për kërcënime as nuk do na shkonte ndër mend


nëse keni kërcënime të tjera mund t'ja adresoni drejtpërdrejtë përgjegjësit kryesor.

Por një fjalë do t'ua themi se na duket absurde që ne të konsiderohemi armik të Iranit, kur në fakt jemi i vetmi vend, që po strehon iranianë, të cilët nëse ju, të dashur lexues, do merrni numrin e 2-të të Le Monde Diplomatique në shqip, e do lexoni reportazhin e Ylli Patës do e kuptoni, që ata po kalojnë një jetë aq idilike në kodrat e buta të Tiranës, sa më shumë ngajnë me Budhistë sesa me luftëtarë muxhahedinë. E nëse regjimi iranian do të donte, fjala vjen, në një frymë reciprociteti të strehonte opozitën shqiptare, diku në periferi të Teheranit, ne do ishim më shumë se të kënaqur për ta e do kishim vetëm falenderime e për kërcënime as nuk do na shkonte ndër mend. Madje, nëse nuk do donin t'i merrnin të gjithë se helbete i kanë dhe shpenzimet e larta, mund të sugjeroja Sali Berishën vetëm, ai tashmë është një njeri digjital, gjithçka i duhet është një atmosferë urrejtje dhe një kompjuter.

E fundit dhe më e rëndësishmja, siç bota mbarë e di, por me sa duket akoma jo kreu i shtetit iranian, Shqipëria më datë 1 Janar, mori drejtimin e OSBE-së e do ta mbaj atë për plot një vit. Ky vit është po ashtu edhe vit zgjedhor në SHBA ku në diskutim është rizgjedhja e presidentit Trump. Matematikën mund ta bëjnë vetë, por ajo që duket e sigurtë është që Hassan Rouhani nuk do ta konsumojë hashuren e fundvitit me këtë sjellje. Kjo do të thotë, që nëse brenda këtij viti Irani do të ketë zgjedhjet e para demokratike pas shumë dekadash diktature, gjejeni pak kush do i organizojë? Megjithatë siç thotë dhe një proverb iranian: “Një njeri që po mbytet, nuk ka frikë nga shiu”.

*Autori është drejtor i Institutit të Studimeve Sociale dhe Humane në Tiranë

Nga brenda betejës



Botuar në 1963, *Herën tjetër, zjarri* (The Fire Next Time), - një titull që do të bëhet legjendë – e ngriti shkrimtarin Xhejms Balduin në rolin e zëdhënësit të lëvizjes për të drejtat qytetare, e cila shkundi Shtetet e Bashkuara nga 1954 deri në vitin 1968 dhe u përhap më vonë në gjithë botën. Në këtë letër drejtuar nipit të tij, Balduini shpjegon më së miri itinerarin e tij dhe atë çka do të thotë të jesh me ngjyrë në Shtetet e Bashkuara: “Çmimi i emancipimit të të Bardhëve, është emancipimi i Njerëzve me Ngjyrë”. Në ditët e sotme është ribotuar ky tekst i shoqëruar me fotografi të mrekullueshme bardh e zi të Stiv Schapiros, që ishte miku dhe shoku i tij i angazhimeve.

Që të dy i ranë kryq e tërthor vendit kur iu desh të përgatisnin një reportazh për revistën *Life*, duke u ekspozuar ndaj sulmeve të Jugut racist. Duke dokumentuar kushtet e jetës në geto dhe çastet më të spikatura të luftës, duke ofruar portrete të liderve si Martin Luter Kingu apo Roza Parks, si dhe tekste të Xhon Levis, një aktivist i rëndësishëm i të drejtave qytetare, të Balduinit, të motrës së tij, Gloria Karefa-Smart dhe të Schapiro-së, vepra ndihmon në vlerësimin e përmasave të një beteje të bërë e cila përmbledh sfida gjithnjë e më të mëdha. Figura e Balduinit që sot zgjon një kthim interesi, u kërkua pikërisht nga lëvizja e *Black Lives Matter*. **MARINA DA SILVA**

SI I RIMBURSON DREJTËSIA AMERIKANE VIKTIMAT

Disa jetë më të çmuara se të tjerat

Kur dikush pëson një dëmtim, drejtësia duhet të vendosë shumën e rimbursimit që personi duhet të marrë. Në Shtetet e Bashkuara, për këtë gjë, drejtësia mbështeten në disa kritere: si paga e tij, jetëgjatësia ... Pabarazitë që ekzistojnë në shoqëri ndikojnë mekanikisht mbi kompensimet, aq sa, një noter paguhet më shumë se një infermier, një i bardhë më tepër se një njeri me ngjyrë, një burrë më tepër se një grua etj...

NGA CHARLOTTE RECOQUILLON*

Kur ajo u vendos bashkë me të shoqin në maj të vitit 2011 në një apartament të saporinovuar të Bruklinit, në Nju Jork, znj. Niki Hernandez-Adams ishte shtatzënë. Pesëmbëdhjetë muaj më vonë, një analizë rutinë mjekësore zbuloi te i porsalinduri nivele aq të larta të plumbit në gjak sa që pasojat në shëndetin e tij ishin të pakthyeshme. Nëna e re vendos të bëjë padi ndaj pronarit të apartamentit me qëllim përfitimin e një kompensimi ndaj dëmit të shkaktuar dhe interesave. (compensatory damages)[1]

Pas një beteje gjyqësore prej katër vjetësh, pronari u shpall fajtor (2). Gjykata duhet të vendosë shumën e zhdëmtimit që do të përfitojë viktimat. Për këtë gjë, gjykatësit dhe anëtarët e jurisë u mbështeten në dëshmitë e ekspertëve të ngarkuar nga paditësi, nga njëra anë, dhe nga i akuzuari, nga ana tjetër, në mënyrë që të vlerësonin dëmin ekonomik të shkaktuar, ku përfshihen shpenzimet e mundshme mjekësore apo dhe të funeralit, dëmet materiale si dhe të ardhurat e humbura nga një plagosje, ndonjë handicap apo vdekje. Me qëllim që të mbështesin vlerësimet e tyre, ekspertët marrin në konsideratë kritere, me gjasë, objektive si: paga e viktimës (ose e familjes së saj, nëse bëhet fjalë për një fëmijë), numri e viteve të punës që duhet të kryejë në vazhdim, jetëgjatësia ... Mekanikisht, pabarazitë që ekzistojnë në shoqëri ndikojnë në shumën për dëmtimin dhe interesat. Një pastrueseje të goditur nga një makinë që do t'i ndalohej puna për tre muaj, i propozohet një zhdëmtim më i vogël sesa një agjenti imobiliar në të njëjtën gjendje.

Në rastin e djalit të znj. Hernandez-Adams, avokatët e familjes kërkuar diku tek 2, 5 – 4 milionë dollarë, ose sipas vlerësimit të tyre, shumë që viktimat do të kishte fituar gjatë jetës së vet nëse nuk do të ishte helmuar me plumb. Mbrojtësit e pronarit të banesës bëjnë një tjetër përlllogaritje. Fëmija, meqë ishte me origjinë hispanike, argumentuan ata, kishte pak mundësi të kryente studimet dhe të ndërtonte një karrierë që do t'i lejonte të mblidhte një shumë të tillë. Ata propozojnë një zhdëmtim më të ulët: diçka tek 1, 5 -2, 5 milionë dollarë. Avokati i viktimës replikon duke pohuar se «popullsia hispanike ka një prije më të fortë për të arritur një nivel arsimimi më të lartë se ai i prindërve të tyre.» Juria vendos për një zhdëmtim prej 1, 9 million dollarësh, pas përjashtimit kategorik të kriterit racor – diçka jo fort e zakonshme në gjykatat amerikane – nga gjykatësi Jack B.Weinstein. «Kategoria hispanike» është shumë e përgjithshme. (...) ka profesorë dhe kopshtarë (...) nuk mund ta konsideroni fëmijën sipas mesatares të hispanikëve, por duhet të merrni në konsideratë karakteristikat specifike, si diplomat e nënës, vendin ku ajo jeton, familjen e saj, etj..., - i urdhëroi ai anëtarët e jurisë.



Foto nga Cameron Casey, Pexels

Në prill të vitit 2019, gjashtëmbëdhjetë organizata të mbrojtjes së të drejtave civile i dërguan një letër të hapur NAFE-së, duke i kërkuar që të dënojnë publikisht marrjen në konsideratë të të dhënave mbi racën dhe gjininë në përlllogaritjen e zhdëmtimeve për dëmtim moral apo fizik

«DISKRIMINIMET JANË TË PRANISHME KUDO»

Gjithashtu, drejtësia autorizon marrjen për bazë të seksit dhe të racës së një viktime dhe, për më shumë, atë të nivelit të saj social në përlllogaritjen e dëmit dhe të interesave. E thënë ndryshe, për të njëjtin dëm dhe me një status social të barabartë, gratë dhe minoritetet përfitojnë më pak sesa burrat dhe se të bardhët. «Dizavantazhet e njerëzve me ngjyrë dhe grave në Shtetet e Bashkuara në qasjen e tregut të punës reflektohen në shumën e rimbursimit që ata marrin», - përmbledhin juristët Ronen Avraham dhe Kimberly Yuracko. (2) Në vitin 2019, në Shtetet e Bashkuara, të ardhurat mesatare të femrave paraqisnin 82,3% të atyre të meshkujve; të ardhurat e njerëzve me ngjyrë, 74,9% të atyre të meshkujve të bardhë; një mashkull aziatik fitonte mesatarisht 30% më shumë se një mashkull i bardhë (2), etj. Të gjitha këto të dhëna, të mbledhura nga administrata, u transformuan në tabela që shërbejnë si referencë për vlerësimet e ekspertëve, veçanërisht kur viktimat janë të reja dhe pa ndonjë historik karriere.

Pjesa më e madhe e negociatave midis paditësit dhe të akuzuarit bëhen me dyer të mbyllura dhe është e zorshme të masësh në mënyrë të saktë peshën e këtyre tabelave. Ndodh që gjykata hedh poshtë përdorimin e kritereve të seksit dhe racës, siç qe rasti për fondin e zhdëmtimit të viktimave të 11 Shtatorit, që nën presionin e të zgjedhurve dhe shoqatave, vendosi të mbështetej në tabelat mashkullore dhe tabelat e të bardhëve – më të favorshmet – për të gjitha viktimat. «Praktika [për të diskriminuar sipas seksit dhe origjinës etnike] është e përhapur, por jo sistematike», - na shpjegon Martha Chamallas, profesoreshë e së drejtës në universitetin e Ohajos dhe autore që në vitin 1994, të punëve të para mbi këtë temë. Në vitin 2009, 92% e ekspertëve të pyetur nga Shoqëria kombëtare e ekonomistëve juridikë (National Academy of Forensic Engineers, NAFE) deklarorin se merrnin në konsideratë gjininë e viktimës, dhe 44,1% atë të racës. «Po të më pyesni nëse diskriminimet racore janë të përhapura në sistemin gjyqësor, do t'ju thoja që po, janë të pranishme kudo», - deklarorin vetë z. Lee Merritt. Ky avokat që aderorin në gjirin e lëvizjes Black Lives Matter («Jeta e njerëzve me ngjyrë vlen»), krahason dy raste të fundit. «Në korrik të vitit 2017, Justine Damond, një profesoreshë

joge australiane dhe e bardhë, u vra nga një polic me ngjyrë në Minneapolis. Meqë ishte punëdhënëse e policit, bashkia e Minneapolis-it i akordoi familjes së viktimës, në maj të vitit 2019, një zhdëmtim rekord prej 20 milionë dollarësh.» Në të njëjtën moment, z. Merritt mbron te familjen e Jordan Edwards, një adoleshent me ngjyrë që u vra nga një polic i bardhë nga Dallasi në prill të vitit 2017. I deklaruar fajtor, agjenti mori një dënim prej pesëmbëdhjetë vitesh burg. Por bashkia e qytetit, vazhdon të refuzojë çdo lloj forme zhdëmtimi.

NJË KUNDËRSHTIM GJITHMONË E NË RRIJJE.

Marrja në konsideratë e kritereve të mjedisit shoqëror, e racës dhe seksit vlen sa një formë me dënim të dyfishtë. Familjet e varfëra, midis të cilave minoritetet janë të mbipërfaqësuar, rrezikojnë p.sh të pësojnë një ekspozim ndaj plumbit më tepër se shtresat e kamura : ato janë gjithnjë të detyruara të zgjedhin lagjen dhe strehimin e tyre, ndërsa aktiviteti ndotëse vendosen më shpesh në territorret e populluara, ku pushteti i politikës (pra pushteti i opozitës) së banorëve është i dobët... Pastaj në rast helmimi, ato zhdëmtohen më pak. Avraham dhe Yuracko vlerësojnë faktin se marrja në konsideratë e tabelave demografike në përlllogaritjen e zhdëmtimeve dhe interesave, do mund të nxiste ndërmarrjet që të përqëndronin rreziqet në lagjet jo të bardha dhe të varfra. Për të vërtetuar hipotezën e tyre, ata paraqesin rastin (fiktiv) të një ndërmarrjeje shpërndarëse PhedEx që do të kishte interes t'i nxiste shoferët e saj t'i jepnin makinës më ngadalë në lagjet e të bardhëve – meqë atje penalitetet financiare në rast aksidenti janë më të larta – dhe të përshkonin sa më shpejt rrugët e tyre, të përzgjidhnin itineraret që kalonin në lagjet e njerëzve me ngjyrë, duke shtuar njëkohësisht sikletet dhe rrezikun.

Po aq të përhapura sa dhe diskrete, këto praktika diskriminuase ranë në sy kohët e fundit. Në vitin 2016 senatorët demokratë Cory Booker dhe Kirsten Gillibrand depozituan një projekt-ligj, *The Fair Calculation Act*, që synonte të ndalonte përdorimin e kritereve të racës dhe të gjinisë në rangun federal. Por teksti nuk u mor kurrë në konsideratë. Lëvizjet Black Lives Matter dhe #MeToo e zgjeruan më shumë kundërshtinë e këtyre praktikave diskriminuase, duke denoncuar pabarazitë social-ekonomike që janë në themel të pabarazive të rimbursimit.

Në prill të vitit 2019, gjashtëmbëdhjetë organizata të mbrojtjes së të drejtave civile i dërguan një letër të hapur NAFE-së, duke i kërkuar që të dënojnë publikisht marrjen në konsideratë të të dhënave mbi racën dhe gjininë në përlllogaritjen e zhdëmtimeve për dëmtim moral apo fizik. Ato morën një refuzim kategorik. Në planin legjislativ, Kalifornia u bë në vitin 2019, shteti i tretë që e ndalon këtë praktikë, pas Karolinës së Veriut dhe Nju Xhersit. Në nivel federal, një projektligj i ri është duke u studiuar në Kongres që në muajin shtator. Edhe pse nuk ka asnjë shans që të votohet nga Senati – ku republikanët kanë shumicën –, ai dëshmon përparime të pakta në debatin publik. Por janë të rallë zërat që rekomandojnë braktisjen e kriterit social. Mbetet në fuqi që, nëse dy adoleshentë vdesin në të njëjtin aksident me makinë, familjet e tyre mund të zhdëmtohen në mënyra të ndryshme, në bazë të profesionit të tyre apo dhe nivelit të studimeve.

[1] Këto rimbursime për dëme dhe interesa dallohen nga gjokat që mund t'u vihen autorëve të krimeve dhe vrasjeve.

[2] GMM vs. Kimpton, n° 13-CV-5059, 30 korrik 2015. Cf. Gjithashtu Kim Soffen, « In one corner of the law, minorities and women are often valued less », The Washington Post, 25 tetor 2016.

[3] Ronen Avraham dhe Kimberly A. Yuracko, « Torts and discrimination », Ohio State Law Journal, vol. 78, n° 3, Columbus, 2017.

[4] «Median usual weekly earnings of full time wage and salary workers», Bureau of Labor Statistics, United States Department of Labor, Washington, DC, tetor 2019.

[5] Michael Brookshire, Michael R. Luthy dhe Frank Slesnick, «A 2009 survey of forensic economists: Their methods, estimates, and perspectives», Journal of Forensic Economics, vol. 21, n° 1, Mount Union (Iowa), dhjetor 2009.

PROTESTA NGA BEJRUTI NE BAGDAT

Në rrënjët ekonomike

Në kontekstin e një krize të madhe ekonomike, popullsia libaneze pushtoi sheshet për të kërkuar reforma të thella, si dhe fundin e klientelizmit dhe të korrupsionit të elitave politike. Ngadalësimi i rritjes ekonomike dhe ulja e prurjeve në valutë të huaj e çuan vendin drejt rrezikut të falimentimit.

NGA HAJAR ALEM DHE NICOLAS DOT-POUILLARD *

Më 17 tetor 2019, ministri libanez i telekomunikacionit, Z. Mohammad Choucair, vendosi të caktojë një taksë mujore – të quajtur – «taksa Whats-App» - prej 2 dollarësh në të gjitha aplikacionet telefonike falas. Po atë mbrëmje, me qindra të rinj manifestues, më së shumti nga klasat e varfëruara, zbritën në rrugët e qyteteve të mëdha. Të nesërmen, ata bllokuan arteriet kryesore të vendit dhe organizuan rrjetin e

protestave, qëndrime ulur në vendet emblematike, si në sheshin Martyrs në Bejrut. Qeveria mbylli menjëherë zyrat e administratës, universitetet dhe shkollat publike – duke inkurajuar në mënyrë paradoksale gjithmonë e më shumë njerëz që të zbrisnin në rrugë. Mbyllja e bankave libaneze gjatë dy javëve që pasuan lindjen e kryengritjes, ushëu zemërimin popullor, dhe depozuesit nuk kishin mundësi të tërhiqnin paratë e tyre.

Rritja në pikën e vdekjes

Dy muaj më vonë, manifestuesit këmbëngulnin. Ata kërkonin përsëri rrëzimin e regjimit të kastave fetare, bazuar në ndarjen publike të pushtetit midis shiitëve, sunitëve dhe të krishterëve. Asnjë lloj zgjidhjeje nuk u gjet në boshllëkun qeveritar dhe kryeministri Saad Hariri dha dorëheqjen më 30 tetor 2019, duke e braktisur idenë për të formuar më vonë një «qeveri teknokratësh».

Taksa «whatsApp» nuk është tjetër veçse një shkëndijë që ndezi zjarrin në një vend ekonomikisht të venitur dhe veçanërisht të pabarabartë: 1% e libanezëve me më shumë fat kanë 40% të pasurive dhe marrin 23 për qind të të ardhurave kombëtare sipas një studimi të Laboratorit në lidhje me pabarazitë në botë (1). Libani ndodhet gjithashtu pranë falimentimit. Borxhi i Shtetit paraqet 150% të prodhimit të brendshëm bruto (PBB) ndërkohë që deficiti i tij publik është 11%. Shërbimi i borxhit (pagesa e interesave dhe një pjesë e shumës së huazuar) arrin në 4 miliardë dollarë çdo vit. Rritja e ekonomisë është në pikën e vdekjes – rreth 0, 2 % në vitin 2018. Vendi gjithmonë e më pak arin të mbulojë nevojat në valutë për të paguar importet e tij të shumta (veçanërisht të lëndëve djegëse, të ilaçeve dhe të drithërave), që janë katër herë më shumë se niveli i eksporteve të tij. Prurja e kapitaleve të diasporës dhe të investimeve të huaja nuk mjaftojnë më që të mbajnë stabil sistemin: fondet dalin tashmë më shpejt sesa hyjnë.

Që në vitin 2011, lufta civile në Siri ndikoi, gjithashtu, për keq në sektorin e bujqësisë tashmë shumë i brishtë, sidomos në zonat periferike si Bekaa dhe distrikti Akkar. Këto

zona kufitare, ndër më të varftrat në Liban, mbijetonin mirë apo keq, falë tregtisë me qytetet siriane si Homs. Për më shumë, me rënien e çmimit të naftës në vitin 2014, flukset financiare që vinin nga vendet e Gjirit, shteruan – ashtu si turizmi saudit, katarist apo dhe i emirateve. Që me ardhjen në pushtet të Z. Donald Trump, forcimi i sanksioneve amerikane për bankat libaneze që akuzoheshin se kishin marrëdhënie me partinë Hezbollah, parti shiite në luftë me Izraelin, rëndoi mbi ekonominë, shtylla kryesore e së cilës është sektori bankar. Kështu, në gusht të vitit 2019, *Jammal Trust Bank* u akuzua nga thesari amerikan se mbështeste Hezbollahin dhe Iranin. Kapitali i saj në Shtetet e Bashkuara u ngri, dhe transaksionet në dollarë u ndaluan. Banka filloi një proces likuidimi në shtator të vitit 2019.

Për t'i bërë ballë shkatërrimit ekonomik të vendit, kryeministri Hariri kishte premtuar në maj të vitit 2019 një regjim të ashpër kursimi «të paparë». Ai duhej të kënaqte, gjithashtu, huadhënësit e tij ndërkombëtarë. Për të marrë një hua në formë ndihmë prej 11,2 miliardë dollarësh për zhvillimin e infrastrukturave – me përqindje interesi të kufizuar – premtuar gjatë Konferencës ekonomike për zhvillimin e Libanit nga reformat me ndër-marrjet (Cedre), që u zhvilluan në Paris në prill të vitit 2018, qeveria u angazhua të ulte deficitin e saj buxhetor me 1% të PBB në pesë vitet e ardhshme; një zotim pothuajse i pamundur për t'u mbajtur. Buxheti i 2019-s, i ratifikuar nga Parlamenti në muajin korrik, nuk favorizonte, veçanërisht, funksionin publik: si ngrirje të rekrutimeve (përfshi këtu dhe në ushtri), ndalim i daljeve të parakohshme në pension gjatë tre vjetëve, pakësim të ndihmave shkollore për fëmijët e funksionarëve.



Lebanese protesters hold a sign fighting a proposed WhatsApp tax.

Taksa «whatsApp» nuk është tjetër veçse një shkëndijë që ndezi zjarrin në një vend ekonomikisht të venitur dhe veçanërisht të pabarabartë: 1% e libanezëve me më shumë fat kanë 40% të pasurive dhe marrin 23 për qind të të ardhurave kombëtare sipas një studimi të Laboratorit në lidhje me pabarazitë në botë

mujore prej 1,5% mbi pensionet e tyre. Më 20 maj, këta veteranë, provuan të pushtojnë Parlamentin për të kundërshtuar uljen e pensioneve. Përgjatë gjithë verës, ata bllokuan disa rrugë të kryeqytetit, duke u përballur edhe me ushtarë në shërbim, që ruanin institucionet kryesore. Një javë para kryengritjes popullore të 17 tetorit, ata u mobilizuan sërish para ministrisë së financave: ata denoncuan mospagimin për nëntë muaj me radhë të pensioneve të pensionistëve të sapodalë, nga ushtria.

për të luftuar kundër korrupsionit dhe «parave të pista». Kështu formacioni i vet presidentit u godit nga ngjarjet e 17 tetorit të vitit 2019. Tetë ditë më vonë, dy deputetë të LPL-së shpallën tërheqjen e tyre nga blloku i tij parlamentar si dhe Z. Chamel Roukoz, dhëndrri i udhëheqësit të shtetit, dhe një gjeneral i vjetër shumë popullor në radhët e ushtrisë.

Lëvizja shoqërore që lindi në tetor të vitit 2019 doli në mënyrë direkte nga politikat e masave shtërnguese, nga impakti i tyre mbi funksionet publike dhe shtresat e mesme, por edhe nga rritja e vazhdueshme e taksave, që prek në mënyrë të veçantë klasat popullore. Taksa «Whats-App» u pezullua nga qeveria pas manifestimeve, por sërish ngelën që në vitin 2017 një rritje e taksave mbi TVSH-në nga 10 në 11%, si dhe një seri taksimesh mbi duhanin dhe alkoolin. Kjo lëvizje është gjithashtu frut i një ankese anonime kundër korrupsionit të elitave politike, dhe kundër mungesës së shërbimeve publike cilësore: 20% e libanezëve nuk kanë ujë të pijshëm dhe ndërprerjet e energjisë

«Jo pushtetit të financës»

Mobilizimi i tyre ngjalli një simpati të fortë në opinionin publik dhe i shtyu të luanin rolin e ngritjes së alarmit kundër ashpërsimit të masave. Në konfliktet politike që shkatërruan Libanin, ushtria është konsideruar shpesh si asnjënjë, si pak e influencuar nga fjalimet publike dhe është parë gjithmonë si garantja e një

sigurie gjithmonë e më të brishtë. Një tjetër efekt i dukshëm i lëvizjes: vuri në vështirësi presidentin e republikës, dikur gjeneral. Z. Michel Aoun i parë është mjaft popullor për shumë oficerë dhe pensionistë të ushtrisë, për solidarizim me trupën ushtarake. Por, partia e tij, Lëvizja Patriotike e lirë (LPL), është akuzuar gjithashtu se nuk i kreu reformat e nevojshme

*Respektivisht gazetar dhe kërkues në shkencat politike, Bejrut

të kryengritjes libaneze



Foto Nadim Kobeissi

Protesters blocking access to the Ring bridge in Beirut, Lebanon. October 26, 2019.

elektrike zgjasin tre orë në Bejrut dhe deri në dymbëdhjetë orë në pjesën më të madhe të krahinave.

U vu gjithashtu në diskutim plotfuqia e bankave. «*Jo pushtetit të financës*», ishte një nga parrullat e lëvizjes. Nga Bejruti në Nabatiyyeh (Libani jugor), duke kaluar për në Tripoli, në Veri, manifestimet sa vinin dhe shumëfishoheshin që prej dy muajsh përpara zyrave të Bankës së Libanit dhe institucioneve të tjera kryesore financiare të vendit. Këto të fundit zotërojnë 35, 3% dhe 40, 1% të borxhit publik. Në fakt që nga

fundi i luftës civile (1975-1990), zotimi i kryeministrit të dikurshëm Rafik Hariri (vvarë më 2005) dhe elitave politike ka qenë financimi i rindërtimit përmes marrjes së borxhit, veçanërisht nga Shteti, pranë bankave (disa prej të cilave i kishin politikanë), që edhe ata vetë kanë përfituar nga përqindjet e larta të interesit.

Një pretendim i ri lindi në Liban, si pasojë e manifestimeve të fundit ishte: të ristrukturohej borxhi i brendshëm pranë bankave me qëllim që të shpëtohej ekonomia, të lehtësohej

Ulja spektakolare e papunësisë fshihet në fakt pas punonjësve të paguar keq dhe pak të kualifikuar

Plani i “shpëtimit” i FMN -së

Ristrukturimi i borxhit, kundërshtimi i privatizimeve, kalimi nga një sistem rentier dhe importues i të mirave materiale dhe i prodhimeve drejt një sistemi produktiv, me politika rishpërndarjeje përkundërt shtresave në nevojë, këto ide ecën përpara që nga 17 tetori i vitit 2019. Por, me disa kufizime: disa përbërës të lëvizjes kënaqen duke imagjinuar një kapitalizëm libanez “të pastër”, ku lufta kundër korrupsionit dhe një ligj i ri elektoral do të mjaftonin për të shmangur të gjitha të këqijat e vendit. Kësaj i shtohet edhe fakti se shumë parti fetare dolën kundër Hirakut. Në fillim të tetorit, pas disa ditë hezitimesh, Hezbollahu u kërkoi ndjekësve të tij të tërhiqeshin nga lëvizja, ndërkohë që u kryen shumë manifestime në jug të Bejrutit dhe të vendit, në zona ku ndikimi i partisë është i madh. Më 25 tetor, gjithmonë duke njohur ligjshmërinë e disa pretendimeve sociale, Z. Hassan Nasrallah, sekretar i përgjithshëm i partisë shiite, paralajmëroi libanezët për boshllëkun në krye të Shtetit, dhe denoncoi një «komplot» të nxitur nga armiq të vendit. Si rrjedhojë, militantët e partisë sulmuan disa herë grupimet e hirak-ut, duke i detyruar forcat e rendit të ndërhyjnë. Partia Hezbollah që pretendon të marrë pjesë në çdo qeveri të re, ka prioritet mbrojtjen e presidencës së Z. Aoun, të cilin e konsideron që prej vitit 2006 si aleatin më besnik që i siguron një mbrojtje politike, në kohën e sanksioneve amerikane kundër organizatës shiite, dhe në një kontekst tensionesh të shpeshta me Izraelin në Libanin jugor.

borxhi i shtetit dhe të riorientohej një pjesë e buxhetit të tij në favor të klasave popullore. Në një vend ku liberalizmi është mbret, idesë nuk i mungon guximi. Kjo ide është hedhur nga rrymat politike më pranë të majtës së Hirak - ut (kryengritjes), si *Partia Komuniste libaneze*; Lëvizja e qytetarëve dhe qytetareve në një shtet, drejtuar nga ministri i dikurshëm i punës Charbel Nahas – një nga përgjegjësit e rrallë politikë që nuk u përçmua nga turma e protestuesve - ; *Lëvizja e të rinjve për ndryshim* ; *Lëvizja e popullit* drejtuar nga deputeti i dikurshëm nacionalist arab Najah Wakim ; *Organizata popullore naseriane* e Z. Oussuma Saad, deputet i Saidas. Këto parti i dolën kundër edhe një politike të privatizimit që mundohet të shesë me çmim të ulët ndërmarrjet e fundit shtetërore. Më 21 tetor të vitit 2019, Z. Hariri, ende shef i kabinetit qeveritar, iu përgjigj pozitivisht ankësive të manifestuesve duke premtuar mbajtjen e zgjedhjeve legjislatve të parakohshme dhe lajmëroi, vepër i paparë ndonje herë, se bankat libaneze do të kontribonin në uljen e deficitit buxhetor. Por ai kishte ndërmend, gjithashtu, privatizimin krejt apo të pjesshëm të kompanisë së aviacionit kombëtar, të telekomit, të portit të Bejrutit apo të Kazinosë së Libanit – të gjitha, pa përmendur as perspektivën më të vogël për rishpërndarje sociale.

Ndryshe nga Hezbollahët, nga aleatët e tyre, lëvizja Amal apo Lëvizja Patriotike e Lirë, të tjera parti komuniste, shpallën pretendimet e tyre në lidhje me kundërshtimin si p.sh kundër një qeverie teknokratësh të pavarur. Përmendim këtu rastin e Forcave libaneze (të krishtera), apo të Partisë socialiste progresiste (druze) të Z. Walid Joumblatt.

Tashmë, Libani mund të përshkojë tri rrugë të ndryshme. Mund të zgjedhë drejtësinë më të madhe rishpërndarëse – një perspektivë e sjellë nga formacionet e pozicionuara më majtas në këtë lëvizje. Mund të kthehet gjithashtu dhe tek disa logjika të solidaritetit publik. Në një kontekst krize totale të ekonomisë, nuk përjashtohet mundësia që partitë fetare, të bëjnë në të ardhën një kthim të madh: në mungesë të një Shteti që siguron rishpërndarjen, pra vetëm ata mund të sjellin një të ardhur për mbijetesë për shtresat e defavorizuara. Së fundmi shtrohet edhe një rrugë e tretë: ai i një plan «shpëtimit» të menjëhershëm të një vendi në falimentim të hartuar nga Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN). Kjo e fundit do të kishte një kosto: atë të politikave shtërnguese akoma më të forta, dhe të një «vendi si plaçkë tregu», ku pasuritë e fundit publike do të privatizoheshin. Dhe një pasojë: do të nxiteshin lëvizje kundërshtuese akoma dhe më radikale.



Demonstres libaneze. Foto ZUMAPRESS

[1] Justine Babin, « Lydia Assouad: “Tre mijë individë fitojnë sa 50% e libanezëve më të varfër” », Le Commerce du Levant, Bejrut, 1 nëntor 2019.
[2] Nicolas Offenstadt, *Vendi i zhdukur. Në gjurmët e RDGJ-së*, Botimet Gallimard, kolona. «Fleta e historisë», Paris, 2019 (edicioni i parë: 2018).

SINDIKATA E RE E MINATORËVE NË BULQIZË

Kromi i oligarkisë

Themelimi i sindikatës së re nga minatorët e Bulqizës ka rishfaqur çështjen e të drejtave dhe statusit të minatorëve. Aksidente fatale, pushime nga puna, ulje pagash, miniera e kromit të Bulqizës vazhdon të jetë sinonim i shfrytëzimit të minatorëve për përfitimet private të oligarkisë së lidhur me politikën.

NGA SAMI CURRI

Pas më shumë se tetë vitesh, minatorët e Bulqizës u rikthyen sërish në sheshin e protestës. Para hyrjes për në punin e shfrytëzimit të kromit në Minierën e Bulqizës. Në protestat e vitit 2011 ishte vendi i përplasjeve ndërmjet policisë dhe minatorëve. Sot, Miniera e Kromit në Bulqizë administrohet nga kompania Albchrome e Samir Mane, pjesë e BALFIN grup. Të zhgënjyer nga puna e sindikatës ekzistuese të cilët minatorët e konsiderojnë si palë me firmën dhe që nuk mbrojnë interesat e minatorëve, këta të fundit themeluan një sindikatë tjetër. Albchrome është

kompania që ka numrin më të madh të të punësuarve në sektorin minierar, afro 650 punonjës. Në të gjithë zonën mineral-mbajtëse të Bulqizës dhe Martaneshit, sipas të dhënave nga Zyra e Punës në Bulqizë janë të punësuar afro 2100 persona, ku përpos Albchrome operojnë edhe 36 subjekte të tjera minierare. Sipas të dhënave të bëra publike nga BIRN, prej vitit 2014 në galeritë e kromit në Bulqizë dhe Martanesh, kanë humbur jetën 27 persona dhe shumë të tjerë janë plagosur gjatë punës në minierë.



“Diktatura moderne”

Puna për themelimin e sindikatës së Minatorëve të Bashkuar të Bulqizës do të niste që në muajin prill të vitit 2019. Themelues do të ishin 39 minatorë. Pas ndjekjes së procedurave ligjore, më 15 nëntor 2019-të Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë do ta njohte zyrtarisht sindikatën. Dy ditë më vonë në qendër të Bulqizës do të bëhej edhe shpallja publike e sindikatës. Vetëm pesë ditë pasi

sindikata ishte themeluar dhe njohur nga Gjykata e Tiranës, kompania Albchrome do të shkarkonte nga puna kreun e sindikatës të Minatorët e Bashkuar të Bulqizës, Elton Debreshi. Disa minatorë të tjerë pjesë e sindikatës do të paralajmëroheshin për pushim nga puna. Debreshi tregon se për themelimin e sindikatës kanë ndjekur të gjitha hapat e nevojshëm ligjor dhe se sindikata ekzistuese në Minierën e Kromit

në Bulqizë, pjesë e Konfederatës të Sindikatave të Shqipërisë të drejtuar nga Kol Nikollaj, ka humbur kontaktin me minatorët dhe nuk mbrojnë më interesat e punëtorëve, por është palë me kompaninë. “Themelimi i kësaj sindikate ka ardhur si nevojë sepse laku minatorëve të Bulqizës ju ka ardhur në fyt. Nuk mban më.

Që një punëtorë të futet mbi 1000 metër nëntokë dhe të paguhet 350 mijë lekë të vjetra në muaj dhe një trajtim ushqimor prej 150 mijë lekë të vjetra është e papranueshme. Minatorët që prej vitit 2011 nuk kanë pasur rritje page, por vetëm ulje”, tregon Debreshi. Ky i fundit ka disa breza të familjes së tij që punojnë

në Minierën e Kromit në Bulqizë. Është babai i katër fëmijëve dhe që prej dhjetorit të vitit 2019 është i papunë. “Unë jam minator, babain e kam minator, edhe gjyshin ka punuar një jetë minator. Jam brezi i tretë në familjen time që punoj në atë galeri edhe i dimë shumë mirë hallet, se në familjet tona nuk



Elton Debreshi

“Jam brezi i tretë në familjen time që punoj në atë galeri edhe i dimë shumë mirë hallet, se në familjet tona nuk ka muhabet tjetër, veçse ‘galeria, rroga, minatori, kush u vra, kush shpëtoi, kush erdhi e kush shkoi’. Sot jam i papunë, vetëm se guxua që të ngremë zërin për shqetësimet tona dhe të themelojmë një sindikatë. Kjo është diktatura moderne”

ELTON DEBRESHI

Prej vitit 2014, në galeritë e kromit në Bulqizë dhe Martanesh, kanë humbur jetën 27 persona dhe shumë të tjerë janë lënduar gjatë punës në minierë

ka muhabet tjetër, veçse ‘galeria, rroga, minatori, kush u vra, kush shpëtoi, kush erdhi e kush shkoi’. Sot jam i papunë, vetëm se guxuam që të ngremë zërin për shqetësimet tona dhe të themelojmë një sindikatë. Kjo është diktatura moderne”, shprehet Eltoni.

Pas shkarkimit nga puna të Debreshit, punëtorët e tjerë të kompanisë Albchrome do të bojkotonin punën për afro një javë. Kompania Albchrome në një njoftim të shpërndarë për mediat do ta konsideronte protestën si përplasje mes sindikatave dhe të organizuara nga një grup i vogël punëtorësh. “Një pakicë punonjësish, që nuk përfaqësojnë masën e minatorëve, teknikëve dhe inxhinierëve, kanë themeluar një sindikatë tjetër dhe ne si Albchrome nuk jemi pjesë e saj, kjo për arsye se aktualisht, kemi nënshkruar një kontratë kolektive me një sindikatë tjetër”, thuhet në njoftim e shpërndarë në faqen zyrtare të kompanisë në rrjetin social facebook.

Pak ditë më vonë, kompania do të shkarkonte nga puna edhe tre anëtarë të këshillit sindikal të SMBB, Beqir Duriçi, Behar Gjimi dhe Ali Gjeta të cilët kishin marrë pjesë në protestën. Sindikata e Minatorëve të Bashkuar të Bulqizës në qëndrimet publike të mbajtura lidhur me shkarkimin nga puna të anëtarëve të këshillit sindikal, akuzon kompaninë se shkarkimet ishin të paligjshme, në kundërshtim të hapur me kodin e punës dhe si presione për t’u mbyllur gojën minatorëve dhe për të penguar sindikatën. “Ka arritur në 4 numri i minatorëve të larguar nga puna. Mbi 20 të tjerë janë kërcënuar drejtpërdrejt me të njëjtën masë. Qindra më shumë ndihen të rrezikuar nga hakmarrja e paligjshme dhe e padenjë e Albchrome-it dhe pronarit të saj”, thuhet në një njoftim të sindikatës shpërndarë për mediat. “Kërkesat tona si ndaj kompanisë, por edhe ndaj sindikatës së vjetër kanë qenë vetëm për kushte më të mira puna. Rritje page, pasi kemi thuhajse 9 vite që rrogat tona nuk



Miniera e Bulqizës. Foto FAX Web

janë rritur një qindarkë, por pas 2013-s kemi pasur edhe një ulje prej 30-40 mijë lekë të vjetra. Normat janë rritur, dyfish nga sa kanë qenë. Në këto kushte ne na erdhi laku në fyt. Sindikata e vjetër dhe kompania nuk i duan njerëzit e drejtë, se ju prishin punë” shprehet Duriçi.

Pas grevës një javore, kompania thirri në Tiranë në zyrat qendrore të kompanisë disa prej themeluesëve të sindikatës. Motivacionet e shkarkimit të tre anëtarëve të këshillit sindikal të SMBB, kanë qenë që nga mungesat ‘pa arsye’ në vendin e punës gjatë ditës së protestave, por edhe ‘shkelja e disiplinës në vendin e punës’. Behar Gjimi, njëri prej katër minatorëve të shkarkuar nga puna dhe pjesë e këshillit sindikal të SMBB, tregon se motivacioni i dhënë nga kompania për mungesa në vendin e punës nuk qëndron. “Kompania ka nxjerrë në total, që prej janarit të vitit 2019 shtatë mungesa. Unë tre mungesa i kam bërë gjatë ditëve

të grevës, ku aty kanë qenë 300-400 punëtorë që kanë lënë punën. Ndëshkimin e kemi marrë ne që kemi qenë themelues të sindikatës dhe jemi pjesë e Këshillit Sindikal. Ne jemi në qendër të sulmeve. Unë në total nga janari 2019 kam 13 ditë punë më shumë, që po t’i heqësh 7 mungesat që kompania deklaroi, më rezultojnë pesë ditë punë më shumë. Këtu jemi në diktaturë moderne”, tha Gjimi. Katër minatorët e shkarkuar nga puna janë të vetmit që kanë një pagë në familjet e tyre. “Unë kam dy çunat në shkollë të lartë, shpinë e mbaj me këtë rrogë. Kam një jetë që punoj në këtë minierë. Këta të heqin bukën e gojës nëse ti guxon të folësh dhe të kërkosh të drejtat tuaja” tregon Gjimi. Katër minatorët deklarojnë se do t’i drejtohen edhe gjykatës për shkarkimin, siç e konsiderojnë ata ‘të paligjshëm’, por me pak besim se do të gjejnë drejtësi në Shqipëri. Kompania mori në pyetje edhe 20 anëtarë të tjerë të sindikatës dhe u paralajmëruan për pushim nga puna.

Argumenti i numrave

Kompania Albchrome në të gjitha qëndrimet publike që ka mbajtur për protestën e minatorëve të Bulqizës, ka mohuar që shkarkimet nga puna të katër minatorëve kanë ardhur si shkak i veprimtarisë sindikale. Grupi Balfin, në një deklaratë për mediat deklaroi se për themelimin e kësaj sindikate është njohur zyrtarisht më 16 dhjetor 2019. “Katër prej tyre pasi janë paralajmëruar disa herë për shkeljet e vazhdueshme të kontratës së punës dhe rregullores së brendshme të

kompanisë, janë shkarkuar nga puna për vazhdimin e përsëritur të shkeljeve në fjalë, si mungesa të pajustificuara në vendin e punës”, thuhet në njoftimin për mediat të kompanisë. Gjithashtu Albchrome deklaroi se pjesë e kësaj sindikate janë vetëm 21 punonjës nga 652 që ka kompania. “AlbChrome i trajton punëtorët e saj me normë dhe u jep pagën e 13-të çdo vit. Ky trajtim, është më dinjitozi i mundshëm në krahasim me secilën prej 36 kompanive të tjera **(vijon në faqen tjetër)** ➤

Mini-schengeni si jelek shpëtimi?

NGA AGON MALIQI

Sfidat kryesore të Ballkanit Perëndimor sot nuk janë thjesht problemet e brendshme politike të shteteve, apo mosmarrëveshjet bilaterale mes tyre. Këto probleme kronike kanë zgjatur aq shumë dhe, shprehur metaforikisht, kanë mbledhur aq shumë ujë, sa që gjatë dhjetëvjeçarit të ri rrezikojnë t’i shembit digat rajonale dhe të na përmbysin. Diga e parë është ajo e stabilitetit ekonomik dhe shoqëror. Problemet politike dhe inatet historike kanë prodhuar shtete institucionalisht të dobëta dhe tregje të vogla – apo më shkurt, ekonomi jo konkurruese. Si rrjedhojë, asnjëri shtet nuk po zhvillohet me shpejtësi të mjaftueshme për ta zënë hapin me pjesën tjetër të Europës. Pasojat po i shohim me shpopullimin masiv dhe me një depresion kolektiv i cili, në thelb, është një këmbanë alarmi. Risia është se kësaj here po ikin jo vetëm studentët, të varfërit dhe të pashkathëtit, por edhe profesionistët e punësuar dhe familjet e reja që kërkojnë më shumë se vende pune. Kërkojnë cilësi të jetës – spitale dhe shkolla të mira, ajër të pastër, siguri dhe drejtësi, etj. Nëse kjo shtresë vazhdon të largohet me këto ritme, marrë parasysh edhe rritjen e ulët demografike, rajoni rrezikon të hyjë në një spirale negative dhe paralizuese. Kush do t’i ndërtojë industritë e reja dhe shërbimet cilësore publike të nevojshme për të nxitur rritje dhe zhvillim? Cilat do të jenë pasojat e moszhvillimit ekonomik për demokracinë?

Diga e dytë që rrezikon të shpërthejë është ajo e sigurisë. Brishtësia e rendit ndërkombëtar; kriza e multilateralizmit; hyrja në epokën realizmit brutal dhe të garës mes fuqive të mëdha – të gjitha këto po prodhojnë pasiguri anekënd botës. Të rrezikuara janë veçanërisht rajonet periferike si Ballkani, që, historikisht, kanë qenë fushëbeteja të ndeshjeve hegjemonike dhe “luftërave proxy”.

Një krizë e re ekonomike dhe politike e përmasave botërore rrezikon ta gjejë Ballkanin me shumë çështje të hapura mes shteteve. Bashkë me dobësitë e brendshme ekonomike dhe sociale, kjo na bën të brishtë ndaj mundësisë së rihapjes së konflikteteve etnike. Fatmirësisht, diga e dytë është pak më e lartë dhe më e qëndrueshme. Shqetësimet për sigurinë e rajonit i kanë shtyrë SHBA-të, vitet e fundit, për t’i dhënë prioritet përmbylljes së arkitekturës rajonale të sigurisë, gjë që u materializua me hyrjen e Malit të Zi dhe (së shpejti) Maqedonisë së Veriut në NATO.

Megjithatë, edhe kjo digë e ka një vrimë të thellë. Serbia me neutralitetin e vet ushtarak mbetet problemi nevralgjik i rajonit. E mbajtur peng nga Rusia dhe nga kryeneçësia e saj hegjemonike, Serbia po e mban peng edhe rrugën e Kosovës drejt NATO-së (për shkak të mosnjohjes prej disa shteteve anëtare), edhe atë të Bosnjes e Hercegovinës (përmes Republika Srpska).

Diga e parë, që mendohej se do forcohej përmes integritetit evropian, mbetet dobësia dhe shqetësimi kryesor. Për shkak të krizës së brendshme të Evropës, por edhe dobësive tona, duket qartë se shtetet e rajonit nuk do të hyjnë në BE brenda këtij dhjetëvjeçari (nëse do të hyjnë ndonjëherë). Ky është një realitet të cilin duhet ta përtypim.

Në këtë kontekst, ideja e Shengenit Ballkanik shfaqet si njëfarë jeleku i përkohshëm i shpëtimit. Teoria është se nëse e krijojmë një treg rajonal, të madh thjesht sa Rumania, e çlirojmë potencialin e ndrydhur ekonomik dhe bëhemi pak më konkurrues për investime serioze. Thuhet se BE-ja si kompensim për vonesat në pranim të paktën mund të na japë qasje më të hershme në fondet e mëdha. Më fjalë të tjera, si rajon e thyejmë spiralen negative ekonomike, marrim frymë dhe qëndrojmë mbi ujë, derisa Evropa ta sqarojë të ardhmen e vet. Ideja akoma mbetet në nivelin e spektaklit dhe protagonizmit të nismëtarëve, që nuk duken edhe aq seriozë. Pengesat politike në pamje të parë duken të patejkalueshme. Projekti nuk ka se si të shkojë përpara pa Kosovën, si palë të barabartë dhe me këtë Serbi agresive ndaj saj dhe ndaj Bosnjes dhe Hercegovinës.

Në këtë kontekst, Kosova bëri mirë që nuk tregoi entuziazëm dhe që u rebelua. Por, ajo rrezikon të tregohet naive dhe humbëse nëse nuk i sheh edhe mundësitë strategjike nga një angazhim më konstruktiv. Kjo për shkak se Serbia, ambiciet hegjemonike të së cilës janë para së gjithash ekonomike, është pala më e interesuar për projektin, dhe kjo gjë që e bën atë të kushtëzueshme. Jo vetëm nga Kosova, por edhe nga shtetet rajonale që kanë interes nga njohja e Kosovës, si dhe nga perëndimi si mbështetës i jashtëm. Shengeni Ballkanik mund të shërbejë si leva detyruese ndaj Serbisë dhe për mbylljen e arkitekturës së sigurisë – pra çelësi për njohjen dhe NATO. Serbia e di se pa u mbyllur kjo punë, projekti rajonal nuk ka kuptim dhe është i paqëndrueshëm.

Së dyti, duke mos qenë integrim politik, por ekonomik, projekti nuk duhet parë si zëvendësim, por si diçka komplementare me idenë e bashkimit kombëtar dhe dikur edhe me atë evropian. Në kontekstin e një integrimi ekonomik rajonal, shkrija e parë e natyrshme do të ishte ajo mes tregjeve të Shqipërisë dhe Kosovës, por edhe me vendbanimet e tjera ku ka shqiptarë. Shqiptarët numerikisht do të mund të shërbenin si kundërpeshë ndaj çfarëdo përpjekjeje të Serbisë për ta kthyer projektin në mjet për dominim politik dhe hegjemonik. Gjithsesi, Kosova bëri mirë që u rebelua ndaj mospërfilljes prej Shqipërisë në këtë fazë nismëtare, sepse diçka e tillë nuk guxon të niset pa koordinim. Por tani kërkohet që Kosova të tregohet edhe konstruktive, duke i paraqitur kushtet e saj, qoftë edhe vetëm për t’u ulur në tavolinë, sepse kjo është forma e vetme për të hasur në mirëkuptim mbështetje. Me qasjen folklorike dhe refuzuese ndaj çdo procesi ndërkombëtar të viteve të fundit, Kosova po e mbivlerëson rëndësinë e vet dhe po e rrezikon izolimin e plotë dhe braktisjen nga të gjithë. Kosova e ka bërë të qartë se është shtet dhe se ekziston diçka që quhet interes i veçantë i Kosovës. Por ajo duhet ta kuptojë se ekziston edhe diçka tjetër që quhet interes i veçantë i Shqipërisë. Interesi kombëtar nuk mund të definohet unilateralisht prej asnjëres palë, por buron prej respektit të ndërsjellë dhe konsensusit mes dy interesave shtetërore.

(Autori është analist dhe drejtor i programit në sbunker)

◀ (vijon nga faqja tjetër)

...të shfrytëzimit të kromit në vend”, thuhet në deklaratën e Balfin. Por për kreun e sindikatës së Minatorëve të Bashkuar të Bulqizës, Elton Debreshi, një gjë e tillë nuk është e vërtetë, pasi sindikata është themeluar konform rregullave dhe ligjeve, duke ndjekur çdo procedurë ligjore. “Sa për numrin e anëtarëve nuk është aspak e vërtetë dhe dezinformim. Sindikata ka 39 punëtorë themelues, 21 anëtarë të Këshillit Sindikal dhe 320 anëtarë deri më sot që flasim. Duke qenë sindikata që ka numrin më të lartë të anëtarëve në kompaninë Albchrome. Sindikata i ka nisur në rrugë ligjore të gjitha formularët e anëtarësimit, të noterizuara”, shprehet Debreshi. Pas deklaratës së Albchrome, Sindikata e Minatorëve të Bashkuar të Bulqizës deklaroi se e ka lajmëruar zyrtarisht kompaninë për themelimin e sindikatës që prej datës 24 nëntor 2019-të dhe gjithashtu më herët edhe në njoftimet publike me anë të medias. Albchrome bën me dije se që prej vitit 2013 ka investuar në Minierën e Bulqizës 40 milionë USD në projekte që do të rrisin jetëgjatësinë dhe garantojnë punë të qëndrueshme dhe afatgjatë.

Sipas kodit të punës, në rast se në një kompani veprojnë dy sindikata ose më shumë, kontrata kolektive e punës është e detyrueshme të lidhet me sindikatën që provon se ka numrin më të lartë të anëtarëve. Aktualisht në kompaninë Albchrome veprojnë tre sindikata. Kontrata kolektive në fuqi deri në fund të janarit të vitit 2020 është nënshkruar me Federatën Sindikale të Punonjësve të Industrisë së Shqipërisë, anëtare e Konfederatës të Sindikatave të Shqipërisë. Por protesta e minatorëve të Bulqizës, ka gjetur kundërshtinë e KSSH dhe këta të fundit kanë mbështetur qëndrimet e kompanisë, për investimet, kushtet e punës dhe trajtimin që ju bëhet punonjësve. Konfederata e Sindikatave të Shqipërisë që drejtohet nga Kol Nikolla, ka sulmuar vazhdimisht protestuesit dhe Sindikatën e Minatorëve të Bashkuar të Bulqizës, duke i akuzuar ata si anarkistë dhe pseudomarksistë. “Me kërkesa haxhi-qamiliste, të artikuluar në letra paçavure, të afishuara nëpër mure tualetesh dhe dhoma ç’veshjeshe të minatorëve janë fytyra e vërtetë e pseudostudentëve pseudomarksist”, deklarohet në faqen zyrtare të KSSH-së në Facebook. Për Federatën Sindikale të Punonjësve të Industrisë së Shqipërisë me punën sindikale që këta të fundit kanë bërë në Minierën e Kromit në Bulqizë, ka mundur që të fitojë disa të drejta për minatorët në vite dhe ka përmirësuar kushtet e punës.

Në mbështetje të Sindikatës së Minatorëve të Bashkuar të Bulqizës është shprehur edhe drejtori i Institutit Global të Punës, Dan Gallin. Me anë të një shkrese, Gallin i kërkon kompanisë Albchrome që të ndalojë sulmet ndaj sindikatës së re që është krijuar, pasi këto veprime bien në kundërshtim me ligjet në Shqipëri dhe konventat ndërkombëtare të punës. “Konventat përcaktojnë të drejtën e punëtorëve për t’i bashkuar lirisht çdo sindikatë sipas parëlqimit të tyre, ose në ato raste ku



këto sindikata nuk ekzistojnë, të krijojnë të reja sipas kërkesave të tyre. Punëdhënësit dhe autoritetet publike nuk kanë asnjë rol në këtë proces që përfshin vetëm punëtorët. Përpjekjet nga kompanitë apo nga organizatat e punëdhënësve për të ndërhyrë në organizimin sindikal në ato vende ku janë në fuqi standardet e ILO, janë në shkelje të ligjit”, thuhet në shkresën e drejtorit të Institutit Global të Punës, Dan Gallin. Sindikata e Pavarur e Minatorëve të Trepçës në Kosovë me anë të një komunikate ka dalë në mbështetje të sindikatës së

Minatorëve të Bashkuar të Bulqizës. “Puna jonë si minatorë është mjaft e vështirë, andaj sa herë që kërkojmë kushtet më të mira dikush pëson, mirëpo ne minatorët si të bashkuar gjithmonë do të kërkojmë më të mirën për ne”, thuhet në shkresën dërguar SMBB. “Ne kemi marrë një mbështetje të madhe nga sindikatat e Kosovës, si nga Trepça por edhe nga KEK-u. Gjithashtu edhe nga Gjermania dhe vende të tjera të botës. Jemi në një betejë për të drejtat tona, asgjë më shumë”, shprehet Elton Debreshi, kryetar i SMBB.

Pafuqia e shtetit

Pas dhjetë ditë protestash, Inspektoriati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore zhvilloi një takim me punëtorët që po protestonin dhe përfaqësues nga pushteti vendor. Për shkarkimin nga puna të kreut të sindikatës, Elton Debreshi dhe më vonë të përgjegjësit të financave të sindikatës, Beqir

Duriçi inspektoriati nisi inspektimin dhe verifikimin. ‘Me premtim’ se kjo çështje do hotohej me imtësi nga Inspektoriati i Punës u ndërpre edhe greva e minatorëve. Më 27 dhjetor ISHPSHSH doli me një raport final të inspektimit, duke deklaruar se nga kompania nuk kishte pasur asnjë shkelje apo ndërhyrje në

veprimtarinë sindikale nga kompania. “Ne nuk kemi arritur të provojmë asnjë nga shkeljet e pretenduara nga minatorët, pjesë e SMBB. Ndërsa për dy shkarkimet e fundit, të Behar Gjimit dhe Ali Gjetës do të nisim një inspektim tjetër” shprehet Roland Kurti, drejtori rajonal për ISHPSHSH Dibër.

Pas raportit përfundimtar nga Inspektoriati i Punës, në një qëndrim publik, Albchrome do t’i konsideronte veprimet e ndërmarra nga Sindikata e Minatorëve të Bashkuar të Bulqizës, si një përpjekje 3 javore për të destabilizuar veprimtarinë minerare në Minierën e Kromit Bulqizë. “Pas Kontrollëve të imtësishme edhe nga Inspektoriati i Punës, nuk u zbulua asnjë shkelje minimale”, thuhet në reagimin e kompanisë Albchrome. Por për Sindikatën e Minatorëve të Bashkuar të Bulqizës, raporti nga Inspektoriati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore është gjysmak dhe i njëanshëm për kompaninë. “Ky institucion duhet të hetonte me imtësi shkeljet e Kodit të Punës, kontratave të punës dhe diskriminimin për shkak të organizimit sindikal prej kompanisë Albchrome. Në vend që të zbatonte ligjin, Inspektoriati ka zgjedhur të raportojë qëndrimet e paligjshme dhe të padrejta të kompanisë Albchrome”, thuhet në reagimin e SMBB.

Për protestën e minatorëve u proceduan penalisht nga Policia 7 persona, nga këta 6 minatorë dhe një aktivist i Organizatës Politike, të akuzuar si organizatorë dhe pjesëmarrës në tubime të paligjshme. Por në javën e parë të janarit, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Dibër i pushoi hetimet.



SERBI

Revizionizmi si politikë shtetërore

Partitë dhe politikanët e viteve 1990 e kanë bërë Serbinë sinonim të krimeve, falë një politike revizioniste kriminale, të mbështetur nga shteti. Analizë e historianit Milivoj Beshlin dhe aktivistit Aleksandër Popov.

NGA DEJAN KOŽUL

Serbia dhe Beogradi shënuan 75 vjetorin e çlirimit të qytetit nga fashizmi, përdorisa një rrugë në Kragujev, qytet sinonim i vuajtjeve të Luftës së Dytë Botërore, mori emrin e liderit çetnik Drazha Mihajilović. Shtëpia e Armatës promovoi librin “Masakra e Tuzllës – tragjedia e inskenuar” e Ilija Brankovićit nga botimet e Ministrisë së Mbrojtjes të Republikës së Serbisë, si dhe një pllakë përkujtimore është ngritur në Novi Sad në nderim të Mlladen Bratiqit, komandant i Korpusit të Novi Sadit, në kohën kur ky batalion “çlirori” Vukovarin. Për historianin Milivoj Beshlin, kjo është pasqyra e vërtetë e Serbisë, që reflekton gjendjen e sotme pa fasada.

« Regjimi që udhëhoqi luftërat, mendoj në partinë e Millosheviqit dhe radikalët e Sheshelit, sot ritheksojnë krimet e tyre, duke i glorifikuar dhe rehabilituar kriminelët në masë dhe vrasësit, e duke poshtëruar viktimat ... Dhe nuk bën asnjë rezistencë shoqëria e shpërbërë, e dobët dhe e pafuqishme në Serbi. Kjo do të thotë se partitë e luftës dhe liderët e viteve 1990 arritën ta identifikonin Serbinë me krimin, për ta identifikuar shumicën e vendit me politikën e tyre kriminale. Ky fakt është tragjik, por na flet për gjendjen ekzistuese. Nga kjo diagnozë tragjike duhet nisur çfarëdo rrëfimi dhe përpjekjeje për ndryshim dhe demokratizim në Serbi », - vlerëson Milivoj Beshlin.

Për Aleksandër Popov, nga Qendra për Rajonizim në Novi Sad, ky është «një vazhdim i procesit të rishikimit të historisë që filloi në dhjetëvjeçarin e fundit», me qeverinë e demokratëve që pasuan Millosheviqin. Ai kujton se pas zgjedhjeve të 2003-shit, partitë me karakter nacionalist mbizotëruan absolutisht parlamentin republikan në Serbi.

“Radikalët (e Sheshelit) kishin rreth 83 deputetë. Kjo përbërje e Kuvendit, më 21 dhjetor 2004, në prag të Ditës së dikurshme të Armatës, miratoi ligjin që barazoi çetnikët me partizanët, më propozimin e Lëvizjes së Ripërtërimit të Serbisë (partisë monarkiste të Vuk Drashkovićit – v.j). Këtë ligj e operacionalizoi pastaj qeveria minoritare, kryeministri i së cilës ishte Vojislav Kostunica. Fatkeqësisht, Partia Demokratike, që erdhi më vonë në pushtet, nuk e korrigjoi këtë ligj revizionist, por, përkundrazi, iu nënshtrua forcave të djathta, që ishte një nga arsytet e humbjes së zgjedhjeve më 2012-n. Pas kësaj, Partia Përparimtare Serbe, ish-radikalët dhe Partia Socialiste e Serbisë erdhën në pushtet. Duke pasur parasysh që në të njëjtën kohë u zgjodh President “vojvoda i çetnikëve” Tomislav Nikoliq, nuk duhet të befasonemi që kjo prirje e rishikimit të historisë ka vazhduar me intensitet edhe më të lartë. Shihet së fundi edhe rezultati, ku një rrugë mori emrin e Drazha Mihajilovićit. Kjo është e turpshme”, - përfundon Popov.

Disa mijëra njerëz u vranë në Kragujevc më 21 tetor 1941, rreth 300 prej tyre nxënës. Nga 21 tetori 2012 kjo ditë është shënuar si “Dita e Përkujtimit të viktimave serbe në Luftën e Dytë Botërore”. Vetë emri relativizon krimet e kryera nga nazistët me mbështetjen entuziaste të kolaboracionistëve të Dimitrije Ljotiqit. Emërtimi i një rruge Drazha Mihajilović është është një tjetër vrasje e viktimave.



Presidenti serb Aleksandër Vučić

“Është aktualisht një prirje që të shpallen heronj njerëzit që kryejnë krime në luftërat e Ballkanit përgjatë viteve 1990. Si të interpretohet ndryshe fakti që gjenerali Vlladimir Llazareviq, që u dënua me 14 vjet burg për krime në Kosovë, u prit solemnisht pasi mbajti dënimin e tij dhe më vonë u lejua të ligjëronte në Akademinë Ushtarake”

- Kjo nuk është vetëm një vrasje nw seri e viktimave të nazizmit, kjo është një fyerje ndaj mijëra viktimave të krimeve të çetnikëve, masakrës gjenocidare të civilëve muslimanë dhe deri te terrori e vrasjet në masë kundër popullatës rurale të Serbisë së pushtuar”, - thotë Milivoj Beshlin.

“Procesi i rehabilitimit të fashizmit dhe kërkimi i varrezave masive të pretenduara “me viktimat e komunizmit” janë thjesht një përpjekje për t’i fshehur varrezat masive ekzistuese plot me viktimat të nacionalizmit serb dhe të luftërave të viteve 1990”, - beson Beshlin. Sot

financohet botimi i veprave që relativizojnë dhe mohojnë këto krime, sepse si të interpretohet ndryshe promovimi i librit për Masakrën e Tuzllës të autorit Ilija Branković, i cili së bashku me Momçiq Perishiqin dhe të tjerët është dënuar (në mungesë) me 20 vjet burg, nga Gjykata e Qarkut në Zarë, për shkak të bombardimit të Zarës dhe rrethinës së tij, e që sipas aktgjykimit e bën përgjegjës për të paktën 30 civilë të vrarë dhe dëme të mëdha materiale.

Në librin e tij, Branković shkruan për një ngjarje të ndodhur në 25 maj 1995, ish-Ditën e Rinisë. Gjykata e krimeve të luftës në Bosnje dhe Hercegovinë ka shpallur Gjeneralin Novak Gjukic fajtor për granatimin e Portës (“Kapija”) së Tuzllës. Si komandant i grupit taktik ‘Ozren’ të Ushtrisë së Republika Srpska, ai kishte urdhëruar trupat e tij ta bombardonin Tuzllën, e cila ishte shpallur asokohe zonë e mbrojtur, nëpërmjet një rezolute të Kombeve të Bashkuara. Një raketë kishte goditur qendrën e brendshme të qytetit, të quajtur “Kapija”, duke vrarë 71 njerëz dhe duke plagosur mbi 100 të tjerë. Moshë mesatare e të vrarëve ishte 23. Sidoqoftë, Serbia financon sot promovimin e një libri që e mohon këtë.

“Ky është kulmi i imoralitetit dhe tallje me viktimat e pafajshme të këtij krimi. Aq më tepër që shumica e 71 viktimave ishin të rinj, madje edhe fëmijë. Menjëherë pas luftës, unë isha në varrezat ku ishin varrosur. Nuk do ta harroj kurrrë fytyrën e një nëne që qante ulur në varrin e së bijës duke përkëdhelur foton e saj. Kushdo që është pak njerëzor nuk do të shkruante dhe promovonte një paçavurre të tillë. Dhe qeveria jonë nuk e dënoi falsifikimin e tillë të turpshëm të fakteve, por lejoi që të organizoheshin promovimi i librit në ambientet e Ministrisë së Mbrojtjes, i cili deri më tani është shfaqur disa herë në rolin e jo vetëm promovuesit, por edhe botuesit të librave të të dënuarve të Tribunalit të Hagës, kështu që kjo mund të interpretohet si politikë zyrtare e kësaj ministrie”, - vlerëson Popov.

Nëse dikush ka dilemën nëse kjo është politikë zyrtare e shtetit, mund të bindet pas lajmeve për ngritjen e një pllake përkujtimore në Novi Sad për gjeneralin e Armatës Popullore të Jugosllavisë, Mlladen Bratiq. Kroacia protestoi, por kot. Vendimi ishte marrë shumë kohë më

parë. E ndonëse ky veprim edhe mund të shihet mbi të gjitha si një thyerje krahësh me fqinjën, ai është edhe pjesë e luftës së brendshme.

“Kjo është një shuplakë tjetër për Novi Sadin, një nga qytetet më të dashura në ish-Jugosllavi. Në këtë mënyrë, dikush dëshiron të sjellë trazira midis qytetarëve të Novi Sadit, por edhe të Vojvodinës, i cili konsiderohet të jetë një rajon i rrallë multi-etnik në hapësirën e gjerë, ku ruhet perla e çmuar e tolerancës. Një grup i organizatave joqeveritare, “Gradjanska Vojvodina”, të cilës i përket edhe Qendra për Rajonizim, dënuan me forcë veprimin dhe deklaruan se në vend të kësaj pllake përkujtimore duhet të vendoset një pllakë ku do të shënohet: ‘Korpusi i Novi Sadit, turp’, i cili ishte një mbishkrim i madh në një ndërtim në Novi Sad, gjatë operacionit në Vukovar. Është aktualisht një prirje që të shpallen heronj njerëzit që kryejnë krime në luftërat e Ballkanit përgjatë viteve 1990. Si të interpretohet ndryshe fakti që gjenerali Vlladimir Llazareviq, që u dënua me 14 vjet burg për krime në Kosovë, u prit solemnisht pasi mbajti dënimin e tij dhe më vonë u lejua të ligjëronte në Akademinë Ushtarake”, - thotë Popov.

Presidenti serb Aleksandër Vučić është përgjigjur pas reagimeve nga Kroacia, duke përdorur sulmin si mbrojtje dhe duke e thirrur Kroacinë në rrugë që mbajnë emrin e Mille Budak. Dhe në një takim me udhëheqësit e vendeve fqinje, do të dëgjojmë prej tij se e kaluara duhet të lihet anash.

“Klasa e tanishme drejtuese ishte pjesë e nomenklaturës qeverisëse në vitet 1990, kur ishin kryer të gjitha këto krime. Duan të rehabilitohen vetë duke rehabilituar ata që kanë kryer krime”, thotë Popov. “Nuk do të ketë paqe të vërtetë dhe fqinjësi të mirë në rajon përdorisa të gjitha vendet që janë përfshirë në luftë nuk ballafaqohen me të kaluarën dhe nuk fillohet të quhen gjërat me emrin e tyre të vërtetë – përfundon Popov.

“E kaluara mund të lihet anash vetëm kur e njohim atë, kur krijojmë një marrëdhënie njerëzore dhe racionale me të. Serbia është aq larg sa që çdo fabul për të ardhmen do të thyhet në eshtrat e të vdekurëve në sirtarin e së kaluarës”, - mendon Beshlin. (NOVOSTI)

Kur në janar të vitit 2017, Z. Xi Jinping foli për një himn në lidhje me këmbimin e lirë dhe mburri performancat e Kinës, udhëheqës politikë, kinologë, dhe gazetarë të ndryshëm e duartrokitën, duke iu kthyer kundër proteksionistit Donald Trump. Pothuajse tre vjet më vonë, ishin po ata që denoncuan politikën e saj në emër të «vlerave perëndimore», duke e konsideruar si periudhën më të bukur të luftës së ftohtë. Një ndryshim qëndrimi shumë i çuditshëm

NGA JEAN-LOUIS ROCCA *

Trajtimi mediatik i manifestimeve në Hongkong pohoi se tema e «luftës së qytetërimeve», u përhap shumë shpejt në Kinë. Që prej shumë muajsh tashmë, dokumentarë, libra, apo dhe artikuj u përpoqën të vënë përballë të ashtuquajturat «vlera perëndimore» me ato që konsiderohen «vlera kineze». Ndërtimi i këtyre dy ideologjive rrënjësisht të huaja për njëra-tjetrën, të kujtojnë orët e bukura të luftës së ftohtë, ku secila nxirrte në pah parimet e saj.

Në kampin perëndimor vihej re lindja e një forme nacionalizmi, ndërtimi i një identiteti që dukej se bazohej në vlerat shkencore. Këtë gjë e dëshmojnë dy botime të fundit: njëri i gazetarit François Bougon[i], dhe tjetri i një kërkuesi të njohur, Jean-Pierre Cabestan [ii].

Çdo libër paraqitet si një përpjekje për të kuptuar trajktoren politike të Kinës. Por, në fund, çdo gjë qartësohet. Rrugës për në Athinë, kur gjendej në Agora, Bougon na shpjegon se imajinata e tij e shpinte «në atë çka mund të kishte qenë, para njëzet e pesë shekujsh, zemra e qytetit, që lidhte bashkë tregtinë dhe politikën e cila për ne, europianët, është shndërruar në djepin e demokracisë. Sigurisht, demokracia e grekëve të Antikitit, lidhet shumë pak me idenë që kemi ne tani për demokracinë, por, megjithatë, pikërisht nga ky shesh e ka zanafillën besimi ynë që është gjithmonë i pranishëm në përballjen e ideve, të asaj të fuqisë së debatit apo të bukurisë së artit për të folur gjatë dhe për të bindur. Mendoj se duke përshkuar vendin me emocion, pikërisht gjatë kalimit tim në Kinë, në pesë vitet që kam jetuar atje, nga 2005 deri në vitin 2010, u ndërgjegjësova se jam europian, me pak fjalë, bartës i një trashëgimie të çmuar».

Cabestan-i nuk është më pak emfatik dhe partizan: «Republika popullore e Kinës do të vazhdojë betejën kundër asaj që ajo e quan «demokracia perëndimore», që do të thotë kundër nesh» (është pikërisht ai që e nënvizon këtë gjë). Më tej vazhdon: «Çfarë strategjie të përbashkët duhet të përshtasim ne, europianët dhe francezët e tjerë, për të mbrojtur interesat tona, për të ndaluar kthimin dhe forcimin e autoritarizmit politik dhe prirjen botërore në favor të demokracisë dhe të lirive?» Apo akoma më tej: «Partia komuniste kineze është në luftë kundër nesh, vlerave dhe ideve tona».

Dëgjojmë me padurim që këto vlera apo këto ide të jenë të sakta. Por s' është hiç asgjë.

* Profesor i Shkencave Po, kërkues në Qendrën e kërkimeve ndërkombëtare (CERI), autor i *The Making of the Chinese Middle Class. Small Comfort and Great Expectations*, Palgrave Macmillan, New York, 2017.

Official White House Photo by Shealah Craighead



President Donald J. Trump and First Lady Melania Trump, joined by President Xi Jinping and First Lady Peng Liyuan, right, are given a tour, Wednesday, November 8, 2017, of the Forbidden City in Beijing

KONFRONTIME DHE HIBRIDIZIME MIDIS PEKINIT DHE PERËNDIMIT

Trukimi i një lufte tregtare mes përplasjes së qytetërimeve

Ato përmblihen të gjitha në fjalë të tilla si – demokraci, liri e të shprehurit, të drejtat e njeriut, liri - por që nuk janë përkufizuar ndonjëherë në mënyrë të qartë. Megjithatë, duke filluar nga ekstremi i majtë në të djathtin, nga klasat popullore tek borgjezia, secili ka një koncept shumë të veçantë të këtyre nocioneve.

E njëjta gjë dhe me autorët, «vlerat kineze» që Pekini duket se përhap, janë thjesht të kundërta me ato të homologëve të tyre «perëndimorë»: autoritarizëm, mungesë lirie, mosrespektim i të drejtave të njeriut etj. Disa përpjekje qartësimi përfundojnë menjëherë. Për Bougon-in, Kina

do do të vendoste konceptet e saj si «një komunitet që ndan të njëjtin fat me njerëzimin», si «një diversitet qytetërimesh», «bashkëpunim fitues-fitues», ose një «tolerance reciproke». Por, këto koncepte, a nuk janë përmendur nga Perëndimi për të justifikuar dje kolonizimin dhe sot mondializimin?

Ndërkohë, që të dy aktorët japin shembuj të vlerave kineze në aksion, shumë pasaktësi po grumbullohen. Për Bougon-in, drejtuesit e ndërmarrjeve të mëdha amerikane janë «të nxitur në mënyrë të rregullt nga mësimet e mjeshtrit Xi (presidenti Xi),sado të huaja të jenë bindjet

e tyre në lidhje me këtë ideologji». Por «një cinizëm përfitues shfaqet tek drejtuesit e Silicon Valley», dhe «ne nënvlerësojmë mahnitjen që mund të zgjojë tek inxhinierët e iluminuar të Brigjeve Perëndimore, kjo shoqëri urbane, dinamike, e re dhe mbi të gjitha shumë high-tech». Përse «vlerat perëndimore» nuk u lejojnë këtyre drejtuesve guximtarë të rezistojnë? Një hipotezë: po sikur vlerat perëndimore, për të cilat bëhet fjalë, të jenë në fakt vlera kapitaliste?

Nga ana e tij, Cabestan-i vëren se «Pekini ka përfutur nga tensionet midis Athinës dhe kredituesve të tij, në gjirin e Bashkimit Europian,

Foto nga pxhere.com



për të propozuar financime në sektorët jetësorë si infrastruktura e transportit apo energjia». A nuk duhej t'i detyronin «vlerat tona» europianët duke i shtyrë drejt solidaritetit, t'i ndalonin që të privilegjonin disa interesa të ulëta dhe të llinin kinezët të përfitonin nga konkurrenca? Një armator grek i deklaroi Bougon-it se këta të fundit «bëjnë një punë të mirë». Ndërsa autori shton: «Ai i gëzohet mungesës së grevave dhe pagave që paguhen në kohë dhe në bazë të orëve të punës». Kinezët janë kapitalistë të mirë, tregtarë të mirë dhe për më shumë janë dhe të ndershëm, apo jo?

Cabestan-i zbulon një sekret kur nënvizon se «është e pamundur të injorosh se shumëfishimi i sulmeve kundër demokracisë ashtu siç e kuptojmë ne, është i lidhur ngushtë me një dobësim të Perëndimit në skenën ndërkombëtare». Dhe të saktësosh që ekzistojnë «ndryshime vlerash dhe interesash» midis Kinës dhe Perëndimit. Pra, flitet, pa mbuluar këtu vlerat, për të mbrojtur interesat – e dobësuar -, meqë më në fund kinezët bëjnë pak a shumë atë që kryejnë dhe të tjerët, kështu kanë vepruar ose do të donin të vepronin. Të bie në sy fakti se autorët mbajnë përgjatë gjithë veprës së tyre një paqartësi mbi gjenealogjinë e këtyre «vlerave». Të jenë vallë «perëndimore», «universale», «europiane», apo «franceze»? Nuk do ta dimë kurrë këtë gjë.

NJË VIZION FETAR I DEMOKRACISË

Mungesa e përgjigjes ndaj këtyre pyetjeve lidhet ndoshta me ngurrimin e autorëve për të folur për kolonializmin dhe imperializmin, që, si njëri dhe tjetri, kanë qenë përpjekje për të universalizuar «vlerat tona». Në këtë rast ata duhet të kishin saktësuar se ideali demokratik ka lindur në Europë por që «është çuar gjetkë nga individë të shumtë, grupe sociale dhe mendimtarë për të shërbyer si armë kundër «praktikave tona politike». «Vlerat tona», ndonjëherë janë «ato» që i mbrojnë kundër një pjese «tonës». Le të vëmë në dukje në këtë rast se shumë disidentë kinezë e qortojnë qeverinë perëndimore pasi ajo nuk i mbështet.

Nga këto reflektime të krijohet përshtypja se kinezët ndoshta kanë praktika më pak virtuoze se perëndimorët, por që kjo nuk mund të provohet falë analizës së këtyre «vlerave». Përse autorët nuk krahasojnë asnjëherë sjelljen e kinezëve në Afrikë me atë të Francëfrikës? Ata mbrojnë një vizion fetar të demokracisë sikur demokratizimi të varej nga një lloj transformimi. Na kujtohen njëkohësisht edhe referencat tek Bougon-i. Cabestan-i i thekson me tepër (duke dashur «të tregojë se për një afat të gjatë kohor, regjimi kinez aktual është i dënuar, jo aq shumë për arsye ekonomike sesa për arsye politike dhe njerëzore, do me thënë kur elitat dhe shoqëritë kineze do ta shohin të papranueshme burgosjen e personave vetëm për shkak të ideve të tyre, duke qenë se janë qeverisur për një kohë të gjatë nga një shoqëri sekrete dhe do të vlerësonin se vetëm një Kinë demokratike do të mund të shndërrohej në një fuqi të madhe të respektuar dhe një anëtare me të drejta të plota të komunitetit ndërkombëtar». Demokratizimi nuk do të kishte të bentë aspak me një situatë politike dhe sociale, konflikte, probleme ekonomike, me pak fjalë me historinë.

Bëhet fjalë për të pakësuar vlerat perëndimore me parime të paqarta, dhe perëndimorët me një identitet ahistorik dhe asocialë. Duke proceduar në këtë mënyrë, të dy autorët harrojnë se pas kësaj «ne» ekzistojnë klasa sociale, ndërmarrje, hapësira gjeografike, vlerat e të cilave dhe «interesat» ndryshojnë

Përsa i përket autoritarizmit, ky parim sipas të cilit vetëm një pushtet i fortë efikas dhe kompakt mund të sigurojë lumturinë tonë, është vallë kjo një shpikje kineze? Nga fashizmi në stalinizëm, duke kaluar më vonë nga nazizmi, a nuk i kemi teorizuar pak a shumë të gjitha modelet autoritare? A e ka krijuar Kina kolonializmin, imperializmin dhe kapitalizmin?

shumë. Ata fshijnë faktin se «vlerat perëndimore» kanë shërbyer shpesh si armë kundër Perëndimit për të kundërshtuar funksionimin e institucioneve politike që hiqet se i mbron. Duke filluar nga lëvizja punëtore dje deri në aksionet e sotme kundër masave që shkatërojnë lirinë, grabitjen e planetit, dhunat policore në favor të të drejtave të emigrantëve, shumë njerëz refuzojnë të përfshihen në këtë «ne». Në fakt, ata që i marrin më seriozisht të drejtat e njeriut apo demokracinë mendojnë se përfaqësuesit e kësaj «ne-je» nuk i respektojnë ato në të vërtetë.

Ky mohim i historisë bën të mundur krijimin e një spektri ideologjik: «vlerat kineze». Duke mbrojtur një vizion dikotomik të botës, Bougon-i dhe Cabestan-i çojnë ujë në mënyrë paradoksale në mullurin e drejtuesve kinezë: këta të fundit luftojnë për të treguar se ekziston një bazë morale në vullnetin e tyre për të luftuar me ashpërsi kundër fuqive perëndimore.

Duke i kundërvënë Sokratin Konfuciusit, autorët tanë penguan një punë të vërtetë krahasimi. Nëse disa elita europiane shkojnë drejt autoritarizmit kinez, pa dyshim, kjo ndodh sepse shoqëria kineze është më tepër kapitaliste sesa konfucioniste. Në fakt, modeli social kinez që mbrohet nga Partia komuniste kineze mbledh të gjitha utopitë e Perëndimit. Pushteti kërkon të çrrënjosë varfërinë dhe të krijojë një shoqëri «me prosperitet të vogël» (xiaokang) në të cilën ashtu si tek Thomas Hobbes, qytetari do të këmbëjë një pjesë të lirisë së tij përkundërt jetesës në mënyrë të sigurtë: ëndrra e vjetër e një shoqërie prej qytetarësh-pronarë të vegjël të fiksuar nga rendi. Financime të mëdha janë lejuar në zonat rurale në vështirësi për të transformuar fshatrat në qytete të vogla të reja me të njëjtat parime sociale dhe arkitekturore të modernitetit korbusjan. Kjo



Foto nga pxhere.com

referencë me modernitetin dhe me rendin e shpie partinë që të mbikqyrë popullsinë e saj deri në detajet më të vogla; një ambicje panoptike sipas Bentham që Michel Foucault e ka përshkruar me mjeshtëri të madhe që para dyzet vjetësh (4)... Perëndimi në ëndërr, Kina do ta bëjë – por asgjë nuk jep garanci që ajo do t'ia dalë.

Ekziston një variant kinez i një stili jetë bashkëkohore; ose më mirë të themi variante kineze, pavarësisht ndryshimeve sociale, gjeografike, etj... janë pasuese, ashtu siç ekzistojnë tek «ne» ndryshime midis vendeve, krahinave dhe klasave sociale. Por paraqitjet e një jetese të mirë, e shijes së mirë, e sjelljeve të mira dhe e marrëdhënieve të mira familjare si dhe mënyrat e kundërshtimeve sociale duken të afërta me ato që ekzistojnë në Evropë (5). Cilat janë objektivat e kinezëve të klasës se mesme, nëse nuk bëhet fjalë për gjetjen e një pune interesante, për t'u kujdesur për fëmijët dhe prindërit e tyre, për të fituar para, për të blerë një apartament, për të grumbulluar një pasuri, për të udhëtuar?

Në Kinë, shkencat sociale janë po aq perëndimore sa dhe gjetkë, dhe universitetet janë pushtuar gradualisht nga profesorë të formuar me metoda amerikane që nxjerrin botime në revistat anglo-saksone. Do të thoshim se shpirti kritik është më i gjallë në Evropë sesa në Kinë, por a jemi të sigurtë se ky shpirt kritik mund të jetë përhapur universalisht përmes vendeve dhe kategorive sociale? A jemi të sigurtë se të gjitha qeveritë perëndimore e vlerësojnë një gjë të tillë?

Edhe në fushën politike, ndikimi perëndimor është vendimtar. Nacionalizmi kinez nuk ka pse të ketë aspak zili nacionalizmin amerikan dhe ideologjia teknokratike e ka

pushtuar administrimin kinez. Për më shumë, çensura nuk është në mënyrë specifike një ide kineze. «Të drejtat e njeriut», janë pjesë e referencave të qeverisë së Pekinit, edhe pse ai shpjegon në mënyrë shumë hipokrite se e drejta e parë e njeriut është të dalë nga varfëria. Përsa i përket autoritarizmit, ky parim sipas të cilit vetëm një pushtet i fortë efikas dhe kompakt mund të sigurojë lumturinë tonë, është vallë kjo një shpikje kineze? Nga fashizmi në stalinizëm, duke kaluar më vonë nga nazizmi, a nuk i kemi teorizuar pak a shumë të gjitha modelet autoritare? A e ka krijuar Kina kolonializmin, imperializmin dhe kapitalizmin?

Fjalimi i qeverisë kineze që justifikon këtë autoritarizëm riprodhon pothuajse tërësisht atë të drejtuesve europianë (dhe që vazhdojnë ta mbajnë, shumë nga ata) me qëllim që të kufizojë praktikatat demokratike. Në thelb, popullsia nuk është aq e urtë dhe e edukuar për të kuptuar se çfarë është e mirë për të. (6)

Ndërkohë që Bougon-i dhe Cabestan-i vënë kundër njëri-tjetrit regjimin demokratik me atë komunist, mesazhi i nënkuptuar mund të përmbledhet kështu: shoqëria perëndimore duhet pranuar pavarësisht të metave të saj; në Kinë është akoma më keq. Duke lënë në harresë bazën e vlerave të përbashkëta që lidhin që tani e tutje Kinën me Perëndimin rreth kapitalizmit.

[1]François Bougon, Kina nën kontroll. *Tiananmen 1989-2019*, Seuil, Paris, 2019. Në atë kohë gazetar i Le Monde, Bougon kaloi tek Mediapart në shtator 2019.

[2]Jean-Pierre Cabestan, Kina nesër: *demokraci apo diktaturë?* Gallimard, coll. «Debat», Paris, 2019.

[3]Jeremy Bentham (1748-1832), midis të tjerave, krijues i burgut panoptik që i lejon vëzhguesve të shohin, pa u parë.

[4]Michel Foucault, Të vëzhgosh dhe të ndërshkosh, Gallimard, Paris, 1975.

[5]Cf. *The Making of the Chinese Middle Class. Small Comfort, Great Expectations*, Palgrave Macmillan, New York, 2017.

[6] Të lexohet «Në Kinë, demokracia... Kur populli të jetë i pjekur» *Le Monde diplomatique*, mars 2017.

Frankofonë apo gjermanofonë?

Qysh në mesjetë, Luksemburgu, - që në perëndim ka një krahinë frankofone, ku fliten dialektet *wallon*, ndërsa në lindje një krahinë gjermanofone, ku fliten dialektet *fransikë mosellan* – zgjodhi si gjuhë administrative frëngjishten. Që kur pushtoi territorin e këtij vendi, në shekullin e XVII, më pas gjatë Revolucionit, në vitin 1795 – kur krijoi departamentin e përkohshëm të pyjeve - Franca imponoi gjuhën e saj në jetën publike. Pas disfatës së Napoleonit në Waterloo, Kongresi i Vjenës vendosi në vitin 1815 krijimin e një dukati të madh, i lidhur në bashkim personal me mbretin e Hollandës, por që aderoi në Konfederatën gjermane, me një marrëveshje të dobët të mbretërive, principatave dhe shteteve sovraane të gjuhës gjermane.

Në vazhden e revolucionit belg, traktati i Londrës (1839) e zvogëloi dukatin e madh, tashmë të pavarur, duke ia kaluar krahinave gjermanofone. Pjesa perëndimore, kryesisht frankofone, formoi provincën belge homonime të Luksemburgut. Ndërkohë që dukati i madh iu bashkangjiti bashkimit doganor gjerman (Zollverein), personalitetet e larta vendosën të mbajnë frëngjishten si gjuhë administrative, të drejtësisë, dhe të jetës politike. Në vitin 1843, kjo gjuhë u fut edhe në shkollë, si gjuhë e dytë pas gjermanishtes dhe që në klasat fillore.

Gjuha luksemburgase, si gjuhë lokale dhe varietet i gjuhës *fransikë mosellan*, do të përdorej vetëm në vitin 1912, për një orë bisede javore.

Në maj të vitit 1940, dukati i madh u pushua nga Gjermania naziste, dhe më pas u aneksoi; u ndalua përdorimi i frëngjishtes. Një vit më vonë, pushtuesi u ndje i detyruar të anulonte regjistrimin fiskal të popullsisë, e cila u përgjigj tri herë si “luksemburgase” pyetjeve që kishin të bënin me etninë, gjuhën amtare dhe kombësinë. Ky episod i rezistencës pasive përbën një element të romanit kombëtar, bashkë me grevat e mëdha të vitit 1942 kundër regjistrimit të të rinjve në Wehrmacht.

Pas konfliktit, përdorimi i frëngjishtes si gjuhë e shkruar dhe gjuha e folur luksemburgase u kthye në shenja të identitetit. Edhe pse ngelet gjuha e parë që mësohet në shkollë, gjermanishtja është hequr nga hapësirat publike. Përdorimi i gjuhës së Molierit u demokratizua në favor të përdorimit të saj nga emigrantët e shumtë të ardhur nga vendet latine. Në një kontekst rritjeje të shpejtë të numrit të të huajve dhe të mobilizimit të rrymave identitare, si shoqata e *Actioun Lëtzebuergesch*, në lidhje me çështjet linguistike, ligji i 24 shkurtit 1984 vendosi gjuhën luksemburgase si «gjuhë kombëtare», dhe e detyroi administratën të përgjigjej në të tria idomat në përdorim, sipas asaj që ishte zgjedhur nga pala kërkuese. Në tetor të vitit 2008, një ligj i ri e lidh përfitimin e kombësisë me marrjen e provimit që ka të bëjë me zotërimin e gjuhës luksemburgase. Promovimi i kësaj të fundit në institucione u forcua sërish pas futjes në fuqi të ligjit të korrikut 2018.

PH. D. ET X. M.



Artwork © Clover Robin

Si shpiket një gjuhë?

Bastion bankash dhe institucioneve europiane, Luksemburgu është edhe një kullë Babeli ku fliten së bashku tre apo më mirë të themi katër gjuhë. Rritja e numrit të të huajve – që po kthehen në shumicë – forcon ende më tepër multilinguizmin, shumëgjuhësinë, por gjithashtu dhe sfidën për të ndërtuar një fat të përbashkët. Ajo favorizon në mënyrë paradoksale emergjencën e gjuhës luksemburgeze, që nuk ka qenë kurrë kaq e gjallë dhe nuk ka zënë kurrë kaq vend në debatet politike.

NGA TË DËRGUARIT TANË SPECIALË PHILIPPE DESCAMPS DHE XAVIER MONTHEARD

Të paktë janë kandidatët e zonës «Schengen» që e dinë se ky emër i përket një fshati luksemburkez, në mes të vreshtave, fqinj sa me Francën aq dhe me Gjermaninë. Konventa e parë që organizoi qarkullimin e lirë të personave në Europë u nënshkrua në Mosellë, në bordin e anijes Princesse Marie-Astrid, në vitin 1985. Në anën e majtë të lumit, pas një relikeje të murit të Berlinit, Muzeu evropian festoi këtë fshirje të kufijve. Njëzet e katër pllaketa, një për çdo gjuhë zyrtare të Bashkimit, rrëfejnë një legjendë të artë e cila shmanget përfitimin kolosal që Luksemburgu merr nga një liri tjetër qarkullimi, nga ajo e kapitaleve... Këtij koleksioni i mungon edhe një pllaketë në gjuhën kombëtare, *lëtzebuergesch*, emergjenca aktuale e së cilës qartëson rrugëtimin e pazakontë të dukatit të madh.

Një ag vjeshte në kryeqytet, tridhjetë kilometra më në veri. Nën një shi të ftohtë, me dhjetëra njerëz janë drejtuar nga Instituti Kombëtar i Gjuhëve (IKGJ). Ora e parë e gjuhës luksemburgeze e semestrit fillon pas disa minutash. «Unë njoh tashmë pesë gjuhë, - na thotë një suedeze, kjo gjuhë do të jetë një plus për ndërmarrjen time». Më pak të sigurtë, një polak dhe një rus tregojnë «respektin» që kanë ndaj vendasve: «Gjithsesi ndodhemi në Luksemburg!» Një marokene ankohet, sepse duhet të paguante 400 euro në vit për të mësuar një idiomë që «nuk shërben askund tjetër përveçse këtu». Frëngjishtja dhe gjuha luksemburgeze monopolizojnë tre të katërtat e orëve të mësimi. Këtë vit, «është hera e parë që gjuha luksemburgeze e parakalon frëngjishten, - shpjegon Z. Luc Schmitz, zëvendës drejtor. Listat e pritjes

u mbushën plot, kemi mungesa më-suesish». Instituti kombëtar i Gjuhëve lëshon certifikata të çmuara që kërkojnë gjithmonë e më shumë nga punëdhënësit dhe nevojiten për të marrë kombësinë luksemburgeze. Që në vitin 2000, më shumë se një banor në dhjetë fitoi natyralizimin, pothuajse 67 000 persona.

Në një kafene në *Place des Armes*, në qendër të qytetit, Zonjat Rita Schmit dhe Christine Schmit (1), të Shoqërisë së përkthyesve dhe interpretëve

luksemburgezë pohuan zhvillimin e fundit të gjuhës : «Në librat për fëmijë, p.sh. ka pak dhe kjo praktikisht nuk ekziston-te». Ose në sektorin tregtar. «Gjithmonë e më shumë, klientët të huaj duan një manual për produktet e tyre. Ndonjëherë na kërkojnë të përkthejmë në «gjermanishten luksemburgeze» ose në «frëngjishten luksemburgeze», duke imagjinuar sikur bëhej fjalë vetëm për një variant, të një dialekti, siç është gjuha e Quebecut p.sh», zbavitën dy bashkëbisedueset tona. A munden ato të ndiejnë habinë e vizitorëve që vinë nga *Hexagone*-i ndërsa përshkojnë la Ville-Haute, qendrën historike të Luksenburgut. Frëngjishtja zë vendin e parë në sinjalistikë, por, përveç gjuhës luksemburgeze, shfaqen pa pushim propozime në gjermanisht, anglisht, portugalisht apo dhe italisht – gjithashtu edhe katedralja Notre-Dame predikon meshat në të gjitha këto gjuhë. Duket sikur gjithsecili kalon lehtësisht nga një idiomë në tjetrën, ndonjëherë brenda së njëjtës fjali, ndonjëherë në funksion të bashkëbiseduesve.

Anketat ndërkombëtare e konfirmojnë këtë përshtypje: më shumë se katër luksemburgezë në pesë vetëdeklarojnë se flasin tre gjuhë, dhe më shumë se tre persona në pesë, flasin katër



Veshje tradicionale luksemburgeze

gjuhë(1). Kjo shumëllojshmëri gjendet në praktikat kulturore. Në teatër, shfaqjet në gjuhën frënge janë më të shumta, ndërsa për letërsinë, librat në gjuhën luksemburgete mbajnë vendin e parë. Përsa i përket shtypit, dy gazetatat e mëdha të përditshme, *Luxemburger Wortet*, *Tageblatt*, janë hartuar në gjuhën gjermane, por i kanë lënë shumë faqe frëngjisht; numri më i madh i ekzemplarëve i është lënë gazetës frankofone *L'Essentiel* që shpërndahet falas. Në radio dhe në televizion, operatori privat historik RTL ka audiencën më të mirë me programet e tij në gjuhën luksemburgete. Faqja e internetit e këtij kanali është shndërruar gjithashtu në median e parë të shkruar.

Veçantia linguistike e këtij vendi që për nga madhësia është afërsisht sa departamenti i Rhone, e ka origjinën e saj në situatën midis dy fqinjëve të bezdisshëm, Francës dhe Gjermanisë. Kjo veçori shpjegohet edhe nëpërmjet pushtetit tërheqës të dukatit të madh dhe nga dinamizmi i tij ekonomik si rezultat i një politike fiskale të ulët vendosur qysh në vitet 1970 për të ndryshuar faqen e metalurgjisë. Gati gjysma e 613 000 banorëve (1) janë të huaj (47% e popullsisë totale në vitin 2019, dhe 70% e popullsisë së kryeqytetit), pa numëruar këtu 200 000 punëtorët që kapërcejnë kufirin çdo ditë – gjysma vjen nga Franca, një çerek nga Belgjika dhe një çerek tjetër nga Gjermania (2). Në total, të huajt prodhojnë më shumë se tre të katërtat e pasurisë kombëtare.

**NJË BANOR NË
GJASHTË ËSHTË
PORTUGEZ.**

«Baza e kësaj marrëveshjeje miqësore, përbën një shpërndarje të misionit midis gjuhëve, - na thotë sociolinguisti Fernand Fehlen. Secila ka rolin e saj për të luajtur dhe nëse doni të jeni pjesë e plotë e këtij konteksti kombëtar, duhet të pranoni përdorimin e një gjuhe të caktuar në një kontekst të caktuar dhe të keni mundësi ta bëni një gjë të tillë. Por të thuash që njerëzit flasin nga tre gjuhë, kjo është fiksjon, sepse ata vetëm sa i zotërojnë pak a shumë mirë, këto gjuhë». Studimet paraqesin një fotografi me kontraste midis shtëpisë dhe punës. Gjuha “që zotërohet më mirë” ngelet gjuha luksemburgete, por vetëm për 42% të rezidentëve (jashtë kufinjve) (*horsfrontaliers*), dhe renditet para frëngjishtes me (20%) dhe gjuhës portugeze me (14%) – më shumë se një banor i Luksemburgut në gjashtë të tillë është portugez ose me origjinë portugeze. Ndërsa në tregun e punës, frëngjishtja ngjitet në majë. E folur nga katër rezidentë në pesë të tillë, kjo gjuhë zë vendin e parë në të gjithë sektorët, përveç sektorit të administratës, ku parakalohet nga gjuha luksemburgete, dhe atij financiar dhe i sigurimeve, ku anglishtja është mbreti. (1) Gjuha luksemburgete dominon tek personat që janë më shumë se 50 vjeç dhe tek ata që janë më pak se 30 vjeç. Shumë e përdorur në të folur deri më tani, kjo gjuhë ka njohur një përhapje të papritur në të shkruar falë shfaqjes së rrjeteve sociale dhe shumëfishimit të mbështetësve të komunikimit. «Një nga sekretet e rëndësishme që ka marrë gjuha luksemburgete është fakti se në mediat sociale, pranohet gjerësisht se mund të bëhen gabime në të shkruar, pohon Z. Jean –Lou Siweck, drejtor i grupit Editpress (*Tageblatt*, *Le quotidien*, *L'Essentiel*). Kjo gjë e bën jetën më të lehtë. **(vijon në faqen tjetër)**»



Multilinguizmi, një dhimbje koke shkollore

«**M**ë tregoni stereotipet e gjinisë që keni gjetur në këtë katalog lodrash», - thotë mësuesja. Fjala qarkullon rreth tavolinave të vendosura në formë U-je, përballë saj. Çdo nxënës, me radhë, zgjedh një shembull në tabletin e tij elektronik dhe e pasqyron në ekranin e madh kolektiv: djallë duke luajtur si mjek apo mekanik, ndërsa vajza e veshur me ngjyrë rozë, e lumtur që hekuros apo gatuan. Një risi kjo e «seksionit 2» të «mësimdhënies europiane», që mbledh të rinj të moshës 13 vjeç të dhjetëra kombësive të ndryshme ku të gjitha orët (përveç orës së gjuhës), zhvillohen në frëngjisht. I hapur në fillim të vitit shkollor 2018, liceu Edward-Steichen de Clervaux, në veri të vendit, përbëhet nga ambiente ultramoderne, me një strukturë të betonizuar të lëmuar, me dyer të jashtme dhe dritare prej xhami që bien nga pylli si dhe sallat e klasave të pajisura me teknologjitë e fundit. Ai bën pjesë në katër sistemet publike që ofrojnë këtë plan mësimor të ri. I afërt me sistemet franceze apo gjermane, - provimi i pjekurisë, - modeli evropian, ndahet nga origjinaliteti linguistik i mësimdhënies në Luksemburg.

Që në mesin e shekullit XIX-të, mësimi i leximit dhe i shkrimit fillon në moshën 6 vjeç në gjermanisht. Frëngjishtja futet në mënyrë progresive, fillimisht në gjuhën e folur, pastaj në atë të shkruarën, në moshën 8 vjeçare. Kjo gjuhë imponohet për të gjitha disiplinat duke filluar që nga moshë 15 vjeç në planin mësimor të quajtur «klasik», si rruga e sigurt drejt universitetit. Në planin mësimor të konsideruar si «të përgjithshëm» në të cilin futen mësimdhënia teknike dhe profesionale (60% e efektiveve të ciklit të dytë), gjermanishtja është mazhoritare edhe pse gjuha frënge po zë një vend gjithmonë e në rritje.

Kësaj mësimdhënieje të dyfishtë i shtohet anglishtja dhe gjuha luksemburgete – e përdorur çdo ditë në aktivitetet jashtëshkollore, - gjë që përbën një «sfidë të madhe për të rinjtë», - shpjegon Z. Jean Billa, drejtor i liceut të Clervaux. Një eufemizëm. Studimet kombëtare dhe ndërkombëtare kanë nxjerrë në pah braktisje të shumta të shkollës. Ndër-

kohë që përbëjnë më shumë se 2/3 e efektivit të arsimit kryesor (fillor), nxënësit e huaj ose me origjinë të huaj kanë rezultate shumë më të dobëta se ata që kanë për gjuhë amtare gjermanishten apo gjuhën luksemburgete. (1) «Për fëmijët portugezë, të ish-jugosllavisë, apo të Kepit të Gjellbër, mësimi i gjermanishtes është pothuajse i pamundur në këtë kontekst», - shpjegon sociolinguisti Christoph Purschke.

Edhe pse vendi është shumë i pasur dhe zotëron shumë mënyra për të ndihmuar shkollat, përsëri çështja është e komplikuar. Gjuhët përbëjnë një faktor-kyç në dështimet shkollore. Sistemi orvatet të forcojë riprodhimin e elitave, që do të dalin trigjuhësh, bile dhe katërgjuhësh nga ky rrugëtim mbushur me vështirësi. Ai dekurajon një pjesë të nxënësve të kulturës gjermanike, të cilët e përfetojnë në mënyrë shumë të vështirë mbizotërimin e frëngjishtes në provimin klasik të maturës, pjekurisë.

Për të vepruar mbi faktorët linguistikë të ndërprerjes së shkollës, qeveria aktuale, fillimisht, përgjithësoi futjen e përbashkët të frëngjishtes dhe të gjuhës luksemburgete në çerdhe dhe në klasat e vogla që paraprijnë marrjen e njohurive në shkrim e këndim – duke qenë se shkolla ishte e detyrueshme që në moshën 4 vjeç.

«Duhet provuar të krijohen situata shumëgjuhëshe për të hapur shpirtin, veshin dhe mendjen me shumë gjuhë njëherësh që në moshë fare të vogël», - thekson ministri i arsimit Claude Meisch. Mbi të gjitha, shkolla publike propozoi që me fillimin e vitit shkollor 2018, në katër lice, mes të cilëve dhe ai i Clervaux, këto plane mësimore drejt provimit të pjekurisë në sistemin evropian dhe atë ndërkombëtar.

Këta të fundit i lejojnë çdo nxënës të zgjedhë vetëm një gjuhë komunikimi (lingua franca), por edhe nivelin e gjuhëve të tjera që ai kërkon të mësojë. Me këtë program, qeveria kërkon, gjithashtu, të shmangë largimin e të rinjve liceistë drejt vendeve fqinje, apo drejt sektorit privat.

Për të njëjtën arsye, ajo nuk është e vendosur që të hedhë hapin e madh drejt një arsimit në gjuhën kombëtare, teori kjo e mbrojtur nga e djathta e spektrit politik, nga Partia reformiste e alternativës demokratike (ADR) dhe, nga ana tjetër, nga Dei Lenk (e majta). Kufizimi i gjuhës luksemburgete vetëm me dy orë në javë komunikim të gjuhes së folur, ka shkaktuar shumë diskutime zyrtare. «Nuk shoh kontradikta midis promovimit të gjuhës luksemburgete dhe një shumëllojshmërie të ofertës arsimore» - mendon Z. Meisch. «Them se për të funksionuar si vend, multilinguizmi është shumë i rëndësishëm. Dhe, që të kuptohemi si vend, dhe të kemi një identitet si komb i Europës, gjuha luksemburgete është shumë e rëndësishme. Pra duhen të dyja.»

Nxënësit e filialeve të reja publike do të ecin me ritmin e një niveli çdo vit, por prirjet e para kanë sjellë surpriza. Mundësia për të zgjedhur një gjuhë të vetme kryesore ka qenë në përfitim të frëngjishtes e cila është zgjedhur si gjuhë, pothuajse nga gjysma e nxënësve e seksioneve të para të regjistruara në fillim të vitit 2019, shumë më tepër se anglishtja, gjermanishtja dhe më pas portugalishtja.

PH. D ET X. M.

(1)Raport kombëtar mbi arsimin në Luksemburg», Shërbimi i koordinimit të kërkimit dhe inovacionit pedagogjik dhe teknologjik, Luksemburg, 2018

◀ Në gjermanisht, nuk do të pranohej një gjë e tillë. Në frëngjisht akoma më pak». Do të asistonim kështu në emergjencën e një «gjuhe 2.0» ku cilësia stilistike ka më pak rëndësi sesa liria e shprehjes.

Në lindje të kryeqytetit, në Strassen, leksikografi Alexandre Eckert rrëshqet gishtat mbi tastierën e tij. Me një zë të ëmbël dhe të vendosur, ai shpjegon funksionimin e fëmijës së tij, një fjalori online. «Gjuha buri-more është gjuha luksemburgeze, dhe janë katër gjuhë shënjestra që i referohen: gjermanishtja, frëngjishtja, anglishtja dhe portugalishtja. Nuk ka përkufizim të fjalëve në gjuhën luksemburgeze, por vetëm elementë të çdizimit të gjuhëve shenjuese, referuese, që bëjnë të mundur dekodimin, zbërthimin e kuptimit të fjalës». Në anën e tij rreshtohet dhe Z. Luc Marteling, drejtori i parë i qendrës për gjuhën luksemburgeze, që sapo është krijuar. Ai na orienton me gisht drejt korpusit të *Lëtze-buerger Online Dictionnaire*, me 27 000 prurje. Të dy burrat drejtojnë një ekip prej dhjetëra njerëzish të cilët verifikojnë fjalët një e nga një, në kontekstin e botimit, në këtë nëntor, me një ortografi «të kompletuar» të gjuhës luksemburgeze. «Ja një shembull i mirë, - thotë Z. Marteling: fjala «plateau» (pllajë). Shkruhet parimisht, si në frëngjisht, me një «t», dhe «e, a, u». Por në gjuhën luksemburgeze, rrokja e parë e fjalës është e shkurtër. Për të vënë në dukje këtë shkurtësi duhen vënë dy bashkëtingëllore: dy «t». Po përse duhen shkruar «e, a, u, në vend që të shkruhet «o»? Që fjala të jetë vërtet në rregull sipas ortografisë luksemburgeze, duhej shkruar «platto: Por a do ta vendosim ne këtë gjë?»

Përpunimi i fjalorit në përmirësim e sipër që prej pesëmbëdhjetë vjetësh, ka nxjerrë në pah një problem specifik të vendit: përmes zgjedhjes së një ortografie, a nuk e tërheqim gjuhën drejt origjinave gjermanike apo ndikimeve franceze? Kufijtë janë shumë delikatë për t'u përcaktuar dhe prej ndjeshmërisë së lartë: të shkruash «Kuraasch» dhe jo më «courage» (guxim), u ngrihen qimet e kokës përpjetë brezave që janë mësuar me grafinë franceze, për shembull. Zotërinjtë Marteling dhe Eckert e pranojnë se ndonjëherë konsiderohen si shejtanë budallenj. «Ne rekomandojmë një përqasje tolerante, nuk duam të diktojmë. Jemi këtu për të marrë përgjegjësinë e zgjedhjeve; por nëse një fjalë nuk gjendet

në fjalorin tonë nuk do të thotë se ajo nuk ekziston», - përfundon Z. Marteling.

Nëse gjuha e shkruar, ose më mirë të themi «ortografia», siç përdoret gjerësisht këtu - dhe përse jo? - u përcaktua me një vendim ministror për herë të parë në vitin 1975, pak persona e zotërojnë atë. *Spellchecker.lu*, që është një korrigjues online falas, edhe i shkarkueshëm për programet e zyrave, u vendos për të lehtësuar këtë mungesë që s'ka një konkurent industrial serioz. Të gjithë bashkëbiseduesit tanë thonë se e përdorin për të dërguar ndonjë e-mail të rëndësishëm, për të korrigjuar ndonjë artikull, apo raportuar ndonjë mbledhje... Konceptuesi i logjistikut, Z. Michel Weimerskirch, një informaticien i cili krijoi në vitin 2013 një ndërmarrje të re për zhvillimin e faqeve në internet, duket pothuajse i habitur nga roli pilot që ai luajti në standartizimin grafik të gjuhës luksemburgeze. Sitin «*Spellchecker.lu*, e krijoja për vete! E nisa në universitet, në vitin 2008, si një sfidë. Në fakt është një hobi që u kthye në një kartvizitë, një vitrinë». Falë mjeteve informatike, vetëm në disa vite ai ka mundur të bëjë ekuivalentin e punës së disa dekadave për Akademinë



Për zgjedhjet e tetorit 2018, të gjitha partitë morën në mbrojtje gjuhën. Koalicioni midis liberalëve, social-demokratëve dhe ekologjistëve që përmbysën Partinë e pandërrueshme popullore kristiano-sociale në vitin 2013 (7), u bazua në premtimin se do të vendoste një «strategji për të promovuar gjuhën luksemburgeze» në njëzet vitet e ardhshme

franceze...«Faqet e internetit përbënë korpusin tim të parë. Shkrova algoritma, dhe mundësia për të automatizuar më lejoi që të përparoja shumë shpejt». Linku *Spellchecker.lu* përmban me shumë se 80.000 fjalë për formatet kryesore, përfshirë dublat franceze dhe gjermane dhe variantet ortografike. Është trefishi i fjalorit online luksemburgez! Një përparësi e padiskutueshme, por edhe një burim i thellë mosmarrëveshesh. Por kjo është një periudhë bashkëpunimi: Z. Weimerskirch po e përshtat këtë mjet për të përdorur ortografinë e përditësuar.


Para emergjencës së digjitalizuar, dhe që në vitin 1929, përçuesi kryesor në fushën e gjuhës nuk ishte tjetër veçse ... një radio, RTL Radio Lëtzebuerg, ku punonte Z. Marteling deri korrikun e shkurtit. Media zotëruese e vendit, që shpërndan dy orë televizive në ditë, e ka zyrën e saj në pllajën e Kirchbergut, që mbledh tok në qytetin lart institucionet financiare, europiane dhe selitë e shoqërive të mëdha në një dekor futurist. Ajo i përket të njëjtit grup si edhe dega e saj franceze, me të cilën ajo ndan imazhe nëpërmjet agjensisë Enex, por gëzon një status special, përfutur nga një ndihmë e Shtetit në dukatin e

madh. Përgjegjës i transmetimit online i kanalit, Olivier Treinen shprehet me sqimë: «Është një gjuhë akoma e re. Filma, filma vizatimorë, programe audiovizuale... po ndërtohet një identitet i ri në çastin kur luksemburgezët do të bëhen minoritarë në popullsinë e vendit. Tek gjuha vërehet një tension politik.»

Edhe pse gjuha luksemburgeze nuk ka pasur kurrë kaq shumë folës, ky tension manifestohet në tregti, si të ky dyqan buke në qendër të qytetit ku një person i moshuar mezi kuptohet me një punëtor të ardhur nga një vend tjetër kufitar. Kjo mund të jetë më sikletuese kur bëhet fjalë për çeshtje intime të shëndetit, me personelin e spitalit apo në një shtëpi të moshuarish. Por ky promovim i gjuhës «kombëtare» i shërben klasës politike si diversion dhe influencë sqaron Z. Siweck. Debatë publik mbi çështjet e identitetit u ashpërsua gjatë referendumit të qershorit 2015, ku u propozua që t'u lejohej të huajve që ishin vendosur në vend, për të paktën 10 vjet, të votonin në zgjedhjet kombëtare - kjo e drejtë ekzistonte tashmë për zgjedhjet lokale. «Kjo ide vinte, kryesisht, nga bota ekonomike, - shton ai. Shumë pak luksemburgezë punojnë në sektorin privat

(1). Drejtuesit e ndërmarrjeve ndihen gjithmonë e më pak të përfaqësuar nga institucionet, meqenëse elektorati vjen kryesisht nga funksionet publike dhe zotëron një sindikatë të fuqishme. Mjediset drejtuese nuk e durojnë një gjë të tillë. Qartazi, ambicia e tyre ishte që të ndryshonin dinamikën politike.» Rezultati pati efektin e një shuplake të fortë për gjithë elitën e vendit: 78% votuan «jo» !

Për zgjedhjet e tetorit 2018, të gjitha partitë morën në mbrojtje gjuhën. Koalicioni midis liberalëve, social-demokratëve dhe ekologjistëve që përmbysën Partinë e pandërrueshme popullore kristiano-sociale në vitin 2013 (7), u bazua në premtimin se do të vendoste një «strategji për të promovuar gjuhën luksemburgeze» në njëzet vitet e ardhshme. «Ne kemi ambicien se ajo luan rolin e vektorit të përbashkët në një shoqëri gjithmonë e më tepër të larmishme, plurikulturore, me njerëz, gjithnjë e më shumë që nuk e flasin gjuhën luksemburgeze në shtëpi ose që nuk e kanë gjuhë amtare», - shpjegon Z. Claude Meisch, ministër i arsimit kombëtar, përgjegjës i dosjes së gjuhëve. «Me shpejtimin e emigrimit dhe të një tregu pune shumë të hapur, tepër ndërkomëtar, pozita e qeverisë, madje dhe ndjenjat e popullsisë, kanë ndryshuar. Tani jemi të bindur se duhet promovuar gjuha luksemburgeze në një mënyrë shumë më aktive.» (8)



[1] Pa lidhje gjaku.
[2] « Europeans and their languages », Eurobarometër, Komisioni evropian, Bruksel, qershor 2012.
[3] Përveç një mocioni të kundërt, të dhënat vijnë nga Instituti kombëtar i statistikës dhe studimeve ekonomike (Statec), janar 2019.
[4] « Bashkimi i profesionistëve në Luksemburg, me banin në Francë, Gjermani, apo dhe Belgjikë », Inspektimi i përgjithshëm i sigurisë sociale, dukati i madh i Luksemburgut, 2019.
[5] Revista Regards, n° 9, Statec, maj 2019.
[6] Në fund të marsit 2019, sipas Inspektimit të përgjithshëm të sigurisë sociale, luksemburgasit zënë 87% të vendeve në administratë, dhe vetëm 19% në tregti dhe 9, 4% në ndërtim.
[7] Figura kryesore është Z. Jean-Claude Juncker, kryeministër që nga janari 1995 deri në dhjetor 2013 dhe president i Komisionit evropian nga nëntori 2014 deri në nëntor 2019.
[8] Lexo online intervista e plotë që na dha.

Tre muaj protesta

Irakenët kundër ndërhyrjes së Iranit

Iraku njohu një krizë të madhe sociale, e cila u rëndua nga korrupsioni dhe shkatërrimi i Institucioneve. Popullsia në revoltë që prej tre muajsh, vuri në diskutim sistemin politik, bazuar mbi sektarizmin dhe fenë. Kundërshtimi që për momentin është thelbësisht çështje e shiitëve, denoncon praninë e gjithanshme të ndikimit iranien.

NGA FEURAT ALANI *

A fërsisht 450 të vdekur dhe 20 000 të plagosur midis 1 tetorit dhe gjysmës së dhjetorit: bilanci është i tmerrshëm. Që nga sheshi Tahrir, në zemër të Bagdatit, deri në qytetet në jug të Irakut, me mijëra manifestues protestojnë kundër qeverisë dhe ushtrisë që e mbështet duke shpallur fundin e sistemit politik që drejton vendin që në vitin 2003, e cila është dhe data e rënies së regjimit të diktatorit Saddam Hysein. Dialogu midis pushtetit dhe protestuesve në rrugë duket se është ndërprerë. Kryengritjet dhe vrasjet e të rinjve militantë vazhdojnë edhe pas masakrës së natës së 6 dhjetorit, kur 24 persona (20 manifestues dhe 4 policë) që ishin vendosur në parkim ngun me kate, një vend konvergjence për protestuesit, u vranë nga milicë të paidentifikuar. Që pas dorëheqjes së kryeministrit Adel Abdel-Mahdi, më 29 nëntor, klasa drejtuese qëndroi e shurdhër ndaj pretendimeve të rinisë së saj dhe kërkoi që të zgjidhej një kryetar i ri qeverie, pasi i vjetri po nxitonte të mbyllte pa kujdes të gjitha çështjet. Gjashtëmbëdhjetë vjet pas rënies së Bagdatit, që erdhi si rrjedhojë e pushtimit të vendit nga trupat amerikane dhe aleatët e tyre, veçanërisht ata britanikë, vendi përjetoi një krizë të paparë deri më tani.

Kjo faqe e re e historisë irakene u hap më 27 shtator. Atë ditë, dy ngjarje ndezën zjarrin e zemërimit. Fillimisht shpërbërja e dhunshme dhe e pajustificuar e një grumbullimi të diplomuarish që ishin të papunë, para zyrave të kryeministrit. Më pas shkarkimi e një njeriu të konsideruar si një hero kombëtar për rolin e tij në betejën kundër Organizatës së Shtetit Islamik (OEI): Zëvendës-generali Abdel Wahab Al-Saadi, komandant i dytë i Shërbimit iraken të luftës kundër terrorizmit (CTS). Një numër i caktuar irakenësh ishin të mendimit se pas këtij shpërthimi qëndronte dora e Iranit, njeriu që ishte njeri i amerikanëve dhe i CTS-së, ku në fakt ishte shefi i tyre, përbënte një pengesë përballë ambicieve hegjemonike të Hachd Al-Chaabi, dhe Bashkimit të mobilizimit popullor. I krijuar në vitin 2014 për të vazhduar luftën e shenjtë kundër OEI-së, pas rënies së Mosulit, ky koalicion i përbërë nga shumë milicë paraushtarakë, me shumicë shiite, është financuar nga Irani dhe është stërvitur nga gardianët e revolucionit, që është dhe krah i armatosur i Teheranit në atë zonë. Ndërshkimi i të diplomuarve dhe lënia mënjane e një heroi kombëtar për të kënaqur Teheranin. Këto dy fakte përmbledhin motivimin e dyfishtë të Hirakut: zemërimi kundër një situatë ekonomike dhe shoqërore të degraduar dhe neveritje nga ndikimi iranien. Edhe

pse spontane, kryengritjet aktuale, të fundit si datë në një seri të gjatë protestash që në vitin 2003, nuk janë tjetër veçse pasojat e gjashtëmbëdhjetë viteve premtimesh të pambajtura. Problemet endemike që ekzistojnë në vitin 2003 u fshinë: korrupsioni, klientelizmi, papunësia, dhuna e armatosur, sistemi politik jo efikas dhe gati i mbaruar. Ose vendi nuk ka qenë kurrë kaq i pasur, buxheti i shtetit ka përfituar nga të ardhurat e çmimeve të mira të naftës, që për vitin 2019, shkuan në 112 miliardë dollarë (hidrokarburet zinin 99% të eksporteve). Paralelisht, ngritja e korrupsionit shtetëror u thellua akoma më shumë. Në fillim të vitit 2019, një komision i Parlamentit pohoi se në gjashtëmbëdhjetë vjet, ky korrupsion kishte përlarë 200 miliardë dollarë, ose dyfishin e prodhimit të brendshëm bruto (PBB).

Me 50% të papunë, rinia është viktima e parë e këtij shpërdorimi. Vetëvrasja e aprovuar nga feja muslimane, nuk përbën më një temë tabu. Midis viteve 2016-2018, Komisioni shumëzyrtar i të drejtave të njeriut të Parlamentit njohu një rritje prej më shumë se 30% vetëvrasjesh, dhe që shkoj nga 383 në 519 raste. Edhe pse në të vërtetë e nënvlerësuar, këto shifra shkaktuan një emocion të madh në popullatë. Më e rënda: në vitin 2019, shumë nga këto akte të dëshpëruara u kryen në mënyrë të drejtpërdrejtë në rrjetet sociale. Që në vitin 2013, arsimi që lënë në harresë nga shumë qeveri. Sot mungojnë më shumë se 20 000 shkolla; në vetëm një klasë mblidhen rreth 80 nxënës. Më alarmante akoma: 130 000 fëmijë nuk janë shkolluar në arsimin fillor gjatë vitit shkollor 2017-2018 (1). Nëse flasim për gjithë territorin e Irakut, problemi është akoma më i thellë në zonat e pushtuara nga OEI. Pikërisht për të kërkuar me ngulm një ndryshim, rinia zbriti në rrugë.

«Ky brez nuk ka mundësi për të udhëtuar, por është shumë i lidhur me mediat e reja. Ai shikon së jashtë shtetit, moshatarët e tyre jetojnë shumë mirë, dhe ndonjëherë në vende më të varfëra sesa Iraku. Të jetosh në një vend ku nuk zbatohet drejtësia, ku ka ushtarë të armatosur gjithandej, nuk është më diçka e pranueshme. Kjo krizë është akoma më e thellë sesa të parat. Kësaj herë denoncohet një sistem i tërë, dhe pikërisht për këtë arsye përgjegjësit politikë qëndrojnë të heshtur. Kjo ndodh sepse kërcënohen interesat e tyre “personale”, - shpjegon Moustafa Saadoun, themelues i Observatorit iraken të të drejtave të njeriut. Ky gazetar që jetonte në Bagdad ishte një prej liderve të manifestimeve në sheshin Tahrir në vitin 2015. Protestuesit i kërkonin reforma sociale qeverisë së kryeministrit Haidar Al-Abadi. «Në vitin 2015 ishte shumë më pak e dhunshme sesa sot.



Nga protesta t në Irak. Foto VOA

NË MES TË DHJETORIT, ZEMËRIMI POPULLOR PREKTE VETËM KRYEQYTETIN DHE QYTETET E MËDHA SHIITE SI NASSIRIYAH, KERBALA, NADJAF, AMARAH, BASSORAH. NË JUG, ME SHUMICË SHIITE, TË RINJTË SHPREHIN DËSHIRAT E TYRE PËR T'I DHËNË FUND REGJIMIT TË NGRITUR NË RAPORT ME FORCAT SEKTARE, KU FEJA ËSHTË ÇELËSI I QEMERIT TË JETËS POLITIKE

Pastaj ne mblidheshin vetëm të premtete. Ndërsa sot, sapo u bënë dy muaj protesta, kemi pothuajse 500 të vranë! Të gjithë qenë paqësorë: askush prej tyre nuk ishte i armatosur », - revoltohet Saadoun.

Përveç gjendjes së keqe social-ekonomike të vendit, prania e gjithanshme iraniane është një prej karburanteve të revoltës. Me premtimin për demokraci nga pushtuesit e tij amerikanë në vitin 2003, Iraku u zu në morsi. Prania e trupave të huaja në tokën e tij, çmontimi i strukturave të regjimit të vjetër, zhdukja e shumë institucioneve, sektarizimi i atyre që mbetën, ndikimi mbizotërues i një numri kundërshtarësh që kishin jetuar për një kohë të gjatë jashtë vendit dhe që nuk e njohin akoma realitetin e dobësuar në mënyrë të konsiderueshme aparatit shtetëror. Kjo u hapi rrugën ndërhyrjeve të Iranit dhe të Shteteve të Bashkuara.

Por, që në vitin 2011, data e tërheqjes së trupave amerikane, gjë që u vendos nga administrata e Z. Barack Obama, fqinji pers fitoi autoritet ndaj rivalit të tij. Nëntorin e kaluar, faqja e internetit *The Intercept* publikoi telegramet iraniane duke zbuluar atë që për pjesën më të madhe të irakenëve nuk ishte tjetër veçse një sekret polishineli (sekret që gjithkush e di por nuk e tregon), përhapje e infiltrimit iranien në të gjitha shtresat e qeverisë. Mund të flasim për një entrizëm kombëtar me flamuj të shpalosur, aq i madh ishte ndikimi, nga veriu në jug, nga lindja në perëndim. Ndikimi është i tillë sa që elementë irakenë që bashkëpunonin me Central Intelligence Agency (CIA) u rekrutuan menjëherë nga shërbimet iraniane menjëherë pas ikjes së trupave amerikane. Burimet

që lejuan daljen e këtyre dokumenteve ishin irakene, gjë që qartëson zemërimin e një kordoni të rëndësishëm të shërbimeve të sigurisë.

«NE DUAM NJË KOMB»

«Gjatë historisë së tij, Iraku ka përfunduar duke u ngritur kundër pushtuesit, ose kundër çdo forme shtypjeje. Sulmet e qeverisë kundër arsimit, korrupsioni endemik, menaxhimi i keq i politikës së vendit, nxitën zemërimin e rinisë », - analizon Z. Mountadhar Nasser, vëzhgues dhe militant i të drejtave të njeriut që ka marrë pjesë në të gjitha manifestimet në sheshin Tahrir që në vitin 2015. Më 1 tetor 2019, një nga parrullat e para popullore nuk kishte të bënte me ndërprerjen e energjisë elektrike, as me vendet e punës, por kishte të bënte me një vizion kombëtar, i cili nëpërkëmbej që në vitin 2003: «*Noreed Watan*» (Ne duam një komb). «Për të ndërtuar të ardhmen e vendit, baza është arsimimi. Dhe motorri i tij është autonomia politike e një qytetarie të rigjetur, - shpjegon Z. Hatem Al-Zaidi, një protestues i sheshit Tahrir. Ne nuk do të pranojmë asnjë ndërhyrje të huaj në punët e Irakut, nuk duam as nga Irani dhe as nga Shtetet e Bashkuara . . .»

Gjatë ditëve të para të revoltës, qeveria nguli këmbë që mos të dëgjonte njerëzit në rrugë. Ajo e ndërpreu lidhjen me internetin dhe turbulloi komunikimin. Padyshim që kjo sjellje e zgjeroi më tej lëvizjen. Të izoluar nga pjesa tjetër e botës, manifestuesit i bënë ballë vdekjes dhe milicëve të afër me pushtetin, ndonjëherë të mbështetur nga elementë iranienë, identiteti i të cilëve u zbulua në rrjetet sociale. Zemërimi kundër Iranit është ushqyer rregullisht nga peripecitë e jetës politike, që mundohen të tregojnë se Bagdati është nën ndikimin e Teheranit. Në prill të vitit 2019, deputetë që ishin pranë Republikës Islamike paraqitën me urgjencë një projekt-ligj që kërkonte me ngulm tërheqjen e trupave amerikane që ishin të pranishme në Irak që në vitin 2014 në kuadrin e luftës kundër OEI-së. Edhe pse nuk i ka shpëtuar askujt fakti që ajatollahu Ali Khamenei sapo kishte kërkuar këtë tërheqje kryeministrit Mahdi duke e pritur në Teheran. Një hetim këmbëngulës që koincidonte me një kulmin tensioni midis Iranit dhe Shteteve të Bashkuara pas vendimit të administratës së Z. Donald Trump për të shënuar gardianët e revolucionit në listën e organizatave terroriste. Këtë instrumentalizim të

vendit të tyre nga fqinji, e përcmonin më tepër një numri irakenësh se Bagdatit lindor, i cili është gjithmonë gati të denoncojë ndërhyrjet perëndimore.

9 dhjetor, ambasadorët e Gjermanisë, Kanadasë, Francës dhe Mbretërisë së Bashkuar u mblodhën në Ministrinë e Punëve të Jashtme pasi kryeqytetet e tyre i bënë thirrje qeverisë për të ndaluar milicët të përdornin dhunën kundër manifestuesve. Popullsia shqetësohet, gjithashtu, për ndikimin progresiv të Hachd Al-Chaabi, i cili ishte integruar tashmë të paktën në teori, në aparatit e sigurimit, por që falë mbështetjes së Teheranit, vepruan si një Shtet brenda Shtetit, duke e ftuar në debat politik. Pas masakrës së 6 dhjetorit, kryetari i tyre u ka kërkuar njerëzve të tij që të mos u afroheshin manifestuesve. Por ky urdhër që rëndoi dyshimet përse i përket përgjegjësisë së milicëve në këto vrasje, nuk pati gjithmonë efekte, anëtarë të shumtë të këtyre njësive ishin të pakontrollueshëm. Pa asnjë surprizë, protestuesit dolën kundër interesave iraniane. Më 4 nëntor, konsullata e Iranit u sulmua në Kerbala. Më 27 nëntor, konsullatës së një qyteti tjetër të shenjtë të shiizmit, nadjafi iu vu flaka nga një turmë e zemëruar. Gjithçka ishte shkruar në sfondin e sloganeve që u shndërruan në himnet e revoltave : «Iran, Iran, jashtë, Bagdati do të jetë i lirë !» Motoja e përsëritur më 9 dhjetor në Kerbala gjatë funeralit të Fahem Al-Tai, një figurë emblematike e manifestuesve, i cili u qëllua të nesërmen para shtëpisë së tij nga disa qitës me motor. Për rininë e revoltuar, të kërkoje «një vend të lirë» ishte një kthim natyror drejt nocionit të humbur që të nesërmen e rënies së regjimit të Huseinit. Identiteti irakian.

SUNITËT JANË AKOMA TË HESHTUR

«Po përjetojmë një moment që e kemi pritur prej shumë kohësh. Kjo është historike. Kemi qenë të izoluar dhe të ndarë që prej vitit 2003. Identiteti irakian u përbuz, dhe mbi të gjitha u deformua nga qeveria, që e ka asimiluar gjithmonë me nostalgjinë e regjimit të Saddam Hysein. Ndërkohë që shumica e të rinjve manifestues nuk e kanë njohur fare këtë epokë! Ajo që ne kërkojmë sot, është që ky identitet të jetë motorri i vetëm i Shtetit irakien ; ne duam vetëm që të njihemi si qytetarë », - ankohet Z. Nasser.

Në mes të dhjetorit, zemërimi popullor prekte vetëm kryeqytetin dhe qytetet e mëdha shiite si Nassiriyah, Kerbala, Nadjaf, Amarah, Bassorah. Në jug, me shumicë shiite, të rinjtë shprehin dëshirat e tyre për t'i dhënë fund regjimit të ngritur në raport me forcat sektare, ku feja është çelësi i qemerit të jetës politike. Këto aspirime janë të njëjtat me ato të bashkëpatriotëve të tyre sunitë, që për momentin po qëndrojnë në heshtje. E shmangur për vite me radhë nga një sistem politik që u ishte mirënjohës dy fuqie të huaja që ndërhyjnë hapur, kërkesa ndaj respektit të identitetit kombëtar varet nga një mobilizim që shkonte përtej copëtimit fetar.

* Gazetar. Autor së bashku me Léonard Cohen, i veprës *Parfumi i Irakut*, Botimet Nova, 2018.

[1] «Programi shkollor në Irak, një pasqyrim në mes të shkatërrimit » (arabisht) Daraj, Beyrouth, 10 mars 2019.

[2] James Risen, Tim Arango, Farnaz Fassihi, Murtaza Husain dhe Ronen Bergman, «A spy Complex revealed», The Intercept (me *The New York Times*), 18 nëntor 2019, <https://theintercept.com>

EKZODI MASIV I BALLKANIT

Shpopullimi në paqe

Përderisa është inicuar projekti për “Mini-Shengen” ballkanik, i cili ka për qëllim lëvizjen e lirë të mallrave, shërbimeve, kapitalit dhe e fuqisë punëtore; po vazhdon shpopullimi masiv i shteteve të Ballkanit Perëndimor. Vendet e rajonit sigurojnë për liberalizmin ekonomik evropian një fuqi të lirë punëtore dhe shërbejnë si një « tampon zonë », që kontrollojnë flukset e migracionit. Një rol i dyfishtë, të cilin e kanë shfrytëzuar politikanët lokalë.

NGA SHKODRAN HOTI

Lëvizja e plotë dhe e lirë e mallrave, shërbimeve, kapitalit dhe e fuqisë punëtore përgjatë tërë rajonit, për të gjeneruar zhvillim, në një ekonomi që ndryshon vazhdimisht dhe të globalizuar. Ky është synimi i deklaruar i nismës rajonale të quajtur “Mini-Shengeni” ballkanik.

Përtej kritikave aktuale mbi këtë projekt, në ndërkohë, paralelisht me iniciativat për hapjen e tregut, po vazhdon shpopullimi masiv i shteteve të Ballkanit Perëndimor. Ky emigrim masiv po thëllon çdo ditë e më tepër krizën demografike, që kompromiton të ardhmen, mbase edhe mbijetesën e këtyre shteteve.

Statistikat thonë se rreth 8.655.000 njerëz kanë braktisur Ballkanin që nga rënia e murit të Berlinit më 1989, kur u lehtësua liria e lëvizjes, kapitalit, mallrave dhe njerëzve.

Institucione dhe organizata të ndryshme (jo) qeveritare paraqesin të dhëna të shpeshta dhe nganjëherë të ndryshme mbi migrimin.

Raporti “Migrimi i Ballkanit Perëndimor në BE”, publikuar nga European Policy Institute of Kosovo (EPIK), tregon se 2.979.766 qytetarë nga shtetet e Ballkanit Perëndimor kanë emigruar në shtetet e BE-së për një dekadë, gjatë periudhës 2008-2018. Sipas të dhënave nga ky Institut, 1.599.971 (54%) kanë migruar në mënyrë të ligjshme, duke fituar lejen e qëndrimit, 808.030 qytetarë (27%) janë zënë ilegalisht brenda shteteve të BE-së, teksa 571.765 qytetarë (19%) kanë kërkuar azil.

EPIK analizën e kanë bazuar në mbi tri kategori të dhënash të EUROSTAT-it për këtë periudhë kohore: Numrin e aplikimeve për azil në BE, numrin e qytetarëve të zënë ilegalisht të pranishëm në BE dhe numrin e lejeve të qëndrimit të lëshuara për herë të parë në BE.

Sipas EPIK, Shqipëria është shteti me trendin më të lartë të emigrimit, pasi që për këto dhjetë vite, ajo u braktis nga 1.249.706 qytetarë, 44% e popullsisë së saj. Serbia listohet si e dyta, nga e cila në periudhën 2008-2018, u larguan 588.033 qytetarë, 8% e popullsisë.

Sa u përket qytetarëve të zënë duke qëndruar ilegalisht në BE, gjatë periudhës 2008-2018 janë zënë 451,015 shtetas të Shqipërisë. Sipas EPIK kjo është më shumë se numri i shtetasve të kësaj kategorie nga të gjitha vendet e tjera të rajonit të marra së bashku.

Me fjalë të tjera, 16% e popullsisë së Shqipërisë është zënë ilegalisht në BE gjatë

Tridhjetë për qind (30%) e popullsisë është larguar nga Kosova në dhjetëvjeçarin e parë pas shpalljes së pavarësisë: 529.647 kosovarë, prej të cilëve 171.690 kanë kërkuar për herë të parë azil në vendet e Bashkimit Evropian, 216.057 kanë marrë lejeqëndrimin për herë të parë dhe 141.900 të tjerë kanë qëndruar në mënyrë të paligjshme.

kësaj periudhe. Shqipëria ka udhëqur rajonin edhe me numrin e shtetasve që kanë fituar lejen e qëndrimit në BE. 622,171 shtetas të saj e kanë fituar atë gjatë periudhës 2008-2018. Kjo përbën 39% të qytetarëve nga i tërë rajoni që kanë fituar leje qëndrimi në BE. Shqipëria ka udhëhequr rajonin edhe me numrin e qytetarëve të cilëve u është refuzuar hyrja në BE.

Sipas INSTAT, emigracioni në Shqipëri po shkakton mbyllje të shkollave, boshatisje të vendit, rëndim të skemës së pensioneve, plakje të popullsisë dhe ulje të numrit të lindjeve, duke bërë që me këto ritme deri në vitin 2030, numri i shqiptarëve të zbresë në 1 milionë.

EPIK nënvizon se nga Bosnja dhe Hercegovina emigruan 318.271 qytetarë (9% e popullsisë), nga Maqedonia e Veriut 258.020 qytetarë (12%); si dhe nga Mali i Zi 36.089 qytetarë (6% e popullsisë).

Tridhjetë për qind (30%) e popullsisë është larguar nga Kosova në dhjetëvjeçarin e parë pas shpalljes së pavarësisë: 529.647 kosovarë, prej të cilëve 171.690 kanë kërkuar për herë të parë azil në vendet e Bashkimit Evropian, 216.057 kanë marrë lejeqëndrimin për herë të parë dhe 141.900 të tjerë kanë qëndruar në mënyrë të paligjshme.

Sa u përket vendeve të BE-së të cilat kanë pranuar më së shumti azilkërkuues, Gjermania prin me 83,880, e ndjekur nga Franca, me 41,885. Sa u përket vendeve ku qytetarët e Ballkanit janë zënë duke qëndruar ilegalisht, prinë Greqia me 280,850 dhe Gjermania me 52,220.

Enti i Statistikave Federale Gjermane (Destatis) ka bërë të ditur së fundi se numri i njerëzve nga jashtë BE që punojnë në Gjermani është rritur me 20 përqind gjatë një viti të kaluar. Destatis raporton se gati 25% e tyre janë nga Ballkani Perëndimor, përkatësisht nga Shqipëria, Mali i Zi, Kosova, Maqedonia, Serbia dhe Bosnja e Hercegovina. Në vitin 2015, kishte vetëm rreth 9%.

Arton Lipa me 6 shokë të tjerë ishin nisur për Gjermani. “Nga Subotica u nisëm drejt kufirit hungarez në ora tetë e mbrëmjes. Kishim frikë senuk njihnim terrenin. Rruga zgjati rreth pesë orë. Kur kaluam në Hungariu arrestuam dhe

dërguam në një kamp. U liruar pas dy ditësh me një urdhër me shkrim që të largoheshim nga Hungariabrenda 72 orësh”, rrëfen Artoni. Pasi kishte paguar 1000 euro për të kaluar në Gjermani, ai ishte arrestuar sapo kishte zbritur në Augsburg. “Kërkuam azil dhe na dërguan në një kamp me rreth 50 veta. Qëndruam rreth dy javë aty. Pastaj fituam lejeqëndrimin e përkohshëm dhe na jepnin nga 320 euro në muaj. Pas 6 muajsh u njoftuam se nuk na ishte pranuar kërkesa për azil dhe na kthyen në Kosovë”, shpjegon Artoni.

Më 1 Mars 2020 hyjnë në fuqi rregulla të reja rreth imigrimit të fuqisë punëtore të kualifikuar në Gjermani. Ligji i ri zgjeron mundësitë tashmë ekzistuese për punëmarrësit/et e kualifikuar/a nga shtete që nuk janë pjesë e BE-së si Shqipëria, Maqedonia dhe vende të tjera të cilët kërkojnë të nisin një marrëdhënie punësimi në Gjermani.

Një ligj që do të mundet ndoshta t’i ndihmojë Enis Salihut (23 vjeç), i cili ka dy vjet që pret për vizë gjermane me të dashurën e tij. “Kam kryer praktikën me pagesë në BiCredit. Nuk ja vlente sepse paga ishte shumë e vogël. Dyqind euro për tetë orë punë është shumë pak dhe nuk mjaftojnë as për nevojat elementare”, tregon Enisi që ka diplomuar në Fakultetin Ekonomik.

EMIGRACION MË I MADH
SENË KOHËN E LUFTËS

Sipas të dhënave të publikuara nga Ministria e Punëve të Brendshme e Kosovës në raportin e titulluar “Profil i zgjeruar i migrimit 2013 – 2017” ka një trend në rritje të emigrimit në Kosovë përgjatë viteve 2013/2015, ndërsa ai bien relativisht gjatë viteve 2016 dhe 2017.

Në vitin 2013 rezultoi të kenë emigruar 20.246 qytetarë. Më shumë se dyfishi i tyre emigruan në vitin 2014: 45.333. Dukshëm



më shumë emigruan një vit më vonë (2015): 74.434. Në vitin 2016, shifra e të larguarve nga Kosova bie në 22.012, derisa një vit më vonë (2017), kjo shifër përgjysmohet në 11.263. Në këtë periudhë pesëvjeçare llogaritet se nga Kosova emigruan rreth 9% e popullsisë.

Ky trend rezultoi shumë më i lartë krahasuar edhe me vitet e '90-ta, kur ishte periudhë luftë. Në raportin "Migrimi Kosovar" të Agjencionit të Statistikave të Kosovës, vërehet se nga viti 1960 deri në vitin 1988, numri i atyre që kanë ikur nga Kosova në asnjë vit nuk prek shifrën 5000. Rritje e hovshme vërehet nga 1990 deri në vitin 1999, e në veçanti në vitet 1998 dhe 1999, vite të luftës. Gjatë këtyre dy viteve raportohet që të kenë emigruar nga Kosova 51.728 banorë (21.973 gjatë vitit 1998 dhe 29.755 përgjatë vitit 1999). Kjo shifër është rreth tri herë më e vogël në vitin 2000, një vit pas mbarimit të luftës, por nga viti 2001 e deri në vitin 2009, trendi është pothuajse gjatë gjithë kohës në rritje.

Studiuesi dhe ligjëruesi i politikave sociale, Artan Mustafa, thotë se nga 2011 deri më tani, nga projeksionet e bëra atëherë, rezultoi se 15% e popullsisë që do ta kishte Kosova sot, ka emigruar nga ky vend. Ai thotë se në këtë periudhë kemi emigracionin më të lartë që nga viti 1966, që shtetë krizë e jashtëzakonshme. Arsyet e kësaj, Mustafa i ndërlidh edhe me gjendjen e rëndë në Kosovë, por edhe me fenomenet globale.

"Njëra prej arsyeve kryesore është ndërkombëtarizimi i madh i tregut, dominimi i madh i qasjes neoliberale ekonomike. Emigracioni është fenomen që nuk kufizohet vetëm te Kosova. Kapitalistët e mëdhenj nëpër Evropë, pavarësisht çfarë thonë qeveritë e shteteve të tyre, janë të interesuar për këtë emigracion. Është mjet për t'i rezistuar kërkesave të klasës së mesme në Evropë dhe njëkohësisht punë e lirë që iu shërben", shpjegon Mustafa.

Një gjë e tillë në Gjermani vërehet me zbutjen e vazhdueshme të rregullave të emigracionit, si pasojë e nevojës së shtuar për fuqi punëtore. Kjo edhe përkundër ndjenjës në rritje kundër emigrantëve, jo vetëm në këtë shtet, por edhe në mbarë Evropën.

Paketa e emigracionit në Gjermani ka qenë subjekt diskutimi edhe në gjysmën e parë të vitit 2019. Ajo kishte marrë dritën jeshile në Bundestagun gjerman. Me këtë rast u bë me lehtë mundësia për të shkuar në këtë vend që të mësosh një zana, duke qenë e mjaftueshme shkolla në vendin e prejardhjes. Po ashtu, ndryshimet në ligjin e migracionit parashohin hapje të mundësisë për profesionistë të të gjitha

"Njëra prej arsyeve kryesore të emigrimit masiv është

ndërkombëtarizimi i madh i tregut, dominimi i madh i qasjes neoliberale ekonomike.

Kapitalistët e mëdhenj nëpër Evropë, pavarësisht çfarë thonë qeveritë e shteteve të tyre, janë të interesuar për këtë emigracion. Është mjet për t'i rezistuar kërkesave të klasës së mesme në Evropë dhe njëkohësisht punë e lirë që iu shërben"

ARTAN MUSTAFA

fushave, si dhe barabarësi në tregun e punës, duke mos pasur përparësi për shtetasit gjermanë, apo ata të BE-së.

Artan Mustafa vlerëson që janë dy kategori të qytetarëve të Kosovës që kryesisht po emigrojnë jashtë vendit. Sipas tij kategoria kryesore që përbën shumicën janë të rinjtë dhe klasa punëtore, sidomos nga viset rurale, arsyeja e emigrimit të së cilëve ndërlidhet më shumë me përmirësimin e statusit të tyre social.

"Një kategori tjetër janë një elitë që kanë qenë tradicionalisht më të pasur dhe më kozmopolitane, e që arsyet e ikjes së tyre nga vendi janë kryesisht kulturore, porse kjo kategori është dukshëm më e vogël numerikisht", shton ai.

Ndërsa, lidhur me dyndjen më të madhe të emigrantëve kosovarë në Gjermani, ai thekson reformat e vazhdueshme në ekonominë politike të këtij shteti që nga viti 1998. Teksa shton se emigrantët përfundojnë duke zënë vendet

e punës që nuk janë tërheqëse për klasën e mesme gjermane.

Një vend pune në Gjermani po e synon edhe Albert Bajraj, 34 vjeçar, i cili edhe pas dy vitesh, nuk ka ende përgjigje për vizë. Ai shpreh zhgënjim me trajtimin që i bëhet punëtorëve në Kosovë. "Nëse e bëj një përlogaritje të mesatares së pagës që kam marrë në punë të ndryshme tash e 10 vite, ajo nuk e mbërrin 500 euro, të pamjaftueshme për një familje. Unë edhe pse me kualifikim master dhe me një numër të madh trajnimesh e programesh profesionale dhe akademike, nuk e konsideroj veten të vlerësuar në Kosovë. Këtu punësimi bëhet me referenca partiake, familjare e klano-re dhe kjo gjë e pamundëson jetën me dinjitet", shprehet Bajraj.

SIPAS INSTAT, EMIGRACIONI NË SHQIPËRI PO SHKAKTON MBYLLJE TË SHKOLLAVE, BOSHATISJE TË VENDIT, RËNDIM TË SKEMËS SË PENSIONEVE, PLAKJE TË POPULLSISË DHE ULJE TË NUMRIT TË LINDJEVE, DUKE BËRË QË ME KËTO RITME DERI NË VITIN 2030, NUMRI I SHQIPTARËVE TË ZBRESË NË 1 MILIONË.

SISTEMI JOZHVILLIMOR

Ikja e qytetarëve që kanë të përfunduara studime universitare është dukuri mjaft e shpeshtë. Emigrimi i tyre nga Kosova është në rritje dhe ky fenomen i njohur si "ikja e trurit", veçanërisht është problematizuar gjatë vitit 2019. Është nënvizuar sidomos ikja e mjekëve pikërisht në drejtim të Gjermanisë, të cilët ballafaqohen me mungesë punësimi ose me paga të vogla. Vetëm në vitin 2019, sipas të dhënave të tyre, 105 mjekë kanë kërkuar certifikatën e pastërtisë




Photo by Oleg Magni from Pexels

KY KAPITALIZËM QË DREMIT NË SECILIN PREJ NESH

Jeta dhe vdekja e borgjezit të vogël të sjellshëm

Si ta luftojmë një rend shoqëror që ka instaluar tek ne vetë mënyrat e tij të të parit të botës? Kjo dilemë përshkuan veprën e sociologut Alain Accardo, tamam si figura që ai mishëron: ajo e borgjezit të vogël të sjellshëm, i shpërndarë midis dëshirave të tij zhgënjyese dhe revoltës së ndaluar. Kriza klimatike dhe ekzigjenca e një ekologjie antikapitaliste do të lajmërojnë fundin e këtij lloji njerëzor?

NGA ALAIN ACCARDO *

Nëse në garën e monopolizimit të kapitalit industrial dhe financiar, borgjezia e madhe ka ruajtur avantazhet e veta klasike, përkundrazi, në fushën e mbledhjes së kapitalit simbolik dhe kulturor (veçanërisht në formën e saj shkollë dhe universitare), borgjezia e vogël ka bërë më shumë sesa të mbështeste krahasimin me borgjezinë e madhe. Ajo krijoi diçka duke nisur nga asgjëja, të paktën duke kontribuar gjerësisht në zhvillimin dhe shpërndarjen nëpërmjet botës, të një stili jete të karakterizuar nga gjithë pushteti i parasë, kulti i guximit sipërmarrës, lëvizja afariste, sjellja drejt një konsumimi detyrues dhe morali miop i grimuar i gjithi nga një lloj spiritualiteti fasadash në lidhje me modelin amerikan.

Ky «shpirt i ri i kapitalizmit», siç e kishte pagëzuar Luc Boltanski dhe Eve Chiapello (1), ia kishte dalë mbanë që para krizës së madhe të vitit 2008 të kolonizonte gjykimet dhe ndjeshmëritë, duke u futur bile edhe në mjediset më të pabindura në parim të shpirtit borgjez, dhe më të favorshme tradicionalisht ndaj vlerave të humanizmit progresist apo dhe ideve të socializmit revolucionar. Për Boltanskin dhe Chiapellon, ky orientim ideologjik ishte shumë i lidhur me peshën gjithmonë në rritje që po merrte borgjezia e vogël e re e kuadrove, e të diplomuarve me studime të larta, e universitarëve, e artistëve dhe grupeve të tjera hyrëse, të rinj në kapital kulturor, po që shumoheshin me nevojat sociale gjithmonë në rritje të hierarkisë, arsimit, informacionit, këshillimit, prezantimit, zbavitjes etj. Punonjësit e viteve 2000 ishin gjithmonë të ngarkuar me zinxhirë, por një numri të mirë prej tyre, ata zinxhirë u dukeshin më pak të rëndë. Ose të paktën kjo ishte ajo për të cilën Shkolla e Republikës dhe Shtypi i Kryeqytetit konkuronin me njëri-tjetrin për t'i bindur. Ata e ndiqnin me një hap të sigurtë ndryshimin, që kishte nisur që në vitin

1968, dhe që në një gjysmë shekulli, siç mund ta masim në ditët e sotme, i shpuri klasat e mesme (jo pa i zhvilluar nëpërmjet infektimit simbolik në njëfarë mënyre, drejt klasave popullore të urbanizuara) që ta shihnin veten dhe të silleshin sikur të ishin shndërruar në qenie të paafta për t'i imponuar vetes të tjera formula, një tjetër ideal jete, të ndryshëm nga ai i shpallur nga priftërinjtë e mëdhenj të narcizizmit të borgjezisë së vogël të gjysmës së parë të shekullit të XX.

Ky ideal, ashtu siç ishte gdhendur dhe nga Andre Gide (veçanërisht nga ai) në mermerët e *Ushqime tokësore* (1897), duke i kërkuar gjithkujt që ta kthejë veten e tij drejt dhe kundër të gjitha tabuve, «qënien më të pazëvendësueshme në botë». Po ashtu, Paul Valéry në librin e tij *Narcisse* (1890) nxiste secilin që të «humbiste në veten e tij» për të mësuar «të adhuronte dhe të bashkohej me Unin e tij të pashtershëm». Në vetvete, një program i tillë mund të ishte tërësisht tërheqës nëse nuk do të kishte përfshirë midis kushteve të tjera lejuese, vendosjen e konkurrencës më të keqe individualiste. Në fund të fundit, ky ultimum, moralisht vdekjeprurës, gjendet në penën e të gjithë letrarëve tanë të mëdhenj dhe mendimtarëve që nga Rilindja dhe rimarrja e trashëgimisë antike. Nga Znj La Fayette deri tek Marguerite Duras, nga Montaigne deri tek Jean-Paul Sartre apo dhe Andre Malraux, letërsia dhe, akoma më gjerë, të gjitha artet perëndimore nuk pushuan së lëvduari fuqitë personale të Unit dhe të shtypit çdo individ që ta kthejnë jetën e tyre në një vepër arti të adhurueshme, të ngjashme me asgjë tjetër në botë, duke harruar të saktësojnë se përmes kushteve konkrete të një arritjeje në jetën e gjithsecilit, në mënyrë të pashmangshme, ka dhe në një sistem ultrakonkurrenës, ku nuk do të dinim të bënim abstraksion, shkatërrim, deri dhe në vrasje, pak a shumë në një shkallë të madhe, të njëfarë numri të të tjerëve.

Pabarazi, krenari dhe humbje kohe

Zbulojmë sot me dëshpërim atë që kritika marksiste vinte në dukje që në vitin 1844: se fjalimi i humanizmit abstrakt, idealist dhe i çmuar mbi thelbin e

Njeriut universal dhe aftësia e tij për të dominuar botën ka një tendencë të pakëndshme për të bërë iluzion mbi fatin konkret të njerëzve real dhe mbi nënshtimin e masave ndaj oligarkisë. Në vitet 2000, zëdhënësit e neoliberalizmit si të së djathtës ashtu dhe të së majtës, e kishin humbur nga sytë, duke supozuar se nuk e kishin




Photo Collection Catherine Gide © Editions Gallimard

Andre Gide

Ky «shpirt i ri i kapitalizmit», siç e kishte pagëzuar Luc Boltanski dhe Eve Chiapello (1), ia kishte dalë mbanë që para krizës së madhe të vitit 2008 të kolonizonte gjykimet dhe ndjeshmëritë, duke u futur bile edhe në mjediset më të pabindura në parim të shpirtit borgjez, dhe më të favorshme tradicionalisht ndaj vlerave të humanizmit progresist apo dhe ideve të socializmit revolucionar

kuptuar kurrë kategorikisht, se formula e emancipimit njerëzor, nuk ishte aq shumë Terenci me librin e tij «Unë jam njeri», as Dekarti me «Cogito ergo sum» (Mendoj prandaj unë jam), të cilën e kishte formuluar me librin e tij «Pasurohuni» njëfarë Francois Guizot, historian universitar që bënte pjesë në qeverinë e «mbretit borgjez» Louis Philippe (1830-1848). Në fakt, dimë se ultimatumi i Guizot, u shndërrua në moton e të gjithë borgjezisë së vogël, dhe parapriu varfërimin pa kufij dhe pa keqardhje të proletariati.

E tillë ishte në thelb, pikëpamja që u mundova të shprehja duke hartuar Borgjezin e vogël e të sjellshëm, para njëzet vjetësh. Në dukje, që atëherë ka kaluar shumë kohë në planin e ngjarjeve apo dhe të ekonomisë. Kjo mënyrë u vendos edhe tek redaktimet, që pas rezultatit të papritur të zgjedhjeve presidenciale të vitit 2017, dhe më pas atyre legjislativë që pasuan, për të folur për «një botë të re», për «ndërprerje» me botën e vjetër dhe për të rimarrë në mënyrë informacionesh gazetareske, pa asnjë distancë kritike,

«elementet e gjuhës», të komunikesve të regjimit që përpiqen të përsërisin faktin se ardhja e Z, Emmanuel Macron solli një revolucion – siç theksonte dhe titulli i librit të fushatës së tij.

Por për aq pak sa mund të shqyrtojmë atë që ndodhi në këndvështrimin e logjikave strukturore dhe të historisë kolektive, nuk mund të arrijmë në përfundimin se lëvizja inerciale e shoqërisë kapitaliste nuk ka njohur kurrë më parë ndryshime vendimtare.

* Autor i The Twittering Machine, The Indigo Press, Southampton, 2019.

Nga kjo pikëpamje, edhe dyndja në skenën politike dhe në sferën e Shtetit, të aktorëve të improvizuar makronistë, nuk ka sjellë ndonjë gjë të re. Në planin strukturor, sa subjektiv dhe objektiv në të njëjtën kohë, mungesa e progresit të historisë duket sikur e konfirmon predikimin e La Bruyere (në shekullin XVII): «Në njëqind vjet, bota do të mbijetojë akoma në tërësinë e saj: do të jetë i njëjti teatër dhe i njëjti dekor, por nuk do të jenë të njëjtët aktorë.» Në fakt, luhet i njëjti repertor, por me një shpërndarje të ndryshme. Kryeministri i ri Macron, shfaqet gjithë shkëlqim, ose si një prototip i borgjezit të vogël të kohës sonë, ose të paktën si tipi i fundit, dhe, në këtë kuptim, ai është ikona përfundimtare e njeriut ekonomik, i mbërthyer nga kapitalizmi i shekullit të XXI, neo-aristokrati i shoqërisë së bollëkut, i pabarazisë, lavdisë, i pamjes së gënjeshtërt, dhe humbjes së kohës, modeli i shkëlqyer që i është propozuar nxënësve tanë në shkollat e mira të vendit.

Fatkeqësisht për të dhe për ata që i përngjasojnë atij, kanë mbërritur shumë vonë për t'i dhënë një karrierë të lirë ambicjeve të tyre: shoqëria e bollëkut është duke u rrënuar. Edhe duke u ruajtur që të hiqesh për kolapsologut, mund të dallosh premisat e një tërmeti të fuqishëm.

Kemi prekur kështu të vetmin aspekt të rëndësishëm të realitetit aktual që mund ta konsiderojmë me të vërtetë si një risi që mund të sjellë ndryshime thelbësore në rrjedhën e historisë sonë: pohimi gjatë dekadës së fundit të ndërgjegjes ekologjike, jo vetëm në formën e një fjalimi shkencëtarësh mbi raportet midis aktiviteteve njerëzore dhe menaxhimit të mjedisit natyror, dhe as të një doktrine filozofiko-antropologjike mbi përkatësinë e Njeriut në Natyrë - ide dhe opinione që janë shprehur, tashmë, ka pak kohë, pa ndonjë bujë të madhe, dhe që duhet ta pranojmë. Përkundrazi, këto vitet

e fundit, kemi qenë prezent në një nga lëvizjet e një tërësie të trupit shoqëror, që shkencat shoqërore kanë pasur gjithmonë vështirësi për ta kuptuar sepse shpesh këto lëvizje kanë tendencën ta shpjenë kolektivin tek interindividualja dhe është, praktikisht, e pamundur të gjeshe me saktësi ku, kur dhe përse pikërisht individualitet e panumërta që formojnë një grup social ndryshojnë drejtim me një tërësi të habitshme, si një grup zogjsh apo një grumbull peshqish që në dukje nuk i binden asnjë sinjali të izoluar të kapshëm.

Arsyeja është se këto lëvizje, në mënyrë të pandashme kolektive dhe individuale, nuk kanë një drejtues unik, por që ka shumë mundësi të jenë orkestruar në çdo rast në popullatën njerëzore, nga një mekanizëm komunikimi i menjëhershëm ndërmjet dijeve (habitus à habitus) tek individët e formuar nga e njëjta materie kolektive: të njëjtat reaksione në të njëjtat kushte strukturore të ekzistencës dhe në të njëjtat stimuj ekonomikë. Kjo lloj forme ndjeshmërie tërësisht sociale është e dënuar nga vetë natyra që t'u shpëtojë analizave ndërvepruese të politologëve të shërbimit dhe miopisë puntiniste të instituteve që kryejnë sondazhe. Këtë gjë shpjegon dhe fakti se pse pjesa më e madhe e të ashtuquajturve ekspertëve tanë, përgjithësisht, e humbin shfaqjen e së resë tek e vjetra. Në këtë mënyrë, gjatë viteve 2010, fluksi i madh i ndjeshmërisë ekologjike u zhyt pak nga pak në peizazh, në një mënyrë pothuajse të heshtur, pavarësisht

Spektri i ekologjisë

Siç e kemi konstatuar, këto tentativa të së ashtuquajturës e majta qeveritare, më pas e djathta makroniste, për të futur në trungun kapitalist një element ekologjist, u desh të bëheshin ulje të mëdha nëpërmjet një fiaskoje.

zhurmës mediatike që u bë rreth tentativave të kota të përmirësimit elektroralist të ekologjisë nga qeveritë pasardhëse. Klasat tona drejtuese, që besonin se kishin lidhur përfundimisht klasat e mesme në karron e liberalizmit të së djathtës dhe të së majtës, menduan fillimisht se për të çuar në vatrën prodhuese klasat e mesme të shqetësuar dhe për të devijuar zemërimin e tyre përpara tmerrit kapitalist, mjaftonte që t'i besojë një portofol ministri, më shumë honorifik sesa i dobishëm, ndonjë përfaqësuesi të borgjezisë së vogël të gjelbër i etur për të bërë karrierë.

Kjo mund të habisë vetëm ata që nuk e kishin kuptuar mirë akoma se një projekt i tillë është nga vetë thelbi i tij i papërputhshëm me logjikën e zhvillimit kapitalist.

Ky i fundit detyron çdo qeveri dhe çdo administrator të shesë gjithçka dhe çfarëdolloj gjëje, përfshi këtu dhe nënën e tij, natyrisht, nëse gjen treg edhe për të. Është më se e qartë se për të futur ekologjinë në politikë, nuk mjafton të rekrutojmë disa të rinj bashkëpunëtorë ambicioz apo naivë dhe t'u ngjisim në ballë etiketën «ekologjist shërbimi» për të rregulluar problemin. As Franca, as Europa, as planeti nuk do të silleshin më mirë. Një Saturn i tillë që gllabëron fëmijët e tij, kapitalizmi e shtrin gllabërimin e tij në gjithçka që ekziston, pa llogaritur riprodhimin e tij afatgjatë: burime minerale, bimore, shtazore, bile dhe njerëzore, gjithçka duhet të vdesë, gjithçka është për t'u shitur, çdo gjë bëhet mall dhe para. Derisa i gjithë planeti të shndërrohet në një gropë shkarkimi që qelbet erë, helmuese dhe e pajetueshme. Vetëm nëse e ndalojmë këtë çmenduri vrasëse para se ajo të ketë shkatërruar gjithçka.

Pikërisht në këtë pikë ekologjia – jo si ekologji artificiale dhe gjeshtikulime plot hijeshi dhe borgjezë



Emmanuel Macron. Foto nga Remi Jouan

Sistemi social kapitalist ekziston gjithmonë dhe gjithandej gjendet në dy forma: njëra e konkretizuar në struktura, në institucione dhe në shpërndarjet e jashtme, për të luftuar nëpërmjet të gjitha rrugëve tradicionale të luftës politike; forma tjetër e fshehur dhe e trupëzuar në një lloj tjetër Teme, që mund ta përfaqësojmë në formën e një «borgjezi të vogël të sjellshëm»

në të cilën ndodhemi. Ashtu siç «spektri i komunizmit» e bënte Europën të dridhej në shekullin XIX-të, spektri ekologjik bën botën të dridhet nga kapitali i madh aktual.


Pikërisht këtu qëndron e vetmja risi e sotme, dhe shpresa e vetme. Çdo ditë bëhet më e qartë, sidomos në mendjen e brezit të ri, se jo vetëm duhet luftuar për të shpëtuar planetin, por dhe se beteja për të shpëtuar botën natyrore është absolutisht e pandashme nga beteja për të ndryshuar botën shoqërore. Në këtë nivel mendimi, nocioni i ekosistemit pushon së qeni një koncept-kyç i shkencave të jetës dhe të tokës për të krahasuar si në përhapje ashtu dhe në kuptim, konceptin e «sistemit social». Me fjalë të tjera, nëse duam vërtet të shpëtojmë ekosistemin njerëzor, duhet t'i nxjerrim nga kapitalizmi. Ose më mirë të themi, duhet të nxjerrim kapitalizmin nga lloji njerëzor. Por sistemi social kapitalist ekziston gjithmonë dhe gjithandej gjendet në dy forma: njëra e konkretizuar në struktura, në institucione dhe në shpërndarjet e jashtme, për të luftuar nëpërmjet të gjitha rrugëve tradicionale të luftës politike; forma tjetër e fshehur dhe e trupëzuar në një lloj tjetër Teme, që mund ta përfaqësojmë në formën e një «borgjezi të vogël të sjellshëm» dhe ky i fundit është rrënjësor në thellësi të ndryshueshme, në secilin prej nesh. Nga kjo rezulton se beteja kundër sistemit kapitalist është gjithmonë në njëfarë mënyre, një betejë kundër një pjesë të vetvetes, kundër borgjezit të vogël oportunist që dremet në secilin prej nesh, gati për t'u zgjuar nga alarmi i sirenavë.

[1] Luc Boltanski dhe Ève Chiapello, *Shpirti i ri i kapitalizmit*, Gallimard, Paris, 1999.

[2] Tek filozofi Gottfried Wilhelm Leibniz (1646-1716), njësitë më të vogla, që përbëjnë një tërësi autosuficiente, «nuk kanë fare dritare, nga të cilat mund të hyjë ose të dalë diçka» (Monadologie).

[3] «Homo sum, nihil humanum mihi alienum putō» («Jam një njeri, mendoj, dhe jam i mendimit se asgjë njerëzore nuk më është e huaj»), Tërenci (shekulli i II, PK).

[4] Sipas sociologut Pierre Bourdieu, habitus është një sistem dispozitash i trupëzuar nga individët gjatë socializimit të tyre dhe që variojnë në funksion të origjinës sociale.



Portret i Molière

SHKRIMTARËT MIDIS (MOS) PËRGJEGJËSISË MORALE DHE LETËRSISË SË ANGAZHUAR

Penat e kundërthënies

Jo pak shkrimtarë vendorë me ndikim ishin frymëzues të projekteve politike që patën përfundime vrastare në masë, përgjatë historisë ballkanike dhe sidomos luftërave të fundit në ish-Jugosllavi. Përtej çështjes së ballafaqimit të sotëm të letërsive dhe të artit me të kaluarën; temat e imperativit estetik, përgjegjësisë morale, letërsisë të angazhuar ose rolit të shkrimtarit në shoqëri, janë rishfaqur së fundi edhe me rastin e fituesit të fundit të çmimit Nobel për letërsi, Peter Handke.

NGA BELGZIM KAMBERI

Tragjeditë ballkanike kanë ridëshmuar se çështja e letërsisë së angazhuar mbetet komplekse. Përderisa përvojat e së kaluarës kanë dëshmuar se disa njerëz të letrave kanë kontribuar në zbatimin e politikave vrastare; disa zëra mbrojnë argumentin e ndarjes së veprës letrare nga mendimet shoqërore dhe politike të autorit.

Në anën tjetër, sot, në kohë paqeje dhe të pluralizmit e tregut të lirë, letërsitë «pasjugosllave» dhe shqipe mbeten marginale e periferike, të mbyllura në një lloj izolimi pas-komunist, përderisa zhvillohen e përhapen këtu dhe kultura zbavitëse.

A duhen shkrimtarët të angazhohen në/përmes letërsi(së) dhe të jenë në shërbim të së vërtetës, emancipimit dhe lirisë?

Për këto tema dhe për gjendjen e sotme në Serbi dhe në Kosovë, njëzet vjet pas rënies së Millosheviqit dhe dhjetë vjet pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës, bashkëbiseduam me dy shkrimtarë të njohur, fitues të çmimeve të shumta në fushën letrare: Ag Apolloni, botues, shkrimtar, studiues dhe ligjërues universitar në Prishtinë; si dhe Gojko Bozhoviq (Gojko Božović), botues, shkrimtar dhe kritik letrar nga Beogradi.

- Gjatë historisë ballkanike dhe sidomos luftërave në ish-Jugosllavi, shumë shkrimtarë vendorë me ndikim ishin frymëzues të projekteve politike që patën përfundime vrastare në masë dhe ç'njerëzore. Sa ka pasur guxim letërsia e pasluftërave ta kthejë së paku tmerrin, të pakuptueshmen dhe të pashpjegueshmen, në njerëzoren?

Ag Apolloni : Lidhja e letërsisë me politikën dhe sidomos animi politik i shkrimtarëve nuk është fenomen i njohur vetëm në Ballkan, pasi sigurisht nëpër periudha të ndryshme atë e hasim edhe në Itali, Francë, Spanjë, Gjermani, Rusi etj. Natyrisht, në ish-Jugosllavi kjo lidhje ishte shumë e theksuar, pasi konteksti ishte i atillë që e instrumentalizonte shkrimtarin. Pa dashur të krijoj alibi për shkrimtarët, mendoj se angazhimi i tyre politik duhet të shpjegohet me analiza sociologjike dhe psikologjike. Ndërsa, se sa ka pasur guxim letërsia ta kthejë tmerrin në art humanist, mendoj se ky është një shqetësim i vjetër sa letërsia dhe më shumë se për guxim, ndoshta do të mund të flisnim për talent. Dhe për karakter, natyrisht.

Gojko Bozhoviq : Nuk kemi fare të bëjmë me ndonjë veçori, të historisë së re, të ndonjë shoqërie të veçantë dhe të shkrimtarëve ballkanikë ose jugosllavë. Rrethanat dramatike historike nuk kanë qenë kurrë një kornizë e mirë për mendimin kritik dhe të pavarur, apo për t'i rimenduar proceset historike ose strategjitë politike. Në Ballkan ka histori për së tepërmi. Shoqëritë ballkanike, të gjitha pa dallim, kanë nevojë për një shkëputje nga historia, në mënyrë që të rregullojnë më mirë veten e tyre, të përballen me

historinë e tyre dhe modernitetin e tyre, jo më pak të rëndësishëm. Unë besoj se kjo do t'i ndihmonte shoqëritë ballkanike ta kuptojnë më mirë veten e tyre, por edhe t'i shikojnë shoqëritë fqinje me më pak vrazhdësi. Sigurisht se letërsia ka një potencial kritik që mund të jetë i vlefshëm për ta kuptuar momentin aktual, si dhe tendencat e fundit apo më të vjetra historike. Letërsitë ballkanike vazhdimisht pas luftës, por edhe në veprat e tyre më të mira japin pamjen më të bazuar dhe më të mprehtë të historisë së Ballkanit.

- Megjithëse sot zyrtarisht pjesë të sistemit pluralist dhe tregut të lirë, duket se letërsitë «pasjugosllave» dhe shqipe mbeten marginale e periferike, të mbyllura në një lloj izolimi paskomunist. Madje, ndryshe nga kultura zbavitëse dhe këtu, letërsitë vendorë nuk po mundën të zhvillohen mjaftueshëm edhe në hapësirën rajonale, e mos të flasim për hartën letrare të Evropës. Cilat janë shkaqet dhe si mund të dilet nga ky rreth vicioz?

Ag Apolloni : Sot jetojmë në «epokën e anglishtes» dhe gjithçka që nuk i përket kësaj gjuhe na duket

sekondare, terciare e kështu me radhë. Por, ky mund të jetë një iluzion që e shkakton gjuha, jo letërsia. Për t'u integruar në gjuhën e madhe kërkohen politika kulturore-përkthimore, sado që vetë përkthimi nuk mund t'i atribuojë veprës vlera që ajo nuk i ka në gjuhën origjinale. Është fakt që letërsia, por jo vetëm ajo «pasjugosllave», nuk po gjen mjaftueshëm hapësirë, për shkak të vërshimit të kulturës zbavitëse dhe të kësaj. Në njëfarë mënyrë, kultura estradeske, e përkrahur fuqishëm nga mediat, ia ka ngushtuar hapësirën kulturës elitare, por le të shpresojmë se kjo që e po e shohim si çështje hapësire do të jetë vetëm çështje kohe.

Gojko Bozhoviq : Nëse e shikojmë me kujdes hapësirën «pasjugosllave», ose Ballkanin Perëndimor, ose Mini-Schengenin, dhe nuk kam dilema se së shpejti do të kemi emërtime të tjerë në qarkullim, mund të shohim lehtësisht që sunduesit populistë dhe autokratë bashkëpunojnë shkëlqyeshëm midis tyre, duke qeverisur atdhetë e tyre si prona private, midis të cilave mbajnë tensione të kontrolluara dhe të dozuar, sepse është më e lehtë të sundosh kur sajon armiq të brendshëm dhe

të jashtëm. Paralelisht kriminaliteti i madh bashkëpunon shkëlqyeshëm, ndërsa këtu dhe kultura zbavitëse vetëvetiu rajonalizohen dhe globalizohen lehtë. Kultura është marginalizuar, sidomos letërsia. Ky është një proces global, por në pjesën tonë të botës kjo ushqehet nga populizmi që ka kulturën për armik natyror. Rëndom, marginalizimit të kulturës dhe qëndrimit të saj brenda hapësirave të mbyllura i ndihmojnë edhe dramat identitare ballkanike, të cilat ndikojnë që elitat politike ta perceptojnë kulturën si makina prodhuese të identitetit. Ekziston një problem tjetër i hapur në një shkallë evropiane: letërsitë e Evropës Lindore, përfshirë ato ballkanike, ishin interesante në perëndimin evropian përderisa shkrimtarët ishin disidentë komunistë dhe letërsia kishte këtë subverzitet politik. Ballkani nuk është më në fokus, siç dëshmohej më së miri nga stabilitetkracia si një model i imponuar i fatit politik të shoqërive ballkanike në shpërndarjen aktuale të roleve evropiane. Megjithatë, shoqëritë ballkanike nuk duhet të pranojnë një rol inferior ose të kontribuojnë në atë. Nëse politikat dhe ekonomitë ballkanike nuk janë të mira dhe me rëndësi evropiane, padyshim që kulturat ballkanike janë të tilla.

ISTIKAMET

- Z. Apolloni, keni deklaruar se letërsia shqipe përgjatë gjithë historisë së saj ka qenë propagandë fetare, politike ose nacionale. Cilat janë argumentet tuaja dhe sa ka perspektivë për ndryshimin e kësaj fryme letrare?

Ag Apolloni : Po, këtë e kam deklaruar në librin «Koferi i Konicës», që është libri im kritik më i diskutuar në Kosovë dhe i bojkotuar plotësisht në Shqipëri. Në këtë libër, ku e trajtoj letërsinë shqipe nga fillimi deri në fund të shekullit XX, kam sistemuar konstatimet që i kam mbajtur nëpër margjina librash, të cilët i kam lexuar kujdesshëm dhe sistematikisht për vite më radhë. Asnjë konstatim aty nuk është bërë në mënyrë të ngutshme, apo me dashakeqësi, sado që konciziteti i konstatimeve të shijen e një arbitrariteti gjykues. Letërsia shqipe lindi si propagandë fetare, sepse erdhi si përgjigje ndaj thirrjes së Kundër-reformës, e cila çoi te krijimi i një sektori propagandistik të quajtur «Propaganda Fide», që financonte botimet kishtarë dhe pro-kishtarë. Letërsia shqipe është edhe propagandë nacionale dhe politike, sepse me shekuj udhëhiqet nga ideja e Motit të Madh (epokës së lavdishme të Skënderbeut) si model i projektit për bashkimin e shqiptarëve dhe të trojeve të tyre. Ndërsa, faza më e padurueshme e propagandës politike ishte periudha e komunizmit, kur letërsia iu nënshtua metodës zyrtare të realizmit socialist. Sigurisht, për dallim prej shkencës, letërsia nuk përparon, thjesht ndryshon, por problemi i letërsisë shqipe është se deri në fund të shekullit XX nuk ka ndryshuar, ka qëndruar në istikamet e hapura shekuj më parë. Dalja nga istikamet nënkupton edhe emancipim intelektual, edhe transformim estetik e letrar.



Ag Apolloni

- Ndonëse e pavarur që më se dhjetë vjet, Kosovën e cilësoni si një vend me «demokraci danteske», ku «nuk ka mbaruar Mesjeta», si një «vend i pafrymë, një tokë e shkretë dhe e vdekur». Ç'nënkupton kjo kur e thotë një njeri i letrave?

Ag Apolloni : Dhjetë vjet pas pavarësisë dhe njëzet vjet pas luftës, askujt s'do t'ia merrte mendja se mund të vinim në këtë ditë sa t'ia kishim frikën demokracisë. Vendi ka kaluar nga diktatura orwelliane në demokraci danteske (infernale) dhe unë nuk e di se cila është më e frikshme. Që njëzet vjet në Kosovë bëhet politikë korruptive, klienteliste, shantazhuese, ofenduese, kërcënuese dhe linçuese. Kulturalisht ajo është e pafrymë, e shkretë, e vdekur. Është nevojë urgjente të formohen disa çerdhe intelektuale dhe kulturore në mënyrë që klima të bëhet e përbalueshme për shoqërinë e shkelur nga thundra oligarkike, së cilës nuk i duhet shumë kohë e mund për t'u kthyer në thundër tiranike. Politikati e gjat izoluese gjithmonë shkaktojnë klaustrofobi te qytetarët, instinkti i mbijetesës së të cilëve, për t'i shpëtuar atakut astmatik, synon të hapë dritare edhe aty ku ka vetëm mure. Dritare të tilla i shoh forumet (vendet, çerdhet, qendrat) intelektuale e kulturore, që krijojnë atë “esprit du lieu”, atë “frymë të vendit” (“genius loci”) që, sipas kuptimit mitik, kuptimëson dhe mbron jetën dhe vendin.

- Z.Bozhoviq, si do ta kishit përshkruar Serbinë e sotme njëzet vjet pas rënies së Millosheviqit?

GOJKO BOZHОВИЌ

Gojko Bozhoviq : Shoqëria është e ndarë dhe e varfër. Ekonomia është e dobët, e për këtë korrupsioni i përhapur. Kultura është e marginalizuar. Mediat janë shumë të kontrolluara, me pak përjashtime. Të rinjtë, por tani gjithnjë e më shumë të moshës së mesme, po braktisin vendin masivisht. Në vend të unifikimit me Bashkimin Evropian, Serbia, si vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor, është zhjatur në stabilitet. Në kuptim politik kemi të bëjmë me autokraci populiste.

- Qarqe të ndryshme dhe njërëz të shumë nga arti e letërsia në Serbi kanë mbështetur ose frymëzuar regjimin e Millosheviqit në luftërat e ish-Jugosllavisë. Sa janë sot në Serbi të gatshme letërsia dhe arti të ballafaqohen me të kaluarën?

Gojko Bozhoviq : Të gjithë regjimet autoritare kanë pasur dhe kanë shkrimtarë dhe intelektualë të tyre. Regjimi i Millosheviqit nuk është përjashtim në këtë drejtim. Pati shkrimtarë dhe intelektualë që e mbështetën hapur regjimin e Millosheviqit në periudha të ndryshme. I kam kritikuar në vitet '90, por kurrë nuk kam menduar se ata e kishin fjalën kryesore dhe se Millosheviqi ishte arma në duart e tyre. Në marrëdhëniet mes shkrimtarit idhujtar dhe regjimit, forca është gjithmonë në anën e regjimit. Shumica e shkrimtarëve dhe intelektualëve në Serbi kanë kontestuar regjimin e Millosheviqit, ndërkohë të

“Luftërat ballkanike të viteve '90 janë tepër të tmerrshme dhe do të jenë tepër rënduese për gjeneratat e tëra që të reduktohen vetëm në një shkak ose vetëm në një të kaluar të errët. Nëse duam ta kuptojmë dhe ta tejkalojmë këtë trashëgimi, atëherë me qasje kritike e të hapur, me gjakftohësi dhe pa vullnet të keq duhet patjetër nisur nga vetja dhe ta kuptojmë tërë kontekstin. Më mirë të jetojmë me të vërteta të hidhura se të mbetet vazhdimisht e hapur lufta e ftohët ballkanike”

shumtë janë ata që e kanë kundërshtuar. Ekzistojnë sot shumë libra për këtë jo vetëm në Serbi. Luftërat ballkanike të viteve '90 janë tepër të tmerrshme dhe do të jenë tepër rënduese për gjeneratat e tëra që të reduktohen vetëm në një shkak ose vetëm në një të kaluar të errët. Nëse duam ta kuptojmë dhe ta tejkalojmë këtë trashëgimi, atëherë me qasje kritike e të hapur, me gjakftohësi dhe pa vullnet të keq duhet patjetër nisur nga vetja dhe ta kuptojmë tërë kontekstin. Më mirë të jetojmë me të vërteta të hidhura se të mbetet vazhdimisht e hapur lufta e ftohët ballkanike.

- Sa zhvillohet vetëkritika shoqërore në krijimtarinë artistike shqipe dhe serbe, sidomos në raport me tjetrin?

Ag Apolloni : Mendoj se vetëkritika, apo autokritika e ndërjegjëson njeriun, e shpëton nga narcisizmi. Për letërsinë shqipe diskursi autokritik është kusht i domosdoshëm për njohjen e vetes dhe njohjen e tjetrit. Njeriu e ka shpikur pasqyrën për ta parë (dhe rregulluar) fytyrën e vet dhe për të mos e shastisur tjetrin.

Gojko Bozhoviq : Vetëkritika ka qenë gjithnjë e shprehur fuqishëm



Gojko Bozhoviq

në kulturën dhe letërsinë serbe. Kjo është, pos tjerash, një virtut i domosdoshëm i kulturës së lartë dhe letërsisë. Zhvillimi i kulturës nuk është i mundur pa vetëkritikën, e besoj se edhe vetë kultura nuk është e mundur. Çështje tjetër është se kultura është marginalizuar sot, si në Serbi ashtu dhe në çdo shoqëri tjetër evropiane, që e bën të pavërtetshëm mjaftueshëm potencialin kritik dhe vetëkritik të kulturës.

- Z.Apolloni, a mund të na shpjegoni se si paraqiten serbët në kulturën, kinematografinë dhe letërsinë shqipe?

Ag Apolloni : Zakonisht në kinematografi dhe në teatër, paraqitja e serbëve është bërë sipas stereotipave të njohur, pa ndonjë trajtim psikologjik, kurse proza dhe poezia, në disa raste të rralla, i ka sfiduar këto paragjykime.

- Po shqiptarët në ato serbe z.Bozhoviq?

Gojko Bozhoviq : Marrëdhëniet serbo-shqiptare janë të ndërlikuara për më shumë se një shekull. Serbët dhe shqiptarët nuk kuptohen mjaftueshëm, ndërkohë që ndërmjetësuesit i kontribuojnë pak ose aspak këtij mirëkuptimi. Ndoshta kultura mund të jetë ndërmjetësi më i mirë midis dy kombeve ballkanike. Shqiptarët janë të pranishëm edhe në romanet e reja serbe, në filmat dhe seriale të reja serbe, si dhe në debatet historiografike. Në mënyra të ndryshme, por rrallëherë në rolet kryesore. Vlenë të përmendet një rast: para dy vjetve, fituesi i çmimit të revistës NIN për romanin e vitit ishte libri “Luzitania” i Dejan Atanackoviq, me temat serbo-shqiptare të shekullit XX.

ANGAZHIMI

- Tragjeditë ballkanike kanë ridëshmuar se çështja e letërsisë së angazhuar mbetet komplekse. Marrë parasysh edhe këto përvoja, a mendoni se shkrimtari duhet të angazhohet në/përmes letërsi(së) dhe të jetë në shërbim të së vërtetës dhe lirisë, siç e thoshte Albert Camus?

Ag Apolloni : Angazhimin, të cilin e refuzoi letërsia moderniste e ktheu letërsia postmoderniste, e cila ishte për një angazhim kritik. Tash kur edhe postmodernizmit i erdhi fundi, mendoj se ka ndryshuar edhe funksioni i artit. Tashmë edhe statistikati e bazuara në anketimet e lexuesve nëpër botë po tregojnë që letërsia jofiksionale po dominon ndaj asaj fiksjonale dhe se letërsia është vënë në shërbim të së vërtetës, në kërkim të së cilës janë vënë autori dhe lexuesi.

Gojko Bozhoviq : Çështja e letërsisë së angazhuar do të jetë gjithmonë komplekse. Do të jetë komplekse edhe në çdo pjesë tjetër të Evropës. Angazhimi është çështje e temperamentit, poetikës, kontekstit konkret historik, kulturor, shoqëror dhe politik, përzgjedhjes vetëndërgjegjëse të secilit shkrimtar. Ka shkrimtarë të jashtëzakonshëm që janë neveritur nga angazhimi, ka shkrimtarë të jashtëzakonshëm që nuk mund ta paramendojnë jetën ose letërsinë e tyre pa angazhim. Por asnjëri prej tyre nuk bëhet i jashtëzakonshëm vetëm se nga angazhimi. Edhe pse nuk e kam vlerësuar kurrë letërsinë me teze, aq më pak letërsinë që pranon çfarëdo funksionalizimi ideologjik, për mua më e afërt është ideja e angazhimit nga ideja e eskapizmit. Nuk mund ta përfaqësojmë qëndrimin se shkrimtarët patjetër duhet të kenë qëndrime identike me tonat që angazhimi i tyre të jetë i pranueshëm. Korrektësia politike është e papranueshme në letërsi. Duhet ta njohim të drejtën e shkrimtarëve për ta përcaktuar rolin e tyre në shoqëri, për t'i zgjedhur temat e tyre dhe poetikën e tyre. Në të kundërtën, nuk ka diversitet, e as shoqëri si oratorium zërash, shpeshherë plotësisht të ndryshëm.

- Ndarja e sivjetme e çmimit Nobel të letërsisë për Peter Handken ka rindezur debatin e njohur, veçmas në Bosnje, Kosovë dhe Serbi, se a duhet apo jo ta ndajmë veprën letrare nga mendimet shoqërore dhe politike të autorit? A ka shkrimtari «përgjegjësi morale» dhe a duhet një vepër artistike t'i përgjigjet

një «imperativi estetik» sipas formulës sartriane?

Ag Apolloni : Në fakt, kjo ndarje e jetës së autorit nga vepra e tij filloi në fillim të shekullit XX, me formalizmin rus dhe Kritikën e Re anglo-amerikane (New Criticism), pastaj avancoi me strukturalizmin frëng. Edhe pse i gjithë shekulli i njëzet duket sikur është marrë me këtë distinkcion, shekulli i ri ka shprehur dyshimet lidhur me përpjekje të tilla. Reagimet që shpërthyen pasi iu dha çmimi Nobel shkrimtarit Peter Handke, tregojnë se nuk është mbyllur ende çështja e ndarjes së autorit nga vepra, të hapur në fillim të shekullit të kaluar. Pra, këtë nderim që iu bë shkrimtarit austriak, unë e shoh si testim të një teorie të ngritur njëqind vjet më parë.

Gojko Bozhoviq : Qëndrimi i Sartrit është një nga të shumtë dhe nuk mund të shndërrohet në formulë. Nëse qëndrimi i Sartrit do të shndërrohej në një formulë, atëherë as Sartri nuk do ta kalonte secilin test të sprovës. Secili njeri ka përgjegjësi morale. Historia e Evropës Lindore, ku janë zhvilluar në ndërkohë institucionet qytetare, solli deri te ajo që shkrimtarët për një kohë të gjatë të mbeten si baballarë të kombit, zëdhënës të kolektivit, zëdhënës të opinionit publik. Por në të njëjtën kohë, nga të njëjtët shkrimtarë me role kaq të rëndësishme është kërkuar të kishin një mendim të përshtatshëm politik dhe shoqëror. Nuk lexohet letërsia për shkak të profilit personal të një shkrimtari ose për shkak të pikëpamjeve të tij politike dhe ideologjike. Përdërisa shijojmë shumë libra, njëkohësisht nuk dimë shumë, ndonjëherë pothuajse asgjë, për autorët e tyre. Sidoqoftë, disa shkrimtarë projektuan biografi dhe pikëpamjet e tyre politike në ekranin më të madh të mundshëm. Kjo është zgjedhja e tyre, por letërsia e tyre nuk është më shumë ose më pak e vlefshme për këtë arsye. Kjo vlen për të gjithë shkrimtarët dhe duhet të vlejë edhe në rastin Peter Handke. Nëse nuk e ndajmë letërsinë nga pikëpamjet publike të autorit, atëherë do ta rivendosnim përshtatshmërinë moralo-politike si në kohën e totalitarizmave të mëdha të shekullit XX.

DHJETË FILMAT RAJONALË QË SHËNUAN VITIN 2019 PËRTEJ BALLKANIT

Rilindja kinematografike

Nga Kroacia në Turqi, nga Serbia në Shqipëri; Ballkani, vendlindja e shumë kineastëve me famë botërore si Aleksandar Petroviq, Theo Angelopoulos, Nuri Bilge Ceylan, Cristian Mungiu dhe shumë të tjerë, tanimë mund të llogarisin edhe zëra të rinj kinematografikë. Pa i lënë pas dore temat tradicionale (familja, lufta, historia), autorët e rinj godasin me forcën e pyetjeve të tyre (identitetin, kalimin në moshën madhore, maçizmin), fuqinë e protagonistëve të tyre (bletarë nomadw, heronj të emancipuar ose në proces të emancipimit) dhe qasjet e tyre inovative në lidhje me zhanret e vendosura (filmi rrugor i kombinuar me filmin mësimor, filmi i periudhës së ngjyrosur me elemente fantastike, etj.).

NGA NIKOLLA RADIQ



Honeyland

Që nga shfaqja e tij, dokumentari i Tamara Kotevska dhe Ljubomir Stefanov nuk ndalon të jetë temë e publikut dhe e kritikëve («The Guardian», «New York Times», «Rolling Stone»). Nga Maqedonia e Veriut, vendlindja e Milcho Manchevskit, fituesit të çmimit Oskar me «Before the rain», «Honeyland» është parapërgjedhur në mesin e dhjetë filmave më të mirë të huaj në garën për Oscar 2020. Për më tepër, filmi përgëndrohet në jetën e Hatixhe Muratovas, bletarja e fundit nomade e Evropës, e cila ka fituar tre çmime në Festivalin prestigjioz «Sundance Festival» dhe dhjetëra çmime të tjera gjatë turneut të saj të festivaleve. Ky «dokumentar i hidhur dhe i shkëlqyeshëm», siç e ka përshkruar portali referues «Indie Wire» do të mbetet padyshim i shënuar në historinë e kinemasë së re maqedonase.




A tale of three sisters

Emin Alper është padyshim një nga kineastët më domethënës që punon sot në Ballkan. Pas dy filmave që nuk kaluan pa u vënë re nga kritikët ndërkombëtarë («Beyond the Hill» në 2012 dhe «Frenzy» në 2015), ai u kthye këtë vit me «A Tale of Three Sisters», një komedi dramatike me thekse fantastike, që na shpie në një fshat të izoluar të Anadolllit. Tri motra të mishëruara shkëlqyeshëm në ekran nga një treshe aktorësh të rinj turq, dërgohen në qytet për të punuar si shërbëto. Përmes një skenari të ndikuar nga letërsia dhe me një skenar të përpiktë (ka fituar çmimin për skenarin më të mirë në Festivalin e Filmit në Sarajevë), regjisori turk shpërfaq një vështrim të freskët për feminilitetin, mashkullorizmin dhe determinizmin social.



God exists, her name is Petrunya

Në zemër të kësaj «fabule feministe dhe universale» (Courrier International), frymëzuar nga një ngjarje e vërtetë: Petrunya, një grua që përfshihet në garën tradicionale të notit për kryqin në ujin e akullit të një fshati maqedonas. Meqenëse gara ishte e rezervuar deri atëherë vetëm për burrat, pjesëmarrja e Petrunya ngjalli indinjatën e bashkësisë fetare. Duke kritikuar konservatorizmin e shoqërisë maqedonase, «God Exists, Her Name is Petrunya» nga Teona Strugar Mitevska, është paraqitur në festivalin të shumta ndërkombëtare duke fituar disa çmime (përfshirë çmimin LUX nga Parlamenti Evropian).



My morning laughter

Fitues i çmimit kryesor të Festivalit të kinemasë të autorit të Beogradit, «My morning laughter» është filmi i dytë me metrazh të gjatë i regjisorit të ri serb Marko Gjorgjević. I xhiruar me një buxhet të vogël, ai përqendrohet në një tridhjetë vjeçar në nevojë për jetë nga provinca serbe. Aktorë të rinj premtues, me një nga rolet e fundit të të jashtëzakonshmit Nebojsa Glogovac (vdekur në vitin 2018), përbërje e pazakontë e planeve, spontaniteti i dialogjeve, humor autentik lokal ..Gjorgjević na shfaq një perlë që tregon se mjafton një buxhet i vogël dhe sineritet për ta bërë një film të shkëlqyeshëm.



Open door

I shfaqur si premierë botërore në Festivalin e Filmit në Sarajevë, «Open Door» ka për subjekt shoqërinë e sotme shqiptare, të shënuar thellësisht nga kanunet patriarkale. Ky film i parë i regjisorit të ri shqiptar Florenc Papa paraqet dy motra që përballen me pamëshirshmërinë e babait të tyre. Filmi është pjesë e traditës së dramës sociale, një zhanër kaq i popullarizuar në gadishullin ballkanik.



Then comes the evening

Regjisoria e re Maja Novaković udhëton në vendlinjen e saj në lindje të Bosnje dhe Hercegovinës për ta xhiruar përditshmërinë e dy grave të moshuara që jetojnë në një fshat të izoluar. Duke u luhatur midis atmosferës folklorike, poezisë së përditshme, melankolisë së vetmisë dhe ndikimeve piktoreske, ajo vështron marrëdhënien e dashur midis dy grave dhe marrëdhënien e tyre me natyrën. Ky film i parë i metrazhit të shkurtër të regjisores ka fituar tashmë disa çmime («Truth Cinema» në Teheran, «Festival i Filmit të Autorëve» në Beograd).



When tomatoes met wagner

Qoftë në saje të kinemastëve të saj klasikë, siç është i pashmangshmi Theo Angelopoulos, apo brezi i ri i autorëve nga të cilët Yorgos Lanthimos («The Favourite»), «The Killing of a Sacred Deer»...), Greqia mbetet një vend i madh i kinematografisë. Nëse këtë vit, filmi politik «Adults in The Room»

nga Kosta-Gavras, shkaktoi bujë në rajon, ndwrsa ajo qw preku thellw mendjet e kienastwve ishte dokumentari «When Tomatoes Met Wagner» me një rend krejtësisht tjetër. Menjëherë vërshohemi nga butësia dhe humori i historisë së këtyre dy kushurinjeve që përpiqen t'i rijapin jetë një fshati të rrezikuar nga zhdukja përmes prodhimit të domateve bio, me ndihmën e çmuar të gjysheve të fshatit.»«When Tomatoes Met Wagner» është një komedi e butë dhe e hidhur, që rrënjëson plotësisht në kohërat tona. Është një histori moderne e rigjallërimit rural, risajimit të të jetuarit së bashku dhe e eksplorimit të globalizmit në shkallën e vet», - nënvizon Madeline Robert e festivalit të filmit «Vision du réel» në Nyon të Zvicrës.



The whistlers

Skenarist dhe regjisor që ka fituar çmime të shumta për filmat e tij, Corneliu Porumboiu ka marrë pjesë sivjet në festivale me filmin e tij të metrazhit të gjatë «The Whistlers». I cilësuar nga Siegfried Forster (RFI) si «një film policor muzikor i jashtëzakonshëm që argëtohet duke luajtur me konventat e filmit të zhanrit, pa harruar dashurinë dhe humorin»,- filmi i ri fikson i autorit rumun ka për personazh kryesor Cristin, një polic i korruptuar i Bukureshtit i cili duhet ta mësojë gjuhën e fishkëllimave të banorëve të ishullit La Gomera në Kanari. Filmi u nominua për Palmën e Artë në Festivalin e Filmit në Kanë dhe mori çmimin për skenarin më të mirë në Festivalin Evropian të Filmit në Sevilja.



Take me somewhere nice

Ena Sendijarević, të cilën e takuam në Festivalin e Filmit në Sarajevë, vetëm disa ditë para se filmi i saj i parë i metrazhit të gjatë «Take me somewhere nice» të fitojë çmimin e madh të festivalit - Zemra e Sarajevës, është një nga ata autorë për të cilët do të duhet ta llogarisë kinemaja e autorëve evropianë në vitet e ardhshme. Midis road movie dhe filmit mësimor, të ndjeshëm dhe të guximshëm, frymëzuar nga Kelly Reichardt dhe Agnès Varda, «Take me somewhere nice» pikëpyet mbi identitetin e dyfishtë të protagonistit, një identitet të cilin e ndan edhe vet kineastja boshnjako-holandeze.



The load

Ndonëse filmi kishte premierën e tij në vitin 2018, viti 2019 do të jetë ai që do të mbetet i gdhendur në kujtesën e kineastit serb Ognjen Glavonić, autorit të «The Load». Ky road movie na shpie në Serbi, në kohën e bombardimeve të NATO-së. Në një atmosferë ngufatëse dhe mbytëse, jemi në udhëtim me vozitësin e kamionit : Vlada (interpretuar me një minimalizëm goditës nga Leon Lučev) i cili bart një ngarkesë misterioze. Në vitin 2019, «The Load» ka qarkulluar gjithandej në botë (Cleveland, Los Angeles, New York, Chicago, Argjentinë, etj.) dhe u vlerësua nga kritikët e revistave prestigjioze (Los Angeles Times, Cinema Scope, New York Times, Variety). Përtej rezultetit 100% me «Rotten Tomatoes», filmi nga Ognjen Glavonić është cituar si «një nga filmat më të mirë të vitit» nga portali referues RogerEbert.com.

(COURRIER DES BALKANS)

REDAKSIA E BOTIMIT NË SHQIP

Botues: Instituti "Musine Kokalari"- Prishtinë (Kosovë)

Drejtor: Belgzim Kamberi

Kryeredaktor: Ilir Yzeiri

Redaksia: Leart Kola, Shkodran Hoti

Përkthimi: Loretta Mokini, Entela Cani

Layout design: Dritan Lleshi

Tirazhi: 1500

Email: botadiplomatiqe@gmail.com

Botimi i "Le Monde Diplomatique" në gjuhën shqipe mbështetet nga Zyra Zvicerane për Bashkëpunim në Kosovë- SDC

 Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra
Swiss Cooperation Office Kosovo

Édité par la SA Le Monde diplomatique.
Actionnaires: Société éditrice du Monde,
Association Gunter Holzmann,
Les Amis du Monde diplomatique
1, avenue Stephen-Pichon, 75013 Paris
Tél.: 01-53-94-96-01. Télécopieur: 01-53-94-96-26
Courriel: secretariat@monde-diplomatique.fr
Site Internet: www.monde-diplomatique.fr

Directoire: Serge HALIMI,
président, directeur de la publication
Autres membres: Vincent CARON, Bruno LOMBARD,
Pierre RIMBERT, Anne-Cécile ROBERT
Directrice des relations et des éditions internationales:
Anne-Cécile ROBERT
Secrétaire générale:
Anne CALLAIT-CHAVANEL

Directeur de la rédaction: Serge HALIMI
Rédacteur en chef: Benoît BRÉVILLE
Rédacteurs en chef adjoints:
Martine BULARD, Renaud LAMBERT
Cheffe d'édition: Mona CHOLLET
Rédaction: Akram BELKAD, Philippe DESCAMPS,
Evelyn PIELLER, Hélène RICHARD,
Pierre RIMBERT, Anne-Cécile ROBERT
Cartographie: Cécile MARIN
Site Internet: Guillaume BAROU, Thibault HENNETON

Conception artistique:
Maria IERARDI, Boris SÉMÉNIAKO
(avec la collaboration
de Delphine LACROIX pour l'iconographie)
Rédacteur documentaliste: Olivier PRONET
Mise en pages et photographies:
Jérôme GRILLIÈRE, Patrick PUECH-WILHEM
Correction: Xavier MONTHEARD, Sarah ZHIRI

Directeur de la gestion: Bruno LOMBARD
Directeur commercial,
chargé de la diffusion numérique: Vincent CARON
Contrôle de gestion: Zaita SAHALI
Secrétariat: Yuliya DAROUKA (9621),
Sophie DURAND-NGÔ, attachée communication
et développement (9674), Eleonora FALETTI (9601)

Courriel: prenom.nom@monde-diplomatique.fr
Fondateur: Hubert BEUVE-MÉRY. Anciens directeurs:
François HONTI, Claude JULIEN, Ignacio RAMONET

Publicité: Hélène FAVERIE (01-57-28-38-03)

Diffusion, mercatique: Brigitte BILLIARD, Saveria COLOSIMO-MORIN, Sophie GERBAUD, Sabine GUDE, Carole MERCERON, Christiane MONTILLET

Relations marchands de journaux (numéro vert):
0805-050-147

Service relations abonnés
● Depuis la France: 03-21-13-04-32 (non surtaxé)
www.monde-diplomatique.fr
● Depuis l'étranger: (33) 3-21-13-04-32

Reproduction interdite de tous articles,
sauf accord avec l'administration

© ADAGP, Paris, 2019,
pour les œuvres de ses adhérents

Prix de l'abonnement annuel à l'édition imprimée:
France métropolitaine: 59 €
Autres destinations: www.monde-diplomatique.fr/abo

FAQE 2-3

Nga Santiago në Paris, popujt në rrugë, **NGA SERGE HALIMI**

FAQE 4-5

Regjimi iranian ose një njeri që po mbytet, nuk ka frikë Nga shiu, **NGA LEART KOLA** / Nga brenda betejës, **NGA MARINA DA SILVA** Disa jetë më të çmuara se të tjerat, **NGA CHARLOTTE RECOQUILLON**

FAQE 6-7

Në rrënjët ekonomike të kryengritjes libaneze, **NGA HAJAR ALEM DHE NICOLAS DOT-POUILLARD**

FAQE 8-10

Kromi i oligarkisë, **NGA SAMI CURRI** / Mini-schengeni si jelek shpëtimi? **NGA AGON MALIQI**

FAQE 11

Revizionizmi si politikë shtetërore, **NGA DEJAN KOZUL**

FAQE 12-13

Trukimi i një lufte tregtare mes përplasjes së qytetërimeve, **NGA JEAN-LOUIS ROCCA**

FAQE 14-16

Frankofonë apo gjermanofonë? / Si shpiket një gjuhë? **NGA PHILIPPE DESCAMPS DHE XAVIER MONTHEARD** / Multilinguizmi, një dhimbje koke shkollore

FAQE 17

Irakenët kundër ndërhyrjes së Iranit, **NGA FEURAT ALANI**

FAQE 18-19

Shpopullimi në paqe, **NGA SHKODRAN HOTI**

FAQE 20-21

Jeta dhe vdekja e borgjezitetit të vogël të sjellshëm, **NGA ALAIN ACCARDO**

FAQE 22-23

Penat e kundërthënies, **NGA BELGZIM KAMBERI**

FAQE 24

Rilindja kinematografike, **NGA NIKOLLA RADIQ**